



RAPORT

"STUDIMI I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR PËR HARTËN ZONALE TE KOMUNËS SË GLLOGOCIT " 2020-2028



Korrik, 2020



Vendimi

Komuna e Glllogocit për përgatitjen e Raportit: "Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit 2020-2028" me numër identifikues: **661-20-051-247** dhe numër të arkivit **02.400-18535** përgatitur në Glllogoc ka lidhur Kontratë me "ZONNUM SH.P.K" me datë: 08.06.2020

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Glllogocit

Përgatitja e Raportit: "Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit është hartuar nga kompania "**ZONNUM SH.P.K**" **Prishtinë**.

Pronar: Msc. Hana ZEKA



PËRMBAJTJE

Contents

1. HYRJE	5
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VSM PËR HZK	10
3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së	14
4. Fazat Kyqe të procesit të VSM-së;	15
Konsultimet gjatë procesit të VSM-së;	18
5. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E GLLOGOCIT	19
Ndotja e ajrit dhe ndikimi në shëndet	24
6. IDENTIFIKIMI I VEPRIMEVE STRATEGJIKE NË MJEDIS.	36
6.1. Toka	37
6.2. ZONA PYJORE	40
6.3. ZONA BUJQËSORE PËR KONSUM PRIVAT DHE TREGTAR	45
6.4. ZONA REKREATIVE	50
6.5. ZONA KOMERCIALE DHE INDUSTRIALE	53
6.6 ZONA TURISTIKE	60
6.7. SIPERFAQET UJORE	65
7. ZONAT E MBROJTURA SANITARE NË BURIMET NËNTOKËSORE NË AKUIFER	73
8. ZONAT E MBROJTURA SANITARE TË BURIMEVE SIPËRFAQËSORE: AKUMULACIONET DHE LIQENE	77
9. ZONAT E MBROJTURA SANITARE NË BURIMET SIPËRFAQËSORE: UJËRRJEDHAT E HAPURA	80
10. ZONA E REZERVAVE MINERARE DHE FUSHAT E EKSPLLOATIMIT	81
ZONË BANIMI ME DENDËSI TË ULËT (ME FUNKSIONE TJERA NE PAJTUESHMËRI)	87
ZONË BANIMI ME DENDËSI TE MESME (ME FUNKSIONE TJERA NE PAJTUESHMËRI)	92
Cilësia e ajrit	93
Cilësia e ujit dhe tokës	94
Zhurma	94
Erozioni i tokës	94
Siguria e popullatës	95



Mbrojtja e natyrës.....	95
ZONË BANIMI ME DENDËSI TE LARTË (ME FUNKSIONE TJERA NË PAJTUESHMËRI).....	95
Ndikimet e mundshme mjedisore.....	95
Ndikimet në komponentët mjedisore.....	96
Masat Zbutëse	97
VLERËSIMI STRATEGJIKË MJEDISOR - ZONAT MBISHTRESORE	98
ZONAT NATYRORE.....	100
Masat e veçanta për mbrojtjen e Zonave të Natyrës.....	102
ZONA MBISHTRESORE ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET).....	108
ZONA MBISHTRESORE PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË TEKNIKO-TEKNOLOGJIKE	108
VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR PËR INFRASTRUKTURË RRUGORE	110
Rekomandime	111
VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR PËR INFRASTRUKTURË PUBLIKE DHE SOCIALE	112
TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE	116
Vlerësimi Strategjik Mjedisor sipas Plani të veprimit për zbatim të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit.....	117
MASAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT BAZUAR NË NDIKIMIN E HARTES ZONALE	118
MONITORIMI.....	123
PËRFUNDIME.....	127
DISKUTIMI PUBLIK	128
VSM - REKOMANDON DISA VEPRIME TË VEÇANTA PËR HARTEN ZONALE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT	129
LITERATURA	133



1. HYRJE

Raporti i vlerësimit strategjik mjedisor (VSM) është përgatitur si dokument përfundimtar i procesit të VSM-së, për Harten Zonal komunal të Komunës së Drenasit .

Raporti është përgatitur sipas kërkesave të kornizës ligjore mjedisore të Kosovës, veçanërisht VSM është në përputhje me ligjin për VSM Nr. 03/L-230, i cili është në përputhshmëri me direktiven e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis”. Bazuar në legjislacionin përkatës në nivel kombëtarë, evropian dhe ndërkombëtarë, VSM ka për qëllim integrimin e çështjeve mjedisore në zhvillimin e planeve, programeve dhe politikave. Vlerësimi strategjik mjedisor është obligim ligjor por edhe funksional në të cilin analizohen ndikimet në mjedis në fushën e shfrytëzimit të tokës, bujqësisë, pylltarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit të mbeturinave, menaxhimit të ujërave, telekomunikacionit, turizmit dhe fushave tjera.

Metodologjia për hartimin e raportit të VSM-së është në përputhje me ligjin për VSM dhe rekomandimet e veçanta nga udhëzuesi për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Harta Zonale të komunave.

Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në Komunën e Glllogocit, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin e planeve dhe programeve sipas hartës zonale të komunës, ndikimet e mundshme në mjedis si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis. Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për evitimin apo minimizimin e ndikimeve të Hartave Zonale në mjedis janë komponentët kryesorë të këtij raporti. Për hartimin e këtij raporti janë përdorë të dhëna nga Plani Zhvillimor Komunal, Vleresimi Strategjik Mjedisor për PZHK, raporte mjedisore nga Ministria e Mjedisit si Raporti për gjendjen e ajrit, si dhe të dhëna dhe materiale relevante të ngjashme. Gjithashtu janë realizuar vizita takime me zyrtaret komunal nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, përfaqësues të Gizit dhe përfaqësues nga kompania e cila ka hartuar Harten Zonale për Komunën e Glllogocit.



Hartimi i raportit "Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor" për Komunën e Glllogocit përfshinë pikat e mëposhtme:

Një përmbledhje të informacionit bazë për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Përshkrim të vizionit, të prioritetëve dhe objektivave kryesore të Hartave Zonale Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të.

Përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritshëm të tij në rast se nuk zbatohet
Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka mundësi të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani

Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin.

Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel lokal ose kombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektivat janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit

Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujën, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve

Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i hartave zonale.

Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.

Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.



1.2. Qëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit strategjik mjedisr VSM-së

Qëllimi kryesor i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. VSM-ja synon përmirësimin e planit ose programit, duke sugjeruar objektivat apo strategjitë e reja, si dhe duke rishikuar strategjitë e propozuara dhe sugjeruar ato që mund të jenë më të mira në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, minimizimit dhe parandalimit të ndikimeve dhe rreziqeve në mjedis. Si pasojë, VSM-ja duhet të fillojë herët në procesin e përgatitjes së planit dhe duhet të integrohet plotësisht në të. Në Kosovë VSM-ja është e rregulluar me Ligjin nr. 03/230, i cili përcakton kushtet, formën dhe procedurat për zbatimin e VSM-së. Në thelb, ligji për VSM-në kërkon që procedura e VSM-së të përbëhet nga:

- Përgatitja e një raporti të VSM-së në lidhje me ndikimet e konsiderueshme të draftit të planit ose programit (PP);
- Konsultimi i organeve relevante, dhe publikut të gjerë, për draftin e PP-së dhe raportin shoqërues të VSM-së;
- Marrja në konsideratë e raportit për VSM-në dhe rezultateve të konsultimit në vendimmarrje;
- Komunikimi i rezultateve të VSM-së dhe përfshirja e rezultatit të saj në PP. Sipas Ligjit Nr. 03/230, VSM-ja është e detyrueshme për PP-të vijuese:
- PP-të që janë të përgatitura për planifikim hapësinor, planifikim të qytetit, shfrytëzim të tokës, bujqësi, pylltari, peshkatari, gjueti, energji, industri, miniera, komunikacion, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikacion, turizëm, dhe të përbejnë kornizën për projektet e ardhshme të zhvillimit të cilat i nënshtrohen VNM-së sipas Ligjit për VNM;
- PP-të të cilat, duke marrë në konsideratë lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura të natyrës, mbi habitatet natyrore dhe në florën dhe faunën e egër.
- Llojet e tjera të PP-ve, vetëm nëse ato janë përcaktuara përmes "ekzaminimit" që kanë gjasa të kenë ndikime të konsiderueshme në mjedis
- Modifikimet e vogla të PP-së dhe PP-ja për zonë të vogël në nivel lokal, vetëm nëse ato janë përcaktuar përmes "ekzaminimit" që kanë gjasa të kenë ndikime të konsiderueshme në mjedis.



VSM si një qasje e të menduarit strategjik, ka tri objektiva shumë konkrete:

1. Inkurajon integrimin e mjedisit dhe qëndrueshmërisë (duke përfshirë komponentën biofizik, sociale, institucionale dhe aspektet ekonomike), vendosjen e kushteve që mundësojnë një kornizë të propozimeve të ardhshme të zhvillimit;
2. Është një vlerë e shtuar në procesin e vendimmarrjes, që mundëson për të diskutuar mundësitë dhe rreziqet e opsioneve të zhvillimit dhe duke i kthyer problemet në mundësi;
3. Ndryshon mënyrën e të menduarit dhe krijon një kulturë strategjike në vendimmarrje, promovimin e bashkëpunimit institucional dhe dialogut, duke shmangur konfliktet e mundshme.

Nëpërmjet këtyre objektivave, VSM mund të kontribuojë që:

- Të sigurojë një perspektivë strategjike, sistematike dhe të gjerë të ndërlidhjes së çështjet mjedisore në kuadër të një kornize të qëndrueshmërisë;
- Të identifikoj, zgjedh dhe të diskutoj mundësitë kryesore të zhvillimit drejt vendimeve më të qëndrueshme (duke ndërlidhur çështjet biofizike, sociale, institucionale dhe ekonomike);
- Të zbulojë mundësi strategjike dhe rreziqet në opsionet (alternativat) në kuadër të analizës;
- Të lehtësoj shqyrtimin e efekteve kumulative në mjedis;
- Të sugjeroj programe përcjelljes nëpërmjet menaxhimit strategjik dhe monitorimit;

Një planifikim në të cilin zbatohet VSM-ja është shumë më i kompletuar, më gjithëpërfshirës, më përmbajtësor dhe më objektiv se sa një planifikim që nuk e zbaton VSM-në. Së këndejmi edhe vendimmarrja në planet ku është zbatuar VSM-ja është shumë më e qëndrueshme.

Pra sikurse është e specifikuar më lartë dhe në përputhje me nenin 4 pika 2 të Ligjit të VSM, Planet Hapësinore dhe ato për planifikim të qytetit kërkojnë përgatitjen e raportit të VSM-së. Prandaj edhe për HZK-në e Komunës së Gllogocit, raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor është i detyrueshëm.



Përfitimet nga VSM-ja

Përfitimet kryesore që arrihen nga zbatimi i VSM-së janë:

- Promovon vendimmarrjen e integruar mjedisore dhe pjesëmarrjen e publikut në hartimin e politikave mjedisore.
- Forcon rolin e autoriteteve mjedisore përmes pjesëmarrjes së tyre;
- Përmirëson bashkëpunimin midis autoritetet të ndryshme (planifikimi, mjedisit dhe shëndetit);
- Proces bashkëpunimi mes shkencëtarëve dhe vendimmarrësve;
- Mundëson qasjen e shumë palëve të interesuara nëpërmjet konsultimit publik;
- E rritë transparencën në vendimmarrje, për shkak të përfshirjes së të gjitha niveleve të shoqërisë;
- Lehtëson projektimin e planeve dhe programeve të qëndrueshme mjedisore dhe bënëmonitorimin e efekteve të tyre;
- Ofron për shqyrtimin e një gamë më të gjerë të alternativave, krahasuar me mundësitë që ofrohen në kuadër të një projekti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- Merr në konsideratë efektet kumulative, ndryshimet globale dhe alternativat në fazën e hershme të zhvillimeve;
- Forcon dhe riorganizon projektet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duke identifikuar paraprakisht ndikimet e mundshme, kërkesat për informata dhe duke reduktuar kohën dhe përpjekje për konsultime;
- Përmirëson qeverisjen e mirë dhe besimit tek publiku;
- Më pak masa zbutëse për shkak të përfshirjes së hershme të konsideratave mjedisore në plane dhe programe;
- Kontribuon për përmirësimin e përputhshmërisë me kërkesat e fushave tjera specifike të politikave mjedisore;
- Lehtëson fondeve të bashkë-financimit nga BE.



2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VSM PËR HZK

Përveç, Ligjit Nr. 03/L-230 të Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor janë konsultuar edhe ligjet tjera relevante mjedisore dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e këtij raporti:

- Ligji nr. 03/l-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji nr.03/L-106 për Planifikim Hapësinor
- Ligji nr.04/l-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji nr. 03/l–233 mbi Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji nr. 02/l-26 për Tokën Bujqësore
- Ligji nr. 02/l-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike
- Ligji nr. 02 / l-102 për Mbrojtjen nga Zhurma
- Ligji nr. 03/l-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
- Ligji nr. 03/l-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji nr. 03/l-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji nr.04 / l-060 për Mbeturina
- Ligji nr. 02/l-197 për Kimikate
- Ligji nr. 02/l-78 për Shëndetësi Publike
- Ligji nr.03/l-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës
- Ligji nr. 02/l-53 për Gjuetinë
- Ligji nr. 04/ l-176 për Turizmin
- Ligji nr. 04/-l-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
- Ligji nr. 03/l-163 për Minierat dhe Mineralet
- Ligji 2003/11 për Rrugët
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale
- Ligji nr. 03/l-104 për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare
- Ligji 2008/03-L039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, etj.



2.1. Konventat Ndërkombëtare Mjedisore

Gjatë hartimit të këtij raporti për Harten Zonale të Komunës së Glllogocit disa nga konventat mjedisore të cilat janë marrë parasysh janë renditur me poshtë:

- Konventa e Bernës; “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”
- Konventa e Bazelit; “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”.
- Konventa e Vjenës; “Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit” dhe Protokoli i Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.
- Konventa e Aarhus-it;
- Konventa e Espoo-s “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar”.
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike,
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin,
- Konventa për ruajtjen e Florës dhe Faunës së egër të mjedisit natyror të Europës
- Konventa për mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të egra
- Konventa për Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha
- Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar
- Konventa për Rivlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar
- Konventa e Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare
- Konventa e Mbetjeve të Rrezikshme dhe asgjësimin e tyre,
- Konventa e Stokholmit; “Mbi dotësit organike të qëndrueshëm”,



Me theks të veçantë gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë në shqyrtim Konventa Aarhus, Espoo dhe Protokolli i Kievit.

Konventa Aarhus - Kjo konventë është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Aarhus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit “Mjedisi për Evropën”. Kjo konvent vendos një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Nga palët në këtë konvent kërkohet t’i hartoj në dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive.

Konventa Aarhus-it parashikon:

Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t’i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t’i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;

Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin- Autoritetet publike duhet t’i bëjnë përgatitjet që t’ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim; Të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipër përmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.

Konventa Espoo - Konventa Espoo përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Po ashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t’u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve.



Protokolli i Kievit - Është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, me që do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokolli është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi i Strategjik i Mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (VNM) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokolli poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit.

Protokolli kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillimi rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Protokolli lejon identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve të mundshme mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes duke zhvilluar politika të qëndrueshme të transportit se sa minimizimin e ndikimeve mjedisore në ndërtimin e rrugëve.

Protokolli i Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, kërkon nga palët e tij që të vlerësojnë pasojat e planeve dhe programeve të tyre zyrtare. Protokolli i Kievit ofron një pjesëmarrje të gjerë të publikut në vendimmarrjen e qeverisë në sektorët zhvillimorë. Protokolli i Kievit rëndësi të veçantë i kushton edhe shëndetit njerëzor.



3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

Qëllimi i raportit të VSM-së për Harten Zonale Komunale të Komunës së Glllogocit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis që mund të rezultojnë nga zbatimi, si edhe të japë alternativat e favorshme për zhvillimin në harmoni me mjedisin.

Si dhe të propozoj masat për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme nga zhvillimi i Hartave Zonale në Komunë.

VSM për Harten Zonale do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- Përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- Përshkrim të vizionit, priritetet dhe objektivave kryesore të Hartava Zonale dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritshëm të tij në rast se nuk zbatohet plani;
- Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me hartën zonale dhe PZHK;
- Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.
- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
- Përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.



4. Fazat Kyqe të procesit të VSM-së;

Faza	Përshkrimi
Shqyrtimi	Gjatë shqyrtimit identifikohet nevoja për VSM që zbatohet në një plan, program apo projekt specifik. Shqyrtimi si proces fokuson burimet tek ato plane, programe apo projekte të cilat mund të shkaktojnë efektet të konsiderueshme në mjedis dhe shëndet dhe përjashton nga procesi i VSM-së ato të cilat kanë ndikime të vogla ose nuk kanë fare ndikime.
Studimi i shtrirjes/ qëllimit të VSM	Cështjet e identifikuar gjatë studimit të shtrirjes/ qëllimit të VSM-së do të orientojnë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM-ja merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjëra mjedisore apo sociale, sic janë adaptimet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë për punësim etj. Qëllimi i kësaj faze është të përcaktohen cështjet kyqe që duhen adresuar në raportin e VSM-së.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese do të përbëjë bazën për vlerësimin e ndikimeve në mjedis dhe përpilimin e skemës së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme që të përvijohen tendencat e mundshme në të ardhmen – kështuqë duhet të bëhet analiza e tendencave në të kaluarën, me qëllim që të parashikohen zhvillimet që do të ndodhin në të. Vlerësimi i ndikimeve të pritshme nuk mund të bëhet pa kuptuarmirë gjendjen ekzistuese të cështjeve kyq të identifikuar në studimin e shtrirjes/ qëllimit të VSM-së.
Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse	VSM-ja analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. Një nga përfitimet kryesore prej VSM-së është se ai mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të një numëri projektesh të përfshira në dokumentin strategjik dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme akumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve të vogla individualisht, por të konsiderueshme të marra së bashku, që do të kryhen për një periudhë të caktuar kohore. Në vijim të rreziqeve dhe ndikimeve të identifikuar, VSM-ja sugjeron masa zbutëse



	për të adresuar efektet e pritshme negative si dhe për të rritur ndikimet pozitive që do të vijnë nga zbatimi i planeve, programeve apo projekteve përkatëse. Kjo fazë ka për qëllim të vlerësojë efektet e konsiderueshme negative dhe pozitive të planeve përkatëse dhe në vijim të konkluzioneve të analizës së ndikimeve, të marrë në konsideratë alternativa dhe opsione dhe të formulojë masat zbutëse për të parandaluar, reduktuar dhe sa më shumë të jetë e mundur të kompensojë cdo ndikim të konsiderueshëm negativ të planeve, programeve apo projekteve përkatëse.
Hartimi i Raportit të VSM-së	Raporti i VSM-së përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë procesit të VSM-së dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është pregaditja e një raporti të shkruar mirë dhe të kuptueshëm, i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në një mënyrë të qartë dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit.
Adoptimi	Jepet informacion mbi adoptimin e planit, programit apo projektit përkatës, si janë reflektuar komentet dhe sugjerimet e procesit të konsultimeve si dhe për metodat e monitorimit të efekteve të konsiderueshme mjedisore që vijnë nga zbatimi i planit, programit apo projektit përkatës.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për cdo efekt mjedisore të konsiderueshëm të paparashikuar.



Plani Zhvillimor Komunal, Plani Hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis kanë përcaktuar vizionin për mjedisin i cili përkufizohet si: Zhvillimi i qëndrueshëm i vendit duke mbrojtur pasuritë natyrore duke promovuar vlerat natyrore dhe duke mbrojtur ato nga ndotja dhe dëmtimi.

Fushat me theks të veçantë për trajtim në këtë raport janë:

- Trajtimi i zonës së Feronikelit
- Trajtimi i ajrit të ndotur
- Trajtimi i ujërave të ndotura;
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i vend-depozitimeve sipas standardeve të BE-së
- Mbyllja në zonat e ndryshme të vend-depozitimeve ekzistuese
- Rehabilitimi i tokave të ndotura dhe burimeve të ndotjes

Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit paraqet një plan të hapësirës së Glllogocit për vitin 2020-2028 si dhe janë trajtuar edhe gjatë hartimit të Hartave Zonale. Mbi bazën e programit të Qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, ajo përcakton edhe qëllimet të cilat në mënyrë të përmblendhur janë:

- Përmbushja e standardeve të kërkuara (BE, Organizata Botërore e Shëndetësisë - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbeturinat urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës;
- Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese apo substanca të cilat shkatërrojnë shtresën e ozonit, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;
- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona evropiane dhe ndërkombëtare;



- Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe
- Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve. Pothuajse të gjitha këto probleme mjedisore për të cilat Plani ka përcaktuar synimet, janë probleme me të cilat ndeshet edhe komuna e Gllogocit.

Për një vlerësim sa më real të gjendjes mjedisore në komunën e Gllogocit dhe luhatjen e saj në vite, krahas të dhënave për problematiken mjedisore të Komunës, informacione më të gjëra dhe sistematike të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, zhurmave, menaxhimit të mbetjeve etj, u gjeten në Raportet Planit Zhvillimor Komunal, VSM për PZHK dhe dokumenta e raporte tjera të nivelit qendrorë, të përgatitura nga institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

Konsultimet gjatë procesit të VSM-së;

Autoret e raportit të VSM-së ndaj Hartave Zonale Komunale (HZK)–se të Gllogocit kanë realizuar deri më tani dy takime me përfaqësues nga komuna e Gllogocit në kuadër të vlerësimit strategjik të HZK-së.

Nga takimet me anëtarë të komunës së Gllogocit, konkretisht nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, janë marrë informacione dhe të dhëna të ndryshme :

- Këto informacione dhe takime kanë ndihmuar grupin e hartimit të VSM-së, të fokusohet më mirë në zona të ndryshme siç janë Zona e Feronikelit, zona me dendësi më të madhe të popullsisë, hapësirat e gjelbra në vendet ku parashikohen zhvillime të caktuara infrastrukturore.
- Gjithashtu takime janë realizuar me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Mjedisit (MMPH) lidhur me problematiken mjedisore në komunën e Gllogocit, zonat e ndotura mjedisore (hot spote) dhe zonat me rendësi ekologjike.
- Këto takime kanë ndihmuar hartuesit e raportit veçanërisht në hartimin e kriterëve kufizues mjedisore.



5. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E GLLOGOCIT

Të dhënat për këtë kapitull janë bazuar në të dhënat e ofruara nga zyrtarët komunal nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit nga Komuna e Glllogocit dhe të dhënat e prezantuara në dokumentet lokale dhe nacionale për sektorin e mjedisit dhe për çështje socio- ekonomike të cilat janë relevante.

5.1. Pozita gjeografike dhe ndarja administrative

Komuna e Glllogocit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, konkretisht në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj, shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit, dhe është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Ka një sipërfaqe prej 275,63 km² me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë. Pjerrësia e terrenit është 10 – 35 %. Gjerësia gjeografike ku shtrihet komuna është 420° 32”, gjatësia gjeografike është 420° 64”.

Territori i komunës së Glllogocit në përgjithësi është i përbërë nga zona të rrafshëta, kodrinore dhe malore pra nuk ka territor uniform. Në pjesën qendrore shtrihet lugina e Drenicës, në lindje të së cilës shtrihen Çiçavica, Goleshi dhe Blinaja, ndërsa në perëndim Caraleva, Drenica dhe Kosmaçi. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër”.

E veçanta e rajonit të Drenicës është miniera dhe shkretorja e “Feronikelit”, si dhe disa gurore. Nëpër këtë komunë kalojnë lumi Drenica dhe Vërbicë, uji i të cilave shfrytëzohet për nevojat e ujitjes së tokave bujqësore.

Kjo komunë, në pikëpamje të ndërlidhjes tokësore lidhet më pjesët tjera të Kosovës më anë të hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugës magjistrale Prishtinë – Bushat (Komoran)-Pejë, dhe rrugët ndër komunale Shalë- Lipjan dhe Bushat-Glllogoc-Skenderaj.



Vendbanimi kryesor në komunën e Glllogocit është qyteti i Glllogocit me 7.210 banorë, gjersa, ka edhe 42 vendbanime të tjera rurale të banuara me 42.938 banorë. Komuna e Glllogocit është e ndarë në 35 zona kadastrale. Komuna ka 14.859 banesa dhe 11.787 ekonomi familjare. Të banuara janë 78.1%, gjersa të pabanuara 21.9%⁴. Pjesa dërmuese e vendbanimeve kanë strukturë homogjene etnike.

Popullsia - Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës, duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme. Në bazë të rezultateve të vlerësimit të popullsisë të realizuara nga ASK për vitin 2019, numri i banorëve në komunën e Glllogocit është 60,525 banorë, shtimi natyror (2019) ka qene 602, bilanci i migrameve (2019) -1,047.

Ekonomia - Komuna e Glllogocit është qendër me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, falë resurseve minerare si dhe falë tokës pjellore e cila ofron kushte të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore. Komuna e Glllogocit ka të regjistruara 4,028 biznese aktive, me rreth 90% prej tyre të regjistruar si mikro-ndërmarrje. Analizuar në aspekt të sektorëve ekonomik, shihet se numri më i madh i ndërmarrjeve, rreth 38% të tyre janë të regjistruara në sektorin e “Tregtisë dhe shumicë dhe pakicë”, pasuar nga sektori i “Ndërtimtarisë” (15%) dhe “Transporti dhe magazinimi” (13%). Kjo strukturë e ndërmarrjeve vërehet se nuk ka ndryshuar shumë ndër vite, dhe është e përafërt me strukturën e regjistrimit të ndërmarrjeve në nivel të Kosovës.

Industria është forca kryesore shtytëse e zhvillimit ekonomik në komunë (në veçanti që prej “Feronikeli” filloi të operojë në vitin 1984). Pjesëmarrja e “Feronikelit” në ekonominë e gjithmbarshme të Drenasit është 66.7%, e pasuar nga bujqësia, tregtia, ndërtimtaria, etj. Operatori Industrial “Feronikeli” punëson mbi 1,000 punëtorë dhe me të drejtë konsiderohet si një ndër prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë.

Pasuritë minerare dhe minierat - Komuna e Glllogocit është e pasur edhe me resurse minerale, ku përveç xehes së Feronikelit e cila është duke u eksploatuar dhe përpunuar në minierën e Çikatovës së vjetër dhe Gllavicës në Lipjan, si dhe përpunimin e tyre në shkritoren e Feronikelit, në territorin e Komunës së



Glllogocit janë të identifikuara edhe rezerva të konsiderueshme të Kromit, Linjtit, Hekurit, Donitit, Guri gëlqeror, Uji mineral etj. Të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e kapaciteteve të eksploatimit dhe përpunimit të tyre, të cilat njëkohësisht sjellin një mundësi për zhvillim ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve minerale dhe industria minerare janë ndër ndotësit me të mëdhenj të mjedisit në Komunën e Glllogocit.

Bujqësia - Sipas të dhënave statistikore kjo komunë ka në shfrytëzim 12,929 h tokë bujqësore e cila është e kategorizuar si tokë e punueshme, serra, livadhe, pemishte, vreshta, djerrina, kullota, pyje, si dhe kategori të tjera. Ndër kulturat bujqësore me dominuesë në Komunën e Glllogocit janë kulturat tradicionale gruri dhe misri, produkte këto me të cilat arrihen rendimente të larta. Viteve të fundit, fermerët e kësaj komune, kanë zhvilluar një bujqësi intenzive edhe me kultivimin e kulturave tjera bujqësore dhe profitabile si: patatja, lakra, luledielli etj., si dhe kultivimin e perimkulturave të ndryshme në ambiente të hapura dhe të mbyllura/ sera.

Trashëgimia Kulturore - Komuna e Glllogocit ka disa monumente të vjetra, ndërtesa religjioze si xhami e kisha, shtëpitë të ndërtuara në mënyrë tradicionale si dhe objekte të tjera të vjetra si ura të cilat duhet të ruhen dhe konservohen për shkak të vlerat të tyre kulturore.

Nga të gjitha kategoritë e trashëgimisë kulturore në Komunën e Glllogocit trashëgimia arkeologjike përfshin 7 asketë ndërsa ajo arkitekturale përfshin 11 objekte. Duke u bazuar në informata nga Komuna e Glllogocit, prej 11 objekteve të trashëgimisë kulturore që përfshin lista e përkohshme, 1 prej tyre është në gjendje të mirë, 1 në proces të ndërtimit, 3 në gjendje mesatare, 5 të dëmtuar dhe 1 fare nuk ekziston.

Gjetjet arkeologjike dëshmojnë që komuna e Glllogocit është një vend i vjetër. Këtë më së miri dëshmon prania e gjurmëve në fshatin Vuçak ku hasen rrënojat e mureve që përcjellin konfiguracionin e kodrës dhe formojnë Gradinën e Madhe (Gjymtët i Madh) dhe Gradinën e vogël (Gjymtët i Vogël). Duke u mbështetur në materialin arkeologjik që është gjetur këtu, janë dëshmuar gjurmë që nga parahistoria e deri tek mesjeta. Kalaja ishte tipike për kohën e antikitetit të vonë dhe shërbente si sistem mbrojtës për popullatën vendase.

Glllogoci, edhe pse komunë jo shumë e madhe megjithatë përfshin asketë të trashëgimisë kulturore-historike, materiale dhe shpirtërore të cilat veçohen për nga vlera, cilësitë dhe karakteristikat. Trashëgimia që posedon Glllogoci e sidomos ndërtesat e banimit shfaqin vërtetësinë e identitetit të shoqërisë dhe



konsiderohet që mund të kontribuojnë në zhvillimet të ardhshme. Këto asketë mund të jenë pika të pushimit që ofrojnë ushqim tradicional dhe të plotësojnë agjendat turistike regjionale apo më gjerë.

Në mesin e këtyre asketeve mund të veçohen: Kulla e Bibish Morinës - pronë e z.Ibish Morinës, gjendet në fshatin Çikatovë në komunën e Glllogocit dhe është ndërtuar nga fundi i shek. XIX. Shtëpia e banimit– Smajl Haxhiu, P+1 është ndërtuar në fillim në shek. XIX. Kompleksi i Banimi i Familjes Dervisholli gjendet në fshatin Gradicë të komunës së Glllogocit, i ndërtuar në shek. XVIII-XIX. Mulliri i Gani Sylës, në Kishnarekë gjendet në mes të fshatit Kshnarekë dhe i përket shekullit XIX. Mulliri i Gani Sylës – ana Veri – Lindore Shek. XIX Kishna Rekë, Glllogoc. Stacioni i Trenit në fshatin Dobroshec – gjendet në rrugën hekurudhore Prishtinë – Fushë-Kosovë – Pejë në fshatin Dobroshec.

Turizmi - Komuna e Glllogocit karakterizohet me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit vikendor, natyror, kulturore dhe rural. Gjeomorfologjia e territorit të komunës së Glllogocit e karakterizuar me masive malore, Çyçavica, Vargmalet e Berishës e Kosmaçi i japin vlerë konkurruese komunës së Glllogocit në Kosovë për zhvillimin e turizmit. Pozita qendrore e komunës së Glllogocit si dhe lokacionet interesante turistike sikurse janë Kalaja e Verbovcit, Liqeni i Vasilevës, lumenjtë Drenica dhe Verbica, Gryka e “Gurit të Plakës”, Guri i Gradinës, Kalaja e Vuçakut, Pishat e Glllobarit etj. janë vetëm disa nga resurse të vlefshme dhe mjaft atraktive për zhvillimin e turizmit.

Gjithashtu, edhe hoteleria është mjaft e zhvilluar, ku në komunën e Glllogocit janë rreth 60 biznese hoteliere, që prezantojnë një infrastrukturën aktuale për pritjen dhe sistemimin e turistëve.

Rëndësi dhe vlere tjera turistike në komunën e Glllogocit janë edhe objektet ose monumentet e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të krijuara në periudha të ndryshme historike si Kalaja e Verbovcit dhe Kalaja e Vucakut etj.

Gjithashtu vlerësohet edhe trashëgimia më e re që ka vlerë të veçantë si shumë lapidare të të rënëve për çlirimin e Kosovës, komplekse memoriale dhe monumente tjera të ndryshme që pasqyrojnë ofertën turistike në këtë komunë. Glllogoci është njohur edhe për organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore që mundë të tërheqin turistë të ndryshëm. I tillë është Festivalit të grupeve kulturo-artistike mbare shqiptare që është pa dyshim një prej manifestimeve më të vjetra si dhe Festivali i Grupeve Kulturo-artistike të shkollave fillore.



Edhe pse turizmi ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor të një zone, zhvillimi i tij i pakontrolluar ka ndikim negativ në mjedis e ne veçanti në ekosistemet natyrore si rezultat i hedhjes së pakontrolluar e mbeturinave, dëmtimit të resurseve natyrore dhe biodiversitetit. Me qëllim të zvogëlimit të këtij ndikimi krahas aspektit ekonomik, turizmi duhet ti kushtojë vëmendje edhe mbrojtjes së mjedisit, andaj si një formë e avancuar e turizmit sot njihet ekoturizmi apo turizmi i qëndrueshëm.

5.2. Gjendja e mjedisit

Ligji për VSM-në kërkon që Raporti i VSM-së të përfshijë një përshkrim të aspekteve relevante të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evulimin e saj të mundshëm pa zbatimin e planit ose programit, si dhe një përshkrim të çfarëdo problemi ekzistues mjedisor. Ky kapitull përmbush këtë kërkesë të Ligjit Nr.03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor .

Komuna e Glllogoci hynë në listën e komunave më pak të zhvilluara në vend për shkaqe të ndryshme duke përfshirë edhe luftrat e shumta që janë zhvilluar në këtë rajon e të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen ekonomike dhe mjedisore. Komuna e Glllogocit ka një mjedis relativisht të pastër, dhe shumë të pasur sa i përket biodiversitetit dhe pasurive natyrore, kulturore e historike, por ajo është larg nga të qenit jo e ndotur. Që nga pas lufta një ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohet kjo komunë është edhe ndotja e mjedisit. Ndotja e mjedisit është një problem mjaft serioz, prezent pothuaj në gjithë territorin e Kosovës e poashtu edhe në komunën e Glllogocit.

Ndotja dhe degradimi i mjedisit në këtë komunë bëhet më së shumti nga faktori antropogjen me veprimet e tij të cilat janë: Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, menaxhim jo i duhur i ujërave të zeza dhe mungesa e trajtimit të tyre, degradimi i pyjeve dhe prerjet ilegale në rritje, cilësia jo e mirë e ajrit në zonat urbane dhe mungese e inventarit të ndotësve të ajrit, cilësi dhe sasi e pamjaftueshme e ujit sipërfaqësor dhe ujit të pijes, trajtimi jo i duhur i mbeturinave, krijimi i vazhdueshëm i deponive ilegale nga qytetarë të papergjegjshëm, humbja e tokës me cilësi të lartë bujqësore nga zgjerimi i vendbanimeve dhe zonave industriale si dhe toka të degraduara që e zvogëlojnë vlerën e peizazhit rural, fragmentimi,



copëtimi dhe shëndërimi i tokës, mbrojtje jo e mjaftueshme e biodiversitetit, mungese e organeve menaxhuese për zona të mbrojtura dhe e planeve lokale për mbrojtjen e biodiversitetit.

Zbatim i pamjaftueshëm i VNM-së nga personat e licencuar nga Ministria e Mjedisit për planet, programet dhe projektet e nivelit lokal të cilat nese pergatitet nga profesionistet e fushës do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e qendrueshëm të komunës.

Fatkeqësishtë kjo Komunë përballet me problemin elementar për jetën e njeriut siç është qasja në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit është ende e kufizuar për shumë fshatra në Komunën e Gllogocit. Trashëgimia Kulturore dhe natyrore ka mbrojtje të pamjaftueshme.

Në projektet e shumta të infrastrukturës mungojnë korridoret ekologjike, të cilat mundësojnë ruajtjen e llojeve në zonat me potencial për biodiversitet të pasur.

Problem serioz për shëndetin e qytetarëve të kësaj komune është mungesë e vetëdijes mjedisore dhe pjesëmarrje e ulët në vendimmarrjen mjedisore.

Ndotja e ajrit dhe ndikimi në shëndet

Ndotja e ajrit në Komunën e Gllogocit paraqet një problem seirioz për jetën e qytetareve. Vlerat e larta të ndotësve të shkarkuar në ajër gjatë vitit 2019 e veçanërisht gjatë sezonës vjeshtë – dimër, kanë paraqitur probleme serioze në shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Nga të dhënat e cilësisë së ajrit për vitin 2019, të cilat janë paraqitur në raportin vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë, e në veçanti për Komunën e Gllogocit shpesh herë kanë qenë alarmante dhe sipas vlerësimeve edhe me ndikim negative në shëndet.

Niveli i lartë i ndotjes ka reflektuar edhe më numrin e madh të pacientëve me sëmundje respiratore dhe ato kardiovaskulare. Nga të dhënat e marrur nga QKMF (Qendra klinike të Mjekësisë Familjare) për sëmundjet respiratore dhe ato kardiovaskulare në Komunën e Gllogocit që përfshin Aglomeracionin AKS1, kanë rezultuar me një rritje të numrit të pacientëve me këto probleme shëndetësore në periudhën vjeshtë- dimer, numri i qytetareve me sëmundje respiratorë ka rezultuar me 27952 raste, ndërsa me sëmundje kardiovaskulare janë regjistruar 8445 raste.

Si ndotës të ajrit në Komunën e Gllogocit mundë të konsiderohen: aktivitetet nga operatori industrial Nëë Feronikeli, transporti, përdorimi i thëngjillit dhe drurit për ngrohje nga ekonomitë familjare, komerciale dhe institucionale, aktivitetet e gurëthyesve etj.



Kompleksi Industrial i New Co Feronikeli përbëhet nga Shkritorja dhe dy Miniera sipërfaqësore, ajo në Çikatovë dhe Gllavicë. Eksploatimi i xehes është sipërfaqësore, por kohë pas kohe bëhet edhe furnizimi me xehe nga importi. Me punën që bënë gjatë procesit të prodhimit të Fe-Ni metalik ky kompleks ndikon në lirim të pluhurit si dhe gazrave (CO, CO₂, SO₂, NO_x) të cilat kanë ndikim në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Sa i përket emisioneve në ajër nga burimet e ndryshme të ndotjes, Komuna e Gllogocit, nuk ka bërë ndonjë inventar të burimeve të ndotjes së ajrit dhe për këtë nuk mund të flitet me saktësi për burimet kryesore të ndotjes.

Në bazë të të dhënave të ofruara nga Komuna e Gllogocit si burime tjera të ndotjes në këtë komunë konsiderohet edhe ekonomitë familjare, institucionet publike dhe bizneset e vogla, që përdorin lëndë djegëse (thëngjill, dru, pëlet etj), për ngrohje, si dhe veturat.

Në komunën e Gllogocit në kuadër të pjesëmarrjes së burimeve energjetike që përdoren për ngrohje dominojnë thëngjilli dhe druri kundrejt peletit dhe naftës. Kjo pjesëmarrje e burimeve energjetike që përdoren për ngrohje është pothuajse e njëjtë si tek objektet publike po ashtu edhe tek objektet e ekonomive familjare (shtëpi dhe banesa).



Burimet e identifikuara të ndotjes së ajrit në Komunën e Glllogocit janë:

Lloji i burimit të ndotësit	Numri i njësive	Aktiviteti i ndotjes	Ndotësit që shkarkohen në Ajër
Objektet e ekonomive familjare (shtëpi dhe banesa)	4,028	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pëllet etj) për ngrohje	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO
Objektet publike (administrata, shëndetësore, arsimore, kulturore, sportive dhe sociale)	55	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pëllet, naftë etj) për ngrohje	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO
Objektet e bizneseve të vogla (furrat e bukës, kafe-restaurante, hotele, dyqane, shërbime tjera)	Rreth 280 objekte (50 shërbime, 60 hotele, 70 industri, 100 tjera)	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pëllet etj) për ngrohje	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO
Numri i automjeteve	9843	Përdorimi i produkteve të naftës për djege Vjetërsia e automjeteve	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO

Ndotja e ujit - Komuna e Glllogocit ka rezerva të pamjaftueshme ujore, ngaqë i takon pjesës qendrore të Kosovës, si rajon që njihet për reshje me të pakta. Lumi kryesor në Komunën e Glllogocit është lumi Drenica i cili edhe mbledh të gjitha rrjedhat tjera ujore. Komuna e Glllogocit ka hidrografi të varfër prandaj uji për pije shfrytëzohet nga Liqeni i Ujmanit.

Burime të ndotjes së ujrave sipërfaqësore në Komunën e Glllogocit janë:

- Ekonomitë familjare të kyçura në rrjetin e kanalizimit
- Institucionet publike të kyçura në rrjetin e kanalizimit
- Bizneset e kyçura në rrjetin e kanalizimit etj etj.



Ndotësit që shkarkohen në ujëra si rezultatet e shkarkimeve të lartë cekura janë: Nitratat, Fosfatet, substancat organike, metalet e rënda, mbeturinat etj.

Ndotja e tokës - Sot, më shumë se kurrë më parë, ekosistemet natyrore dhe shumëllojshmëria biologjike janë në një rrezik serioz. Sikurse edhe në shumicën e komunave të Kosovës duke përfshirë edhe Komunën e Glllogocit nuk ka ndonjë kontroll apo monitorim mbi përdorimin e pesticideve dhe substancave tjera kimike që kanë ndikim negative në mjedis e në mënyrë të veçantë në tokëdhe ujëra.

Një ndër burimet kryesore të ndotjes së tokës janë edhe industritë kimike, përdorimi jo racional i pesticideve dhe plehrave jo minerale, ndotja e tokës me materie radioaktive, ndotja e tokës me metale toksike si dhe ndotja e tokës me mikro organizma patogjen. Gjithashtu edhe humbja e shtresës cilësore të tokës nga procese natyrore të erozionit si dhe nga aktivitetet e njeriut sikurse është prerja e pakontrolluar e pyjeve konsiderohet si ndër faktorët kryesor të degradimit të tokave.

Drejtoria e Shërbimeve Publike për çdo vit e bën evidentimin e deponive ilegale dhe organizon pastrimin e tyre. Përveç ndotjes së drejtpërdrejtë, si një formë tjetër e degradimit të tokës është ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Po ashtu, problem të veçantë paraqet edhe degradimi i pyjeve përmes prerjes ilegale.

Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut). Aktualisht as operatorët ekonomik me potencial ndotës të mjedisit nuk e bëjnë monitorimin e rregullt të cilësisë së tokës (dheut). Në mungesë të të dhënave nga monitorimi i tokës/dheut, është e vështirë të bëhet një vlerësim i besueshëm.

Përgjatë rrugëve kryesore tokat e shumta janë duke u zënë nga objektet afariste pa një strukturë të mirëfillte të planifikimit. Ndotja nga metalet e rënda dhe shumë komponime organike është praktikisht e pakthyeshme (Komisioni Evropian, 2012). Dheu ka aftësi të kufizuar për të përpunuar kemikalet, për shembull nëpërmjet filtrimit apo transformimit.



Ekspluatimi i zhavorrit është shumë i shfaqur në Komunën e Glllogocit dhe atë shpesh guroret ndodhen në afërsi ngjitur me lumin Drenica, siç është rasti në Lagjen Cërvadiku, në zonën kadastrale të Poklekut dhe Çikatovë të Vjetër.

Ndotja shkaktohet edhe nga deponitë ilegale, ndonëse numri i tyre është zvogëluar dukshëm viteve të fundit. Nga 80 deponi që janë eliminuar, mbetin edhe rreth 31 ekzistuese në territor të komunës.

Ndotja akustike - Sa i përket ndotjes akustike nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në Komunën e Glllogocit, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme.

Fakti që përmes territorit të komunës kalon rruga magjistrale Komoran – Drenas - Skënderaj si dhe rrugët regjionale, do të thotë se komuna është e ndikuar nga zhurma. Burimet kryesore të zhurmës në Komunën e Glllogocit janë: Fabrika e Feronikelit, trafiku rrugor dhe ai hekurudhor.

Në mënyrë të veçantë këto burime të zhurmës intensifikohen gjatë zbatimit të aktiviteteve të ndryshme të ndërtimit, transporti i mallrave operimit të gurëthyesit, përdorimi i pajisjeve industriale e tjera. Për asnjë nga këto burime të zhurmës nuk ka barrier ekologjike që do të reduktonin nivelin e zhurmës dhe ndikimin e saj tek banorët e zonave ku shtrihen këto burime.

Ndotja nga mbeturinat – Komuna e Glllogocit gjatë viteve të fundit është duke shënuar progres në procesin e menaxhimit të mbeturinave. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në komunën e Glllogocit aktualisht shtrihen në të gjitha vendbanimet e komunës, mirëpo nuk përfshinë të gjitha ekonomitë familjare. Nga numri i përgjithshëm i ekonomive familjare të komunës së Glllogocit (8681 ekonomi familjare), rreth 6024 ekonomi familjare ose 80% e tyre janë të përfshirë me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Në qytet mbledhja e mbeturinave bëhet për çdo ditë, në fshatra 1 herë në javë. Grumbullimi bëhet përmes 102 kontejnerëve me vëllim prej 1,1m³, 6 kontejnerë të madhësisë 7 m³, e në fshatra grumbullimi bëhet përmes 6095 shportave prej 120 l dhe 72 shportave të madhësisë prej 240 litrave.

Në Komunën e Drenasit në ditë grumbullohen dhe zbrazen 30 tonë mbeturina. Sasia e deponimit të mbeturinave për kokë banori në vit është 105.7 kg. Arkëtimi për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave është rreth 87 %. Komuna e Glllogocit ka një qendër të transferit për grumbullimin e mbeturinave, pas grumbullimit në këtë qendër mbeturinat dërgohen në Deponin Sanitare në Mirash.



Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin ende një ndër problemet kryesore në sektorin e mbeturinave në këtë komunë. Janë evidentuar 137 deponi ilegale, prej tyre mbi 80 janë të rehabilituar. Sa i përket riciklimit Komuna e Glllogocit, ende nuk ka arritur të realizojë ndonjë program të organizuar në tërë territorin e Komunës. Ekzistojnë disa iniciativa të vogla të mbështetura nga donatorët dhe të implementuara nga organizatat joqeveritare. Në kuadër të këtyre iniciativave ka filluar edhe procesi i ndarjes së mbeturinave në burim, në 16 pika të grumbullimit të mbeturinave në qytet. Ka disa iniciativa të vogla edhe për kompostimin e mbeturinave organike komunale kryesisht përmes shpërndarjes së komposterëve familjarë. Komuna përmes një vendimi Nr.383-29533 të datës 05.06.2014, ka adresuar edhe problemin e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit. Përmes këtij vendimi komuna ka caktuar zonën e quajtur Rudishte në zonën kadastrale të Komoranit si lokacion për deponimin e këtyre mbeturinave.

Zonat e mbrojtura – Duke iu referuar të dhënave nga Raporti për Gjendjen e Natyrës 2015-2017 të AMMK-së, numri i zonave të mbrojtura në Komunën e Glllogocit është trembëdhjetë. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 3 Monumente të Natyrës me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik, 8 Monumente të Natyrës me karakter botanik, 1 Monument i Natyrës me karakter hidrologjik, dhe 1 Monument i Natyrës me karakter gjeomorfologjik.

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e Natyrës, natyra dhe vlerat e trashëgimisë natyrore janë me interes për Republikën e Kosovës dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Monumenti i natyrës- Monumenti i natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike. Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukturë gjeologjike, sediment etj, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore. Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.




Peizazhi i mbrojtur - Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike, ose peizazh me veçori të ruajtura unikale karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion. Në peizazhin e mbrojtur nuk lejohen ndërhyrjet dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilit është shpallë i mbrojtur.

Zonat e mbrojtura në Komunën e Gllogocit janë:

- *Shpella e Baicës* – Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik;
- *Shpella e Gllanasellës* – Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik;
- *Trungjet e rrënjës (Quercus robur) në Nekovc* – Monument natyror me karakter botanik;
- *Kompleksi i trungjeve të rrënjës (Quercus robur) në Negroc* – Monument Natyror me karakter botanik;
- *Trungjet e shpardhit në Negroc* - Monument natyror me karakter botanik;
- *Shpella e Kishnarekës* - Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik;
- *Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Krajkovë* - Monument natyror me karakter botanik;
- *Guri i Gradinës në Llapushnik* - Monument natyror me karakter gjeomorfologjik;
- *Burimi i ujit mineral, në Poklek* - Monument natyror me karakter hidrologjik;
- *Trungjet e dushkut - Gjashtë lisat (Quercus sp.) në Likoshan* - Monument natyror me karakter botanik;
- *Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Tërstenik* - Monument natyror me karakter botanik;
- *Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoshan* - Monument natyror me karakter botanik;
- *Guri i plakës në Dobroshec* - Monument natyror me karakter botanik;

Komuna e Glllogocit (Drenasit) 2020
Vleresimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale



Harta e zonave të mbrojtura ne komunën e Glllogocit

Monumentet natyrore në Komunen e Glllogocit janë duke u ballafaquar me problemet mjedisore të cilat kanë ndikim negativ me pasojat të pariparueshme si: Mungojnë investime në infrastrukturë në përputhje me

standarde dhe normat europiane, (ulëse, shtigje, lokacioni për mbeturina, shenjëzimi, ndriqim). Deri te keto monumente shkohet me veshtirësi pasi nuk kanë çasje adekuatë në monumente të natyrës dhe deri tek shpellat, mungon hartimi i planeve menaxhuese, nuk kanë mirëmbajtje zonat e mbrojtura, nuk ka projekte aktuale të cilat lidhen me hulumtimin dhe studimi i mëtejshëm të shpellave të cilat paraqesin atraksion për vizitorët dhe ndikojnë në zhvillimin e turizmit të komunës.

Dëmtimi i vazhdueshëm i zonave të mbrojtura mund të rezultojë me humbjen e tyre. Ndikimet e tilla dhe mungesa e përkujdesjes institucionale e shkencore janë duke bërë që këto monumente natyrore të humbin përgjithmonë karakteristikat e tyre natyrore për të cilat janë vënë nën mbrojtje.



Peizazh në Liqenet e Vasilevës

Liqenet e Vasilevës janë atraksion me biodiversitet që e pasuronë territorin e Komunës së Gllogocit me një biodiversitet të pasur bimor, shtazor dhe peisazhor. Për shkak të këtyre vlerave që disponon kjo zonë, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, ka hartuar një arsyeshmëri dhe ka propozuar shpalljen e kësaj zone si Peisazh i Mbrojtur i Natyrës.



Zona e propozuar për mbrojtje e Peizazhit të Mbrojtur “Liqenet e Vasillevës” përfshinë një sipërfaqe të përgjithshme prej 320.9 ha. Edhe pse këto janë liqene artificiale të krijuara me depozitimi i materialit (dheut) nga mihjet sipërfaqësore në Bardh dhe Mirash nga Korporata Elektroenergjetike e Kosovës në vitet e ‘60 te shekullit të kaluar, ato paraqesin zonë të rëndësishme të natyrës dhe me potencial për zhvillimin e turizmit. Mbi 53 lloje bimore janë gjetur gjatë hulumtimeve në teren, prej tyre më të zakonshme kanë qenë: *Ajuga reptans* (fam.Lamiaceae), *Fragaria vesca* (fam.Rosaceae), *Tilia cordata* (Tiliaceae), *Ornithogalum umbellatum* (fam.Liliaceae), *Papaver rhoeas* (fam.Papaveraceae), bashkësit e *Phragmitis australis* etj. Liqenet e Vasilevës shquhen si zonë e pasur edhe nga aspekti i zoodiversitetit. Sipas hulumtimeve në atë zonë, është konstatuar se jetojnë një numër i konsiderueshëm i llojeve shtazore. Liqeni jo vetëm që shërben si habitat për rritjen e peshqve dhe llojeve tjera por ai në të njëjtën kohë është mjaftë tërheqës edhe për një numër të madh të zogjve, në këtë zonë dhe në afërsi të saj gjenden një numër i konsiderueshëm i llojeve të shtazëve të egra sipas kategorive përkatëse. Gjyhetarët ilegale dhe e pa kriter në këtë zonë ka ndikuar që një numër i madh i llojeve të shpendëve që kanë jetuar më parë në këtë zonë tani mos të hasen. Liqenet e Vasilevës janë vend shumë i përshtatshëm për rritjen dhe shumimin e peshqve, kjo tregohet edhe nga prania e madhe e disa llojeve të peshqve që tërheq një numër të madh të peshkatarëve gjatë tërë vitit. Nga llojet e pranishme në basene numërohen: *Cyprinus carpio* (Krapi), *Carassius auratus gibelio* (Karashi i artë), *Tinca tinca* (Tinka), *Esox lucius* (Peshku shpatë) dhe *Rutilus rutilus* (Sykuqi).

Një zonë tjetër pasuri natyrore me rëndësi për Komunën e Glllogocit janë Bjeshkët e Çyçavicës. Kjo zonë përmes një memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga komunat ku shtrihen këto bjeshkë (Glllogoc, Obiliq, Skenderaj, Mitrovicë dhe Vushtri) është shpallur si zonë e interesit të përgjithshëm me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore të kësaj zone.

Biodiversiteti - Viteve të fundit nga territori i komunës së Drenasit janë raportuar disa gjetje të reja të insekteve ujore për faunën e Kosovës. Nga rendi i inskteve Plecoptera 6 lloje (*Nemoura anas*, *Nemoura peristeri*, *Nemoura asceta*, *Nemoura vinconi*, *Protonemoura beaumonti* dhe *Brachyptera macedonica*) janë gjetja të reja për faunën e Kosovës të mbledhura në Bjeshkët e Berishës. Këto lloje kanë përhapje të kufizuar dhe janë shumë të rralla 3940. Lloji *Limnephilus fuscicornis* është gjetje e re për faunën e Kosovës nga rendi i insekteve Trichoptera i mbledhur në lumin Drenica gjithashtu nga ky rend i inskteve lloji *Limnephilus bipunctatus* është raportuar gjetje e re për faunën e Kosovës (i mbledhur në fshatin Shtuticë).



Flora dhe vegjetacioni i territorit të Komunës së Glllogocit - Territori i Glllogocit ka florë dhe vegjetacion relativisht të pasur mirëpo në degradim e sipër si pasojë e veprimit negative të faktorit antropogjen (sidomos në hapësirat rreth vendbanimeve) dhe se në shumë lokalitete të territorit të Glllogocit duhet të bëhen intervenime pozitive drejt normalizimit të gjendjes natyrore duke bërë pyllëzimin me llojet adekuate. Territori i komunës së Glllogocit zë një vend të rëndësishëm në Kosovë nga aspekti floristik dhe vegjetativ. Sipas të dhënave që disponojmë, territori i komunës së Glllogocit i takon Rajonit Eurosiberiko – Amerikanoverior i cili përfshinë viset kontinentale të vendit, e që ndahen ndërmjet rajoneve kufitare mediterane nga njëra anë dhe majave më të larta të masiveve malore të cilat i takojnë regjionit Alpiko – Nordik nga ana tjetër.

Pyjet - Rajoni i Drenicës konkretisht komuna e Glllogocit është e pasur me resurse pyjore dhe përfshinë një sipërfaqe prej 11,355.00 ha. Zona malore është shpallur zonë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, ripyllëzim, rekreacion dhe turizëm. Zonat me të rëndësishme pyjore shtrihen në malet e Berishës, Kosmaç dhe në Çyçavicë. Në territorin e Glllogocit janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile.

Komuna e Glllogocit prezantohet me dy province fitogjeografike të cilat janë:

- Provinca Mezike, e cila përfshinë shpatet e Malit të Çyçavicës në kuadër të së cilës hyjnë pyjet lëvorbardha dhe pyjet lëvorzeza të brezit malor (montan) dhe paramalor (submontan) e që në këtë territor paraqitet konkretisht me pyje të bungut dhe shkozës (Querco – Carpinetum Rud.) dhe pyjet kodrinore dhe malore të ahut (Fagetum montanum Rud.)
- Në territorin e Glllogocit janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile; të prezantuara në bashkësi të ndryshme të cilat ndërmjet tyre dallohen në bazë të përbërjes floristike si pasojë e kushteve të ndryshme ekologjike.

Në territorin e Glllogocit janë prezente këto bashkësi (asociacione) pyjore:

- Ass. Carpinetum orientalis scardicum, Krasniqi (Bashkësia e shkozë së zezë),
- Ass. Quercetum farnetto – cerris scardicum, Krasniqi (Bashkësia e shpardhit dhe qarrit), e përhapur kryesisht në lartësi mbidetare deri në 750 m,
- Ass. Quercetum montanum, Çer. et Jov. (Bashkësia e dushkut malor), në lartësi mbidetare prej 630 – 960 m, e përfaqësuar kryesisht nga bunga (Quercus petraea),
- Ass. Fagetum montanum Rud. (Bashkësia e ahut).



- Në zonën përreth Gurit të Gradinës në të gjitha ekspozicionet është prezentë fitocenoza *Fagetum Montanum* me rreth 47 lloje që kanë një shtrirje mjaft të gjerë përreth monumentit.

Fauna në territorin e Glllogocit - Si rezultat i aktiviteteve antropogjenë e sidomos ato gjatë shëndërrimit të hapësirës natyrore në territor agrikulturor, industrial apo territor për banim disa lloje shtazore të cilat kanë ekzistuar në këto zona janë zhdukur ose zhduken.

Lloje të cilat janë zhdukur kohë më parë nga këto terrene janë: *dreri*, *dhia e egër*, *pulelegra* etj. Llojet prezente janë më rezistente ndaj kushteve të ofruara apo të imponuara por edhe te këto lloje vërehet zvogëlimi i numrit të tyre.

Llojet të cilat ende hasen në territorin e Glllogocit janë: ariu (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), qelbësi i rëndomtë, derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), ketri (*Sciurus vulgaris*), sqarthei (*Martes foina*), vidra, lepuri (*Oryctolagus cuniculus*), disa lloje të brejtësve të vegjël, gjeraqina, skifteri i përhimtë, petruti (*Falco tinnunculus*), kukuvajka, huti (*Bubo bubo*), harabeli, thëllënza (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër, kumria, disa lloje të korbave, çukapiku (*Dendrocopus major*), qyqja (*Cuculus canorus*), lauresha, borësi, rosat e egra (*Anser anser*), patat e egra (*Anas platyrhynchos*), lejlekët (lloje kalimtare dhe hasen rrallë), breshka e kënetave, breshka e pyjeve, hardhuca e përhimë, hardhuca e mureve, hardhuca e gjelbër, neperka, gjarpëri i larmë, gjarpëri i ujit (johelmues), picrraku (*Salamandra atra*), tritoni (*Triturus vulgaris*), bretkosa e gjelbërt, bretkosa dregëzore, krapë (*Cyprinus caprio*), fildishi, skobusi, shumë lloje të pakurizorëve etj.

Në zonën përreth Guri i Gradinës, sipas të dhënave që posedon AKMM në këtë hapësirë hasen këto lloje shtazore: *8 lloje gjitarësh*, ndërsa dy lloje të tjera të gjitarëve janë zhdukur, *9 lloje shpendësh*, *4 lloje zvarranikësh*, *2 lloje ujë-tokësor*.

Gjatë Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Komunën e Glllogocit me theks të veçantë janë përfshirë këto komponente mjedisore:



<i>Elementet e përfshira në VSM</i>	<i>Kategoritë e përdorura gjatë vlerësimit Strategjik Mjedisor</i>
Toka	Toka(përfshirë shfrytëzimin e tokës, zona të rëndësishme gjeologjike, ndotja e tokës dhe masat për mbrojtjen e tokës.
Uji	Burimi dhe cilësia e ujit (përfshirë ujërat e freskët të sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësor, lumenjtë, erozioni)
Ajri	Cilësia e ajrit, kualiteti i cilësisë së ajrit – monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit
Popullsia	Popullsia (numri i popullsisë, përfshirë efektet socio-ekonomike dhe qasja)
Shëndeti i popullsisë	Shëndeti i popullsisë, mbrojtja e shëndetit
Faktorët klimatikë	Ndryshim i klimës (përfshirë emetimet e gasrave të serrave, efektet e parashikuara nga ndryshimi i klimës sikur: përmytjet dhe aftësitë për t'u përshtatur- adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike
Mbeturinat	Menaxhimi i qëndrueshem i mbeturinave
Ujërat e zeza	Trejtimi i ujërave të zeza
Trashëgimia natyror, kulturore, historike dhe arkeologjike	Trashëgimia natyrore (monumentet e natyrës) si dhe trashëgimia kulturore (përfshirë trashëgiminë arkologjike dhe arkitektonike)
Peizazhi	Peizazhi dhe pamja e qytetit
Bujqësia	Menaxhimi i tokave bujqësore dhe shfrytëzimi i tyre
Biodiversiteti, (bota bimore dhe bota shtazore);	Ruajtja e biodiversitetit dhe natyrës (që përfshinë botën bimore dhe shtazore, dhe funksionimi i ekosistemeve) etj.
Erozioni	Ruajtja e tokës nga erozioni.
Zhurma	Ndikimi i zhurmës, masat për mbrojtjen nga zhurma.



6. IDENTIFIKIMI I VEPRIMEVE STRATEGJIKE NË MJEDIS

Parashikimi për ndikim

➤ Metodologjite për vlerësimin e ndikimeve

Metodologjia që është aplikuar për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimit strategjik mjedisor është planifikuar të marrë në konsideratë natyrën e ndryshme të ndikimeve bio-fizike, social-ekonomike, dhe ndikimet mjedisore. Ndikimet bio-fizike në këtë kontekst janë me të përhapura në kuadrin e përcaktimit të kufijve dhe limiteve si dhe përcaktimit të sasisë, ndërsa ndikimet social-ekonomik janë potencialisht me të përhapura dhe janë objekt i një përqasje cilësore. Në paraqitjen e përgjithshme të rëndësisë së ndikimeve rezultatet që dalin nga kjo metodologji paraqesin një përmbledhje të hartuar të ndikimit mjedisor dhe social.

NDIKIMET BIOLOGJIKE


Në këto zona gjatë fazës së aktiviteteve të ndërtimit ka disa ndikime të vogla të cilat do të paraqiten siç janë: marrje e përkohshme dhe e përhershme e tokës, ndarje e përkohshme e habitateve dhe ndryshime në hidrologjinë sipërfaqësore dhe nëntokësore, depozitimin e materialeve në sheshe, ndotja apo derdhjet aksidentale të karburantit e materialeve të tjera, depozitimi i pluhurit (psh mbi gjethe apo sipërfaqen e dheut), shqetësim i specieve nga zhurma, dridhjet dhe drita, shqetësim jo-specifik për specie (psh zogjtë) për shkak të pranisë së punëtorëve dhe makinerive të ndërtimit.

Ndikimet kryesore që do të shfaqen gjatë fazës së shfrytëzimit janë: marrje e përhershme e tokës nga ndërtimi i strukturave të reja, ndryshime të përhershme në hidrologjinë sipërfaqësore dhe nëntokësore, degradim i dherave prej derdhjeve nga shfrytëzimi etj.



6.1. Toka

Në Komunën e Gllgocit shfrytëzimi i tokës është kategorizuar në bazë të zonave të cilat kanë vlera dhe potenciale të caktuara për zhvillim ekonomik, si: Zona Pyjore, Zona Bujqësore për konsum privat dhe tregtar, Zona Rekreatike, Zona Komeriale dhe Industriale, Zona Turistike, Sipërfaqet Ujore, Zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujërave të pijshëm, Zona e rezervave Minerare dhe Fusha e eksploatimit, Zonë banimi me dendësi shumë të ulët, Zonë banimi me dendësi të ulët, Zonë banimi me dendësi të mesme, dhe Zonë banimi me dendësi të lartë.



HARTA 1: HARTA ZONALE E SHFRYTEZIMIT TË TOKËS

Zonat mbishtresore janë: Sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore, Zona mbishtresore e ndikuar nga Vërshimet, Akuiferifet, Zona për mbrojtje nga Erozioni, Zona mbishtresore me ndotje të lartë(hot spotet), Zona për mbrojtje nga fatkeqësitë tekniko-teknologjike, Zona për mbrojtje nga zjarret, Zona për mbrojtje nga termetet, Zona e interesit të veçantë dhe Zonat natyrore. Zonat mbishtresore janë zonat në të



cilat vendosja e kushteve zhvillimore është më strikte dhe me masa mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike.


Vlerësimi i Ndikimeve në Mjedis - Shfrytëzimi i Tokës në Zonën Urbane

Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor është hartuar duke analizuar secilin komponent të mjedisit dhe ndikimet potenciale të veprimeve (aktivitetetve) për shfrytëzimet e lejuara të tokës në Komunën e Glllogocit, bazuar në legjislacionin përkatës për mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara në Komunën e Glllogocit ka potencial për ndikimet negative në tokë, dëmtim të strukturës së tokës dhe cilësive fizike të saj duke përfshirë humbjen e habitatit tokësor dhe shqetësimin e saj, nga fazat ndërtimore. Potencial erozioni në kohë me reshje në sipërfaqet ku do të zhvillohen punimet, emitime të pluhurit, rrezik nga derdhjet aksidentale të vajrave lubrifikuese, gjenerim të mbeturinave etj.

Masat që duhet ndërmerren për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Emetim i pluhuri si rezultat i punimeve për çdo veper ndikimi mbi tokë duhet jenë të moderuara, maksimumi i mundshëm i lejuar. Zona që do të shfrytëzohet si vend depozitues për mbetjet e ndërtimit duhet të jetë e zhveshur dhe larg zonave me vegjetacion apo pranë zonave të ndjeshme. Vajrat lubrifikuese duhet të grumbullohen në një mjedis të izoluar dhe të shtruar për të shmangur ndotjen e tokës nga pikimet. Menaxhimi i duhur i mbeturinave etj.



HARTA 2: HARTA ZONALE E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS (ZONA URBANE, GLLOGOCIT)

LISTA E ZONAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GLLOGOCIT SIPAS HARTËS ZONALE

Sipas Hartës Zonale teritori i Komunës së Glllogocit është ndarë në këto zona:

- Zona Pyjore (ZP),
- Zona Bujqësore për Konsum Privat dhe tregtar (ZBKPT),
- Zona Rekreative (ZR),
- Zona Komeriale dhe Industriale (ZKI),
- Zona Turistike (ZT),
- Sipërfaqet Ujore (SU),
- Zonat e Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujërave të Pijshë (ZMS),
- Zona e Rezervave Minerare dhe Fushat e Eksploatimit (ZRM),
- Zonë Banimi me Dendësi shumë të Ulët (me funksione tjera ne pajtueshmëri)(ZBUR),
- Zonë Banimi me Dendësi të Ulët (me funksione tjera ne pajtueshmëri) (ZBUU),




- Zonë Banimi me Dendësi të Mesme (me funksione tjera në pajtueshmëri) (ZBMU),
- Zonë Banimi me Dendësi të Lartë (me funksione tjera në pajtueshmëri) (ZBLU),

ZONAT MBISHTRESORE

- Zona Mbishtresore: Sipërfaqet e Mbrojtura të Trashëgimisë Kulturore (ZMTK),
- Zona Mbishtresore E ndikuar nga Vërshimet (ZMNV),
- Zonat Mbishtresore: Akuiferifet (ZMAK),
- Zona Mbishtresore :Për mbrojtje nga Erozioni (ZME),
- Zona Mbishtresore : Me ndotje të Lartë (Hot Spotet) (ZMH),
- Zona Mbishtresore Për mbrojtje nga Fatkpeqësitë Tekniko-Teknologjike(ZMMFTT),
- Zona Mbishtresore Për mbrojtje nga Zjarret (ZMMZ),
- Zona Mbishtresore Për mbrojtje nga Tërmetet (ZMMT),
- Zona Mbishtresore: Zonë e interesit të Veçantë (ZIV),
- Zona Mbishtresore: Zonat Natyrore (ZN),

6.2. ZONA PYJORE

Janë ekosisteme më të përparuara natyrore dhe kanë rendësi shumë të madhe sepse ato janë ekosisteme me biodiversitet shumë të pasur. Pyjet janë rregullatorë natyrore të klimës, ruajnë kualitetin e ujit, ajrit, ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe nga shpëlarja e shtresës produktive të tokës. Pyjet po ashtu, janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së CO₂ në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me Oksigjen. Janë resurse natyrore të ripertritshme, produktet e te cilit mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rendësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Pyjet përveç se pengojnë erërat e fuqishme janë edhe ambient relaksimi dhe çlodhës për njeriun.



HARTA 3: ZONA PYJORE

Në Komunë e Glllogocit zonë me rëndësi të madhe është Zona Pyjore e cila kërkon çasje të drejtë dhe menaxhim të qëndrueshëm të saj duke pasur parasyshë rëndësinë jetike për shëndet dhe të mirat materiale, rekreative, shëndetësore dhe turistike që ofron kjo zonë.

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Pyjore - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Komponenti mjedisor	Potenciali për ndikim negative	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Toka	Potencial për ndikim ekziston tek toka pyjore nga aktivitetet sipas HZK.	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i ndërtimeve të reja objekteve turistike	Të zbatohen parimet e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit; Largimi i deponive ilegale të mbeturinave të krijuara gjatë zhvillimit të aktiviteteve të lejuara; Caktimi i lokacioni për mbeturina;



		me sisitem jo adekuat të trajtimit të ujërave të zeza, pa lokacion të mbeturinave, prerja e drunjëve, zjarret, perdorimi i pesticideve, gjatë kryerjes së punëve ndërtimore, transportit të materialeve, perdorimit të makinerive etj.	Transportimi i mbeturinave të forta në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Gjatë punëve ndërtimore të lejuara, ndërimi i vajrave te makinerive punuese-transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik.
Ajri	Potencial për ndotje të ajrit është minimal	Shtëpitë malore, ndertesat mbështetëse, infrastruktura blegtorale, shtigjet për ecje.	Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje; Reduktimi i ndotjes së ajrit duke përdorur konvertorë katalitik për automjetet e vjetra;
Uji	Potencial relativ	Menaxhimi jo i duhur i mbeturinave ndërtuese, si dhe gjatë transportit të materialit ndërtues (vajra lubrifikant, karburant) nga mjetet transportuese.	Për menaxhimin më efikas të ujërave Komuna e Glllogocit duhet të koordinohet me aktivitetet, vendimet, masat dhe qëllimet e vendosura nga niveli qendror e sidomos nga Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e ujërave.
Flora dhe Fauna	Potencial relativ	Zhdukja e llojeve të veçanta bimore dhe shtazore karakteristike për zonën.	Ruajtja e laramisë biologjike të pyjeve dhe ekonomizimi me pyje bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbajtjen e sistemit natyror të llojeve dhe përtrritjen e tyre natyrore; Për të ruajtur laraminë biologjike të pyjeve, lejohet përdorimi i mjeteve biologjike dhe bioteknike për mbrojtjen e bimëve; Grombullimi i bimëve pyjore të kontrollohet dhe të bëhet sipas standardeve europiane; Të mos dëmtohen gjatë mbledhjes kërpudhat dhe frutat e egra; Ndalohej vjelja, mbledhja dhe shkatërrimi, prerja ose shkëlqja e bimëve dhe kërpudhave strikt të mbrojtura të cilat mbijnë vetë; Ndalohej tregtia me llojet e bimëve dhe kërpudhave strikt të mbrojtura të cilat mbijnë vetë dhe janë në listën e kuqe të Florës së Kosovës;



			Të kontrollohet gjuetia e llojeve të veçanta dhe të mbrojtura me ligj; Kafshët strikt të mbrojtura që lirshëm jetojnë në natyrë ndalohet: të merren nga natyra, të vriten me qëllim, të dëmtohen /ose shkatërrohen me qëllim format e zhvillimit, çerdhet ose strofkat si dhe zonat e shumëzimit dhe pushimit të tyre; Ndalohet të shqetësohen gjatë kohës së shumëzimit, rritjes së të vegjëlve, migrimit dhe dimërimit; Ndalohet përdorimi i mjeteve për kapjen dhe vrasjen e llojeve të egra si dhe shfrytëzimi i të gjitha mjeteve të cilat mundën me shkaktë zhdukjen lokale ose shqetësime serioze të populacioneve në pyje. Të kontrollohet shfrytëzimi i mineraleve; Të kontrollohet peshkimi; Ndalohet peshkimi i llojeve të veçanta të peshqve dhe të rrezikuar për tu zhdukur.
Peizazhi	Potencial për ndikim minimal	Sipërfaqja ku do të kryhen aktivitetet e lejuar është e vogël, dhe kjo mund të ndikoj në shkallë mikrosistemi. Peizazhi lokal do të ndryshohet, nga tokë pyjore në tokë të ndërtuar me objekte mbështetëse të cilat janë në funksion të prodhimit të pyjore.	Për të ruajtur karakterin peizazhor të zonës, e veçmas ndikimin të komunitetit lokal, lokacioni ku lejohen shfrytëzimet e lejuara të zonës duhet të rrethohet me rrethoje të gjelbër ose me bimë të kultivueshme gardh natyror (bli dhe pisha dekorative) ose bimë karakteristike të zonës pyjore.
Mbeturinat	Potencial relativ	Ndikime negative mund të paraqiten nëse nuk menaxhohen si duhet mbeturinat e shkaktuara nga aktivitetet e	Evitimi dhe reduktimi sa më i madh i mundshëm i gjenerimit të mbeturinave; Ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; Të caktohet lokacioni për mbeturina; Zgjerimi i mundësive për riciklimin të mbeturinave; Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave;

Komuna e Glllogocit (Drenasit) 2020
Vleresimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale




		lejuara sipas Hartes Zonale.	Mbeturinat e forta duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme; Të zbatohet UA-nr.15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave; Të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese; Të zbatohet UA-nr. 06/2018 Për ndeshkimet me gjoba mandatore;
Zhurma	Potencial relativ	Ndotja akustike është dukuri prezente si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda, nga kryerja e punëve ndertimore ose montuese te lejuara sipas HZK-së.	Niveli i zhurmës duhet te jetë nën kufijtë e standardit dhe gjatë punës nuk duhet të kalon 40 Db sipas standardeve ndërkombëtare dhe dispozitave ligjore qe tani janë në fuqi; Makineritë me të cilat operohet për transport, të jenë të kontrolluara teknikisht; Të shmangen operimet me makineri të rënda gjatë orëve të mbrëmjes;
Shëndeti i popullatës	Potencial relative	Ndotja e ajrit, ujit, tokës, ndotja me mbeturina.	Gjatë realizimit te aktiviteteve të lejuara duhet të përdoret sistemi i ujitjes për të minimizuar sasinë e pluhurit të liruar në mjedis. I tërë materiali ndërtues, duheet të mirëmbahet sipas standardeve për ruajtje e mjedisit Mbeturinat e gjeneruara duhet të largohen në mënyrë të rregullt nga punëtorët;
Faktorët Klimatik	Potencial relativ	Energja e prodhuar nga thëngjilli, shfrytëzimi i produkteve, mbeturinat, bujqësia dhe shfrytëzimi i tokës.	Mbrojtjen nga përmbytjet, thatësitat, menaxhimin e pyjeve dhe biodiversitetit, menaxhimin dhe shkëmbimin e informatave, ngritjen e kapaciteteve, trajnime dhe ngritjen e vetëdijes; Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencë të Energjisë 2010-2018; Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER) 2011 – 2020; Rindërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të ngrohjes qendrore;
Rrezik nga Erozioni	Potencial relativ	Prereja e drunjëve, djegja e pyjeve, ndërtimi i pa rregullt,	Të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020;



		zhvillimi i infrastrukturës.	Kufizimin ose ndalimin e prerjes së drunjëve, përveç në rastet kur është masë agroteknike. Ndalimin e largimit të shtresës humusore;
Zjarri	Potencial për rrezik nga zjarri ekziston	Si rezultati ndikimit antropogjene, mirëpo mund të shkaktohen edhe nga faktorët natyrorë.	Të ndertimet e reja të vendosen hidrantët për shuarjen e zjarrit. Pajisje për zjarrfikje duhet të vendosen në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë.

6.3. ZONA BUJQËSORE PËR KONSUM PRIVAT DHE TREGTAR

Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm, ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera përveç në rastet e përcaktuara më ligj dhe me dispozitat e tjera të nxjerrura në bazë të tij. Për të mundësuar prodhimtari të rregullt dhe të sigurt me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, botës bimore, shtazore dhe ambientit, zbatohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja. Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja bëhet me ndalim, kufizim dhe parandalim nga bartja direkte, bartja përmes ujit dhe ajrit e materieve të dëmshme dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë.



HARTA 4: ZONA BUJQËSORE

Ndikimet kryesore në bujqësi do të jenë: humbje e përkohshme/përherëshme e përqasjes tek fushat bujqësore, ndryshim i përkohshëm / përherëshëm i perqasjes tek fushat bujqësore, marrje e përkohshme / përherëshme e tokës, copëzim i përherëshëm i pronave fillestare, shqetësim i përherëshëm i punimeve të ujitjes dhe/ose kullimit.

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Bujqësore - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Komponenti mjedisor	Potenciali për ndikim negative	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Toka	Potencial për ndikim ekziston tek toka pyjore nga aktivitetet sipas HZK.	Ndërtimi i fermave të mesme dhe të mëdha për mbarështimin e kafshëve dhe	Rekomandohet që të gjitha këto aktivitetet të lejuara ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të identifikohen mundësitë për minimizimin e efekteve negative në mjedis;



		shpezëve dhe ndertesat e tyre përcjellëse. Ndërtimi i depove për mjete të punës, depo për mekanizëm bujqësor, depo për ruajtjen e ushqimit për bagëti, hangarët për sanë, depo për silazh, dhoma frigoriferike dhe tharëse, etj.	Ndalohet lëshuarja e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e dëmtojnë dhe ndryshojnë aftësinë prodhuese të tokës bujqësore apo kualitetin e kulturave bujqësore dhe përdorimi jo i drejt i plehrave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e bimëve; Nëse vjen deri tek ndotja e tokës bujqësore me lëshuerjen e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme në sasi më të madhe se sa është e lejuar, ndotësi i tokës bujqësore i bartë shpenzimet e veprimeve për dekontaminim, përkatësisht për sanim të tokës bujqësore;
Ajri	Potencial për ndotjen e cilësisë së ajrit të jashtëm është relativ.	Ndotja e ajrit ndikohet nga pluhuri i liruar gjatë ndërtimeve të reja, sasia e mbeturinave të gjeneruara, energjia e cila përdoret për ngrohje.	Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje; Reduktimi i ndotjes së ajrit duke përdorur konvertorë katalitik për automjetet e vjetra; Të zbatohen masat për mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit sipas Planit Lokal për Cilësi të Ajrit 2020-2024; Të zbatohen plani i masave për përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Kosovë, MMPH tani (MEA); Të zbatohen masat sipas Strategjisë për Cilësinë e Ajrit, 2013-2022 MMPH tani (MEA);
Uji	Potencial për ndikimin ekziston te ujërat nëntokësore.	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ndërtuese, si dhe gjatë transportit të materialit ndërtues (vajra lubrifikant, karburant) nga mjetet transportuese.	Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH; Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Ndërimi i vajrave të makinerive transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik; Të zbatohet UA-nr. 13/07 Masat mbrojtëse për burimet ujore që përdoren për pije;
Flora dhe Fauna	Potencial relativ	Peizazhi lokal do të ndryshohet, nga tokë bujqësore në tokë të ndërtuar me objekte për infrastrukturë blegtorale.	Duhet të shmangen zonat e pasura me biodiversitet. Të ruhen llojet e rralla bimore dhe shtazore të cilat jetojnë në atë zonë;



Peizazhi	Potencial relativ	Peizazhi lokal do të ndryshohet, nga tokë bujqësore në tokë të ndërtuar me Infrastrukturë blegtorale.	Për të ruajtur karakterin peizazhor të zonës, e veçmas ndikimin të komuniteti lokal, infrastruktura e parapare blegtorale duhet të rrethohet me rrethoje të gjelbër ose me bimë të kultivueshme gardh natyror (bli dhe pisha dekorative) etj.
Mbeturinat	Potencial relativ	Ndikime negative mund të paraqiten nese nuk menaxhohen si duhet mbeturinat e shkaktuara nga aktivitetet e lejuara.	Sasia e mbeturinave që do gjenerohen gjatë realizimit të aktivitetetve të lejuara duhet të hedhen në lokacion të caktuar nga komuna dhe të njëjtat duhet të mbledhen nga shërbimi komunal; Zgjerimi i mundësive për riciklimin të mbeturinave; Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave; Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave; Mbeturinat e forta duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme; Të zbatohet UA-nr.15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave; Të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese; Të zbatohet UA-nr. 06/2018 Për ndeshkimet me gjoba mandatore;
Zhurma	Potencial relativ	Punët montuese ose nga makineritë bujqësore.	Niveli i zhurmës duhet të jetë nën kufijtë e standardit dhe gjatë punës nuk duhet të kalon 40 Db sipas standardeve ndërkombëtare dhe dispozitave ligjore që tani janë në fuqi; Makineritë me të cilat operohet për transport, të jenë të kontrolluara teknikisht; Të shmangen operimet me makineri të rënda gjatë orëve të mbrëmjes në mënyrë që të minimizohet zhurma;
Shëndeti i popullatës	Potencial relativ	Ndotja e ujit, ajrit, tokës dhe kushtet jo të duhura të mjedisit ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenjen e popullatës.	Gjatë zbatimit të aktivitetetve të lejuara do të përdoret sistemi i ujitjes për të minimizuar sasinë e pluhurit të liruar në mjedisin e brendshëm; Mbeturinat do të largohen në mënyrë të rregullt nga punëtorët; I tërë materiali ndërtues, duhet të mirëmbahet sipas standardeve për ruajtje të mjedisit;
Faktorët Klimatik	Potencial relativ	Energjia e prodhuar nga thëngjilli, mbeturinat, bujqësia dhe shfrytëzimi i tokës.	Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2010-2018; Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER) 2011 – 2020; Rindërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të ngrohjes qendrore; Ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje;



Rrezik nga Erozioni	Potencial relativ	Zhvillimi i infrastrukturës	Për parandalimin e erozionit duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020; Në kuadër të veprimeve të nevojshme duhet të përfshihen edhe masat hidroteknike dhe masat për menaxhimin e tokës; Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga erozioni, duhet të mirren këto masa agroteknike; Kufizimin ose ndalimin e prerjes së drunjve, përveç në rastet kur kjo është masë agroteknike; Kufizimin ose shfrytëzimin e kullotave duke përcaktuar llojin, kohën, numrin e kafshëve që mund të kullosin, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre; Ndalimin e largimit të shtresës humusore ose shtresës së punueshme nga toka bujqësore; Detyrimin e mbjelljes së barit të llojit të veçantë në tokat e pjerrëta; Obligimin e ndërmarrjes së masave mbrojtëse për parandalimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga erërat;
Zjarri	Potencial për rrezik nga zjarri	Depot për ruajtjen e ushqimeve të thata për bagëti, hangarët për sanë.	Infrastruktura blegtorale e lejuar duhet të plotësojë kriteret për mbrojtje nga rreziku i zjarrit; Duhet vendoset rrjeti i hidrantit për shuarjen e zjarrit; Paisjet për zjarrfikje duhet të vendosen , në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë; Kujdes i vecantë duhet kushtuar depove për ruajtjen e sanës dhe ushqimeve tjera të kafshëve të cilat gjatë temperaturave të larta janë lehtë të ndizshme;

Komente Zona Bujqësore:

- Për të parandalur ndotjen e tokës bujqësore nga mbeturinat rekomandohet: Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave (grumbullimi i mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe zgjerimi i mundësive të riciklimit të mbeturinave).
- Ngritja e vetëdijes mjedisore mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës bujqësore dhe nxitja epjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore.



6.4. ZONA REKREATIVE

Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Rekreative - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Komponenti mjedisor	Potenciali për ndikim negative	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Toka	Potencial relativ	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i ndërtimeve të objekteve turistike si: Hotele, Bujtina, Villa të Banimit, depo, garazha etj.	Rekomandohet që të gjitha këto aktivitetet të lejuara ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të identifikohen mundësitë për minimizimin e efekteve negative në mjedis.
Ajri	Potencial relativ	Ndotja e ajrit ndikohet nga pluhuri i liruar gjatë ndërtimeve të reja, sasia e mbeturinave të gjeneruara, energjia e cila përdoret për ngrohje.	Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje; Reduktimi i ndotjes së ajrit duke përdorur konvertorë katalitik për automjetet e vjetra; Të zbatohen masat për mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit sipas Planit Lokal për Cilësi të Ajrit 2020-2024; Të zbatohen plani i masave për përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Kosovë, MMPH tani (MEA); Të zbatohen masat sipas Strategjisë për Cilësinë e Ajrit, 2013-2022 MMPH tani (MEA);
Uji	Potencial relativ	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ndërtuese, gjatë transportit të materialit ndërtues, dhe nga trajtimi jo i duhur i ujërave të zeza në zonë.	Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH; Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Ndririmi i vajrave të makinerive transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik;
Flora dhe Fauna	Potencial relativ	Aktiviteti antropogjen	Mbrojtja e natyrës zbatohet përmes ruajtjes së laramanisë biologjike, peizazhore dhe vlerave të natyrës; Mbrojtja e ekosistemeve realizohet përmes zbatimit të masave të ruajtjes së laramisë biologjike në



			shfrytëzimin e të mirave të natyrës dhe rregullimin e hapësirës si dhe me mbrojtjen e tipave të vendbanimeve; Të pengohet shfrytëzimi i tepërt, rrezikimi i llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimet e tyre; Parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike dhe rekreative; Mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së; Ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve të cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre);
Peizazhi	Potencial relativ	Aktivitetet antropogjene, planet e planifikuara.	Ndikimet në karakterin e peisazhit mund të ndodhin në ato zona karakteristike që ndikohen direkt ose indirekt nga propozimet. Ndikimet direkte ndodhin si rezultat i ndryshimeve fizike të veçorive të peisazhit, ndërsa ndikimet indirekte mund të ndodhin si rezultat i ndërhyrjes së jashtme që ndikon në karakterin e peisazhit apo në pozicionimin e tipareve të peisazhit. Pra shtrirja fizike mbi të cilën ndodh ndikimi do të varet nga vlerësimi i karakteristik bazë dhe nga shtrirja e punimeve të propozuara. Ndikimet do të jenë të përkohshme ose të përhershme.
Mbeturinat	Potencial relativ	Ndotja akustike është dukuri prezente si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda.	Zbatimi i parimit ndotësi pagan, personi i cili zhvillon aktivitetet që ndikojnë në shtimin e sasisë së mbeturinave bartin përgjegjësi për mbeturinat e krijuara gjatë aktiviteteve të tyre; Caktimi i lokacioni për mbeturina dhe zgjerimi i mundësive për riciklimin të mbeturinave; Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave; Mbeturinat e forta duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme; Të zbatohet UA-nr.15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave; Të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese; Të zbatohet UA-nr. 06/2018 Për ndeshkimet me gjoba mandatore;



Zhurma	Potencial relativ	Me rastin e plotësimit të aktivitetetve rekreative, organizimit të aktiviteteve argëtuese, sportive dhe tjera për banorët vendor ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësitë e tejkallimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njesitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë lokacion të përshtatshëm për qëllime të tilla brenda zonës.	Me masat e mbrojtjes nga zhurma, patjetër duhet të pengohet paraqitja e zhurmës, respektivisht të zvogëlohet zhurma në nivel optimal; Masat e mbrojtjes nga zhurma përmbajnë: a) Përzgjedhjen dhe përdorimin e makinave, pajisjeve, mjeteve të punës dhe të transportit të cilat nuk shkaktojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar; b) Vendosjen e objekteve me burim zhurme dhe zonat të cilat duhet mbrojtur nga zhurma; c) Izolimin për mbrojtjen nga zhurma të ndërtesave të cilat mund të jenë si burim i zhurmës në hapësirat e punës ose banimit; d) Matjet me qëllim të përcjelljeve dhe mbikqyrjes së përhershme të zhurmës; e) Kufizimet e herë pas herë të emitimit të zhurmës; f) Mbrojtja nga zhurma aplikohet ditën, mbrëmjen dhe natën. Ndërtesa duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar në mënyrë që zhurma të cilën e degjojnë njerëzit që banojnë në afërsi të jetë e atij intenziteti që nuk do të rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për punë;
Shëndeti i popullatës	Potencial minimal	Të gjitha	Në zonën rekreative sipas hartës Zonale nuk parashihen ndikime të theksuara, të dëmshme në shëndetin e popullatës.
Faktorët Klimatik	Potencial relativ		Zbatimi i masave që zvogëlojnë ndikimin që kanë ndotësit e tokës, ajrit dhe ujit nëntokësor dhe mbitokësor duhet të bëhet përmes aplikimit të kërkesave që dalin nga Ligji i VNM-së, Ligji i VSM-së dhe ligjet tjera mjedisore; Të zbatohen masat sipas Strategjisë për Ndryshimet Klimatike, dhe masat nga Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike;
Rrezik nga Erozioni	Potencial relativ	Prereja e drunjëve, dërtimi i pa rregullt, zhvillimi i infrastrukturës.	Të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020; Kufizimin ose ndalimin e prerjes së drunjëve, përveç në rastet kur është masë agroteknike. Ndalimin e largimit të shtresës humusore;
Zjarri	Potencial për rrezik nga zjarri	Si rezultati ndikimit antropogjene, mirëpo ka	Të vendosen hidrantët për shuarjen e zjarrit. Pajisje për zjarrfikje duhet të vendosen në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë.




		potencial edhe nga faktorët natyrorë.	
--	--	---------------------------------------	--

6.5. ZONA KOMERCIALE DHE INDUSTRIALE

Mjedisi është tërësia e gjerave që ndodhen rreth nesh, me të cilat direkt apo indirekt është e lidhur jeta dhe veprimtaria e njeriut. Njeriu dhe mjedisi janë binom që ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë te njeri-tjetri. Veprimtaritë njerëzore, zhvillimi i shpejtë i teknikës dhe industrisë si dhe shtrirja globale në tërë planetin kanë shkaktuar çrregullime të mëdha mjedisore dhe prishje ekuilibri. Ndotja e mjedisit dhe veçanërisht sipërfaqja e tokës me metale të rënda është prezentë në shumë zona industriale dhe minerare në të gjithë botën, përfshirë dhe Komunën e Glllogocit.

Si rezultat i rritjes së popullsisë, nevoja për konsum jetik është rritur ndjeshëm, gjithashtu dhe prodhimi industrial. Zhvillimi i teknologjisë, industrializimi i shpejtë i bujqësisë, zgjerimi i industrisë kimike, dhe nevoja për të krijuar forma të lira të energjisë, përveç prodhimit primar kanë shkaktuar lëshimin e vazhdueshëm të përbërjeve organike, inorganike, mbetjeve të lëngëta, të gazta dhe të ngurta në mjedisin rrethues, duke shkaktuar kështu efekte negative në ekosisteme dhe njerëz.

Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vleresimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale



HARTA 5: ZONA KOMERCIALE DHE INDUSTRIALE

Atmosfera, shtretërit dhe burimet ujore si dhe shumë mjedisë të tokës janë ndotur nga një larmi e madhe e përbërjeve toksike.

Shumë prej këtyre përbërjeve në përqendrimë të larta ose pas ekspozimit të zgjatur kanë potencial për të prodhuar efekte negative në mjedis dhe organizma.

Këto përfshijnë rrezikun e toksicitetit akut, *mutagjenezën (ndryshime gjenetike)*, *defektet e lindjes (carcinogenesis dhe teratogenesis)* për njerëzit dhe organizma të gjallë. Disa nga këto komponime toksike janë gjithashtu rezistentë ndaj kushteve fizike, kimike, biologjike apo degradimit dhe kështu ata paraqesin një ngarkesë me madhësi të konsiderueshme për mjedisin.



Vlerësimi i Ndikimeve në mjedis sipas Zonës Komerciale dhe Industriale - Komponenti mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve:

Komponenti mjedisor	Potenciali për ndikim negative	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Toka	Potencial relativ	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i ndërtimeve të objekteve industriale dhe zhvillimit të aktiviteteve të tyre.	Bazuar në kornizën ligjore në lidhje me Udhëzimin Administrativ MMPH/01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, Shtojca/Lista e aktiviteteve për të cilat duhet të merret leja mjedisore komunale, aktivitetet në kuadër të Zonës Industriale bie në fushëveprimin e UA-së/MMPH/01/2017 të përmendur më sipër; Në zonën Komerciale mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe pasuritë kombëtare të Kosovës dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi; Të zbatohet Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
Ajri	Potencial relativ	Ndotja e ajrit ndikohet nga pluhuri i liruar gjatë ndërtimeve të reja, sasia e mbeturinave të gjeneruara, energjia e cila përdoret për ngrohje.	Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje; Reduktimi i ndotjes së ajrit duke përdorur konvertorë katalitik për automjetet e vjetra; Të zbatohen masat për mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit sipas Planit Lokal për Cilësi të Ajrit 2020-2024; Të zbatohen plani i masave për përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Kosovë, MMPH tani (MEA); Të zbatohen masat sipas Strategjisë për Cilësinë e Ajrit, 2013-2022 MMPH tani (MEA);
Uji	Potencial relativ	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i menaxhimit jo të duhur të mbeturinave ndërtuese, gjatë transportit të materialit ndërtues, dhe nga trajtimi jo i duhur i ujërave të zeza në zonë.	Të zbatohen masat e përcaktuara sipas Strategjisë Shtetërore të Ujërave në Kosovë 2017-2036 nga MMPH; Të caktohet lokacioni për mbeturina dhe mbeturinat e forta të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Ndrimi i vajrave të makinerive transportuese duhet të bëhet në një lokacion të caktuar larg kontaktit me sipërfaqen e tokës dhe agjentëve atmosferik;
Flora dhe Fauna	Potencial relativ	Proceset industriale në Zonën Industriale përveçse prodhimit	Të bëhet hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve dhe habitateve; Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore në Komunën e Glogocit;



		primar prodhojnë dhe produkte sekondare, mbetje të ngurta, të lëngëta dhe të gazta, në mjedisin rrethues për të cilat duhet të ketë kontroll dhe monitorim të vazhdueshëm. Fito diversiteti është shfrytëzuar kohëve jo shumë racional dhe pa planifikim, gjë që në të ardhmen mund të rezultojë me pasoja të paparashikueshme. Dëme të mëdha po i shkaktohen bimëve mjekuese, aromatike dhe industriale ngagrumbullimi pa kriter i tyre.	Mbrojtja e habitateve të llojeve të rralla dhe të rrezikuara si dhe përgatitja e arsyetimeve profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitateve sipas rrjetit ekologjik Natyra 2000, në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Natyrës; Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve mjedisor në zonat e mbrojtura; Rritja e stafit në DPUMM;
Peizazhi		Ndikimet mbi peizazh vlerësohen gjatë ndërtimit dhe gjatë shfrytëzimit. Ndikimet në karakterin e peizazhit në zonen industriale që ndikohen direkt ose indirekt nga plani. Ndikimet direkte ndodhin si rezultat i ndryshimeve fizike të vecorive të peizazhit ndersa ndikimet indirekte mund të ndodhin si rezultat i ndërhyrjes pamore që ndikon në karakterin e peizazhit.	Të gjitha aktivitetet në zonën industriale në mënyrë që të parandalohet ndotja duhet të rrethohen me breza të gjelbër mbrojtës me gjerësi minimale 5m;



Mbeturinat	Potencial relativ		Me qëllim të përmirësimit të sistemit përmenaxhimin e mbeturinave rekomandohet që përveç implementimit të Strategjive dhe Planeve në sektorin e mbeturinave të punohet edhe më tutje në fuqizimin e institucioneve lokale dhe kompanive për menaxhimin e mbeturinave, në hartimin dhe zbatimin e projekteve, planeve dhe programeve për riciklim, trajtimit dhe ripërdorimin e mbeturinave dhe në ngritjen e vetëdijesimit; Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për trajtimin e mbeturinave; Mbeturinat ndërtimore duhet të transportohen në vendin përkatës të caktuar nga komuna; Të zbatohen UA-nr.06/2008 Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme; Të zbatohet UA-nr.15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave; Të zbatohet UA-nr. 16/2010 për administrimin e mbeturinave biodegraduese; Të zbatohet UA-nr. 06/2018 Për ndeshkimet me gjoba mandatore; Menaxhimi i mbeturinave të ndërtimit; Strategji për përdorimin e materialit për ndërtim dhe riciklimin e materialeve të përdorura të ndërtimit; Mbështetja e riciklimit të mbeturinave me subvencione;
Zhurma	Potencial relativ	Ndotja akustike është dukuri prezente si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda, makinave, mjetet transportuese, paisjet e ndryshme dhe aparaturat e ndryshme.	Me masat e mbrojtjes nga zhurma, patjetër duhet të pengohet paraqitja e zhurmës, respektivisht të zvogëlohet zhurma në nivel optimal; Masat e mbrojtjes nga zhurma përmbajnë: Përzgjedhjen dhe përdorimin e makinave, pajisjeve, mjeteve të punës dhe të transportit të cilat nuk shkaktojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar; Vendosjen e objekteve me burim zhurme dhe zonat të cilat duhet mbrojtur nga zhurma; Izolimin për mbrojtjen nga zhurma të ndërtesave të cilat mund të jenë si burim i zhurmës në hapësirat e punës ose banimit; Matjet me qëllim të përcjelljeve dhe mbikqyrjes së përhershme të zhurmës; Kufizimet e herë pas herë të emitimit të zhurmës; Mbrojtja nga zhurma aplikohet ditën, mbrëmjen dhe natën. Ndërtesa duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar në mënyrë që zhurma të cilën e degjojnë njerëzit që banojnë në afërsi të jetë e atij intenziteti që nuk do ta



			rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për punë;
Shëndeti i popullatës	Potencial relativ Metalet e rënda janë toksike dhe nuk mund të degradohen ose të shkatërrohen, (Metalet të rënda përmendim, Plumbin (Pb), Merkurin (Hg), Kadmiumin (Cd), Arsenikun (As), Kromin (Cr), selenin (Se) dhe Taliumin (Tl), në përqendrime të larta, mbi norma të rekomanduara ato mund të çojnë në helmim.	Prodhimi i metaleve bazike, metaleve të fabrikuara, prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës, shërbimet tregtare si automekanik dhe autolarje. Shfrytëzimet e lejuara si dytësore: trafo të rrymës, kaldaja, infrastruktura e prodhimeve të rënda, infrastruktura e telekomunikacionit.	Metalet nuk duhet të depertojnë në tokë, ujë pasi mund të shkaktojnë ndotje të rëndë; Të ndalohej ndërtimi i objekteve industriale në afërsi të zonës së banimit, distanca duhet të jetë së paku 1000 m; Ndalohej ndërtimi i çerdheve dhe shkollave në afërsi të zonës industriale; Të bëhen hulumtime më të detajuara për ndikimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në shëndetin publik; Të grumbullohen informacione dhe të dhëna të veçanta për numrin e sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve ambientale dhe të hartohen raporte të rregullta për kualitetin e ujit të pijes të cilat do të duhej të jenë në dispozicion të publikut; Të investohet në përmirësimin e kualitetit të ujit të pijes dhe monitorimin e rregullt të tij; Përdorimi i teknologjive të reja në energjetikë dhe industri si dhe favorizimi i përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit, por edhe të shëndetit publik; Të bëhet rehabilitimi i zonave të ndotura; Të mbeshteten projektet të bazuara në teknologjinë e pastër dhe burimet e ripërtëritshme;
Faktorët Klimatik	Potencial relativ	Faktori antropogjen	Zbatimi i masave që zvogëlojnë ndikimin që kanë ndotësit e tokës, ajrit dhe ujit nëntokësor dhe mbitokësor duhet të bëhet përmes aplikimit të kërkesave që dalin nga Ligji i VNM-së, Ligji i VSM-së dhe ligjet tjera mjedisore; Të zbatohen masat sipas Strategjisë për Ndryshimet Klimatike, dhe masat nga Plani i Veprimet për Ndryshimet Klimatike;
Rrezik nga Erozioni	Potencial relativ	Aktivitetet e propozuara	Për parandalimin e erozionit duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020; Në kuadër të veprimeve të nevojshme duhet të përfshihen edhe masat hidroteknike dhe masat për menaxhimin e tokës; Kufizimin ose ndalimin e prerjes së drunjve, përveç në rastet kur kjo është masë agroteknike; Detyrimin e mbjelljes së llojeve bimore të veçantë në zbutjen e ndotjes në zonat industriale;



Rekomandime:

Edukimi mjedisor: Mbështetje për OJQ-të mjedisore në lidhje me arsimimin jo-formal.

Ndërgjegjësimi publik: Zhvillimi i programeve të edukimit mjedisor për të gjitha nivelet (kopshtet, shkollat).

Ngritja e vetëdijes publike për efikasitetin e energjisë (prodhimi dhe përdorimi). Ngritja e vetëdijes publike dhe kompanive për kimikatet e rrezikshme, me projekte konkrete. Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e mjedisit nga mbeturinat, me veprime konkrete si: kampanja dhe fushata për ngritjen e vetëdijes rreth menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit të tyre.

Investimet për mbrojtjen e mjedisit: Investimi në mjedis është një prej formave direkt në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis. Komuna pjesën më të madhe të investimeve në mjedis ta orientojë në projekte mjedisore.

Investimet e donatoreve: Të orientohen në sektorë të ndryshëm mjedisor si mbeturina, biodiversitet, vlerësimin e gjendjes së tokave, planifikim hapësinorë, ndryshime klimatike, ngritjen e kapaciteteve etj.

Përdorimi i teknologjisë, me sa më pak mbeturina;

Përdorimi i substancave më pak të rrezikshme;

Kur të jetë e përshtatshme, përpunimi dhe riciklimi i substancave të përdorura dhe/ose gjeneruar gjatë procesit të operimit;

Kur të jetë e përshtatshme, përpunimi dhe riciklimi i mbeturinave;


Aktivitetet në zonen Komerciale dhe Industriale domosdoshmërisht duhet të parandalojnë ose, kur kjo nuk është e zbatueshme, të reduktojnë deri në minimum të ndikimit të përgjithshëm të emisioneve në mjedis dhe të rrezikimit të mjedisit dhe shëndetit të njeriut;

Aktivitetet në zonen Komerciale dhe Industriale: Të zhvillojnë veprimtaritë në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.



6.6 ZONA TURISTIKE

Turizmi ka qënë dhe do të jetë gjithmonë lëvizja e njerëzve që udhëtojnë dhe vizitojnë vende të reja. Rajoni i Drenicës ka historinë dhe trashëgiminë që e bëjnë atë një destinacion për t'u zbuluar dhe vizituar nga turistët e huaj dhe kombëtar. Ky rajon ka qënë një zonë e rëndësishme historike dhe trashëgimia e këtij rajoni duhet të vihet në plan të parë në planifikimin e mundësive të vizitorëve dhe në zhvillimin e mundësive të turizmit të qëndrueshëm në Gllogoc, duke kontribuar kështu në ekonominë rajonale dhe duke siguruar në të njëjtën kohë mbrojtjen e burimeve natyrore. Rëndësia e Zonës turistike reflektohet në rolin kryesor në ruajtjen e habitateve natyrore dhe biodiversitetit, por edhe në ofrimin e rekreacionit dhe argëtimit, duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik ndërkohë që në të njëjtën kohë territori mbrohet nga ndikimet negative.



HARTA 6: ZONA TURISTIKE

Komuna e Gllogocit karakterizohet me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit vikendor, natyror, kulturore dhe rural. Gjeomorfologjia e territorit të komunës së Gllogocit e karakterizuar me masive malore,



Çyçavica, Vargmalet e Berishës e Kosmaçi, Kodra e pishave të Kamenicës dhe Komoranit i japin vlerë për zhvillimin e turizmit.

Monumentet e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të krijuara në periudha të ndryshme historike si Kalaja e Verbovcit dhe Kalaja e Vucakut kanë rëndësi të veçantë historike dhe kulturore për Rajoni e Drenicës, lapidare të të rënëve për çlirimin e Kosovës, komplekse memoriale dhe monumente tjera të ndryshme janë vetëm disa nga resurset natyrore që kërkojnë mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm. Liqeni i Vasilevës, lumenjtë Drenica dhe Verbica, Gryka e “Gurit të Plakës”, Guri i Gradinës, janë disa nga atraksionet e zonës.

Ndikimi në Habitat dhe Biodiversitet dhe Masat Zbutëse gjatë ndërtimit

Ndikimet gjatë ndërtimit do të jenë lokale dhe të përkohshme. Megjithatë, në rast se fauna është e shqetësuar në fazën e ndjeshme të ciklit të jetës, kjo mund të ndikojë në popullsinë e saj. Serioziteti gjithashtu varet nga disa faktorë duke përfshirë dobësinë e specieve, disponueshmërinë e habitatit alternativ të përkohshëm dhe më shumë.

Ndikimet potenciale dhe masat lehtësuese:

Komponent mjedisor i prekur	Potenciali për ndikim	Burimi (veprimet që e shkaktojnë)	Rëndësia	Masat e lehtësimit
Mjediset dhe llojet	Shkatërrimi permanent i mjediseve natyrore; Degradimi/pakesimi; Biodiversiteti humb gjatë ndërtimit; Migrimi i popullsisë së kafshëve si shkak i shqetësimit; Krijimi i mjediseve të reja për llojet e kafshëve dyndese/pushtuese.	Aktivitetet antropogjene	E vogël	Shmangia e vendeve të punës afër rrjedhave ujore; Puna e ndërtimit gjatë sezonit të thatë dhe jashtë sezonit të celjes së zogjve; Të riparohen mjediset pasi të mbarojë puna. Masa për të shmangur rrjedhjen aksidentale të lubrifikanteve dhe karburanteve;



Mjediset tokësore dhe me shumë mjediset ujore dhe fauna ujore	Ndotja e tokës/ Prishja e cilësise së ujit; Degradimi/pakesimi i mjediseve; Humbjet e biodiversitetit; Prishja ose shkatërrimi i vendeve shmangia e punimeve ne shtratin e lumit, masa për të shmangur rrjedhjen aksidentale të lubrifikanteve dhe karburanteve; Mbledhja dhe riciklimi i lubrifikanteve; Punët e ndërtimit gjatë sezonit të thate.	Karburanti i makinerive; Rrjedhje e lubrifikantev e, etj.	E vogël	Mbledhja dhe riciklimi i lubrifikantëve nga aktivitetet.
--	--	--	---------	--

Rekomandime:

– *Funksionalizimi e Qendrës Informative të Turizmit:*

Qendra Informative e Turizmit përbën njërën nga shërbimet më të rëndësishme të turizmit në një zonë. Kjo shërben për t'i ofruar informacione fillestare vizitorëve dhe luan një rol kyç në krijimin e përshtypjeve të para tek ata. Të funksionalizohet kjo qendër duke punësuar staf të trajnuar mirë, të cilët ofrojnë informata dhe materiale informuese për vizitorët. Orari i punës së saj të jetë i përshtatshëm për vizitorë, dhe të jetë e hapur edhe gjatë vikendit.

– *Përgatitja e një katalogu fizik dhe zhvillimi i një aplikacioni mobil me shtigje të caktuara historike/kulturore:*

Turistë të ndryshëm janë të interesuar për përvoja të ndryshme kulturore/historike. Për t'iu përmbushur preferencat e tyre specifike, duhet të hartohet një katalog që përmban disa shtigje historike. Hartimit të katalogut duhet t'i paraprijë një hulumtim i shkurtër me ekspertë të turizmit për përcaktimin e shtigjeve. Pikat që do të vizitohen në kuadër të të njëjtit shteg duhet të kenë një lidhje organike në mes veti. Për më shumë, duke qenë se telefonat mobil janë shndërruar në platforma shumë të dobishme për vizitorët, katalogu duhet të inkorporohet në një aplikacion, i cili do të ofrojë mundësi vetanake të eksplorimit. Përveç mundësisë për zgjedhjen e shtigjeve, aplikacioni duhet të ofrojë rrëfime unike për atraksionin që vizitohet.

– *Përgatitja e një harte informuese:* Harta informuese përbëjnë materiale kyçe për orientim të turistëve. Për informim sa më të mirë të vizitorëve, duhet të përgatitet një hartë që i përfshin të gjitha pikat/zonat atraktive me shpjegimet përkatëse, numrat emergjent, taksit (me çmime referente) dhe linjat e autobusëve së bashku me oraret.



– *Vendosja e paneleve turistike për orientim:*

Informacionet orientuese e lehtësojnë qarkullimin e turistëve dhe i stimulojnë ata që të shpenzojnë më shumë kohë në qytet. Komuna e Glllogocit është e e mangët në këtë aspekt. Për t'u përmirësuar në këtë drejtim, duhettë vendosen rreth 10 panele turistike për orientim nëpër pikat kryesore turistike të qytetit, së bashku me tabelat tjera informuese.

– *Vendosja e pllakave informative para hapësirave të trashëgimisë kulturore:*

Përshkrimi i fakteve historike përmes pllakave të vendosura para objekteve të trashëgimisë kulturore përmirëson dukshëm përvojën e vizitorëve dhe njëkohësisht ndihmon në ndërtimin e relacioneve me këta të fundit.

– *Vendosja e shportave për hedhje të mbeturinave në hapësira publike:*

Turistët synojnë vende të pastra ku mundësia e kanosjes së ndonjë infektimi është minimale. Mungesa e pastërtisë në hapësira publike është identifikuar si një nga problemet kryesore në hapësira publike nga turistët e huaj. Për ta ngritur nivelin e pastërtisë, do të sigurohet që hapësirat publike, sidomos ato afër lokacioneve turistike, të kenë shporta për hedhje të mbeturinave.

– *Sigurimi i Infrastrukturës:*

Ofrimi i infrastrukturës përcjellëse (ulëse, shtigje të ecjes, ndriçim, vendosje të shportave për mbeturina, etj) për lokalitetet turistike (mali i Kosmaçit, kodra e pishave të Kamenicës dhe ne Komoran, liqeni i Vasilevës) dhe i qasjes adekuate në monumente të natyrës (qasja deri tek shpellat).

– *Ridimensionimi i shtigjeve:*

Shtigjet duhet paraparë për kategori të ndryshme të turistëve, të zhvillohen dhe përshtaten për të gjitha grupet e turistëve, sipas interesave të tyre rekreacionale (p.sh. për ecje, vrapim, biçikleta etj).

– *Krijimi i bazës së të dhënave:* Për të lehtësuar menaxhimin e potencialit ekzistues të florës, faunës dhe resurseve tjera të zonës turistike rekomandohet krijimi i bazës së të dhënave.




Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vleresimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale

6.7. SIPERFAQET UJORE

Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj. Qëllimi i ligjit për mbrojtjen e ujërave është të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social – ekonomik, si dhe të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi.

Ujërat nuk janë lëndë e së drejtës së pronësisë të personave fizikë dhe juridikë, pa dallim nga statusi juridik i pronës në të cilën gjenden. Nxjerrja, shfrytëzimi, akumulimi, ndryshimi i drejtimit, ndërtimi, lëshimi si dhe veprimet tjera ndaj ujërave, duhet të kryhen në kushte, në mënyra dhe në procedura të përcaktuara me ligjin nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës.



HARTA 3: SIPERFAQET UJORE



Ndikimet potenciale të aktivitetetve sipas hartës zonale në sipërfaqet ujore dhe masat lehtësuese janë:

Komponent mjedisor i prekur	Potenciali për ndikim	Burimi(veprimet që e shkaktojnë)	Rëndësia	Masat e lehtësimit
Mjediset dhe llojet	Shkatërrimi permanent i mjediseve natyrore; Degradimi/pakesimi; Biodiversiteti humb gjatë ndërtimit; Migrimi i popullsisë se kafsheve si shkak i shqetesimit; Krijimi i mjediseve të reja për llojet e kafshëve dyndese/pushtuese.	Aktivitetet e ndërtimi, Ndërtimi i urave, rrugëve dhe hekurudhave	E vogël	Shmangia e vendeve të punës afër rrjedhave ujore; Puna e ndërtimit gjatë sezonit të thatë dhe jashtë sezonit të celjes së zogjve; Të riparohen mjediset pasi të mbarojë puna.
Mjediset tokësore dhe mjediset ujore, fauna ujore, cilësia e ujit	Ndotja e tokës/baltës; Degradimi i mjediseve; Humbjet e biodiversitetit, Dëmtimi ose shkatërrimi i vendeve shtuese për peshq dhe specie të ndryshme.	Mbetjet e ngurta dhe të lëngshme nga kampi i punëtorëve dhe aktivitetet e ndërtimit të urave, rrugëve dhe hekurudhave.	E vogël	Shmangia e punimeve në shtratin e lumit; Mbledhja dhe riciklimi i mbetjeve të ngurtadhe të lëngeshme në vendin e punës. .
Mjediset tokësore dhe me shumë mjediset ujore dhe fauna ujore	Ndotja e tokës/baltës; prishja e cilesise se ujit; Degradimi/pakesimi i mjediseve; Humbjet e biodiversitetit; Prishja ose shkatërrimi i vendeve shmangia e punimeve ne shtratin e lumit, masa per te shmangur rrjedhjen aksidentale te lubrifikanteve dhe karburanteve, mbledhja dhe riciklimi I lubrifikanteve, punet e ndertimit gjate sezonit te thate. për specie te ndryshme.	Karburanti i makinerive; Rrjedhje e lubrifikanteve	E vogël	Masa për të shmangur rrjedhjen aksidentale te lubrifikanteve dhe karburanteve; Mbledhja dhe riciklimi i lubrifikantëve, punët e ndërtimit gjatë sezonit të thatë.
Të gjitha grupet	Ndotja e tokës/baltës; Prishja e cilësise së ujit; Degradimi/pakesimi i mjediseve;	Aksidentet (karburant lubrifikante, mbetjet e rrezikshme),	E vogël	Ndërtimi i një sistemi të duhur drenazhi/kullimi për tepricen e ujit;



	Humbjet e biodiversitetit; Prishja ose shkatërrimi i vendeve shtuese për peshk dhe specie të ndryshme.			Mbledhje dhe riciklim i menjehershëm i mbeturinave; Ndalohej larja e mjeteve lundruese, mjeteve motorike dhe pajisjeve tjera në ujërat sipërfaqësore dhe në brigje.
Shpendët, gjitarët, amfibet, zvarranikët	Migrimi i popullsisë së kafshëve si pasojë e shqetësimit;	Zhurma	E vogël	Minimizimi i fuqishëm i zhurmës;
Të gjithë grupet	Degradimi i mjediseve; Ulja e burimeve të ushqimit për llojet e faunës;	Pluhuri	E vogël	Ujitja e rrugës gjatë sezonit të thatë.
Habitatet ujore dhe tokësore	Shkatërrimi dhe degradimi i mjediseve; Largimi/levizja i/e faunës; Dëmtimi ose shkatërrimi i vendeve shtuese për peshk dhe lloje të ndryshme.	Furnizimi me materiale inerte	E vogël	Mos shfrytëzimi i materialeve inerte nga lumenjtë.
Shpendët dhe gjitarët e medhenjë	Pakesimi i specieve dhe abondanca e tyre; Migrimi i popullsisë së kafshëve si pasojë e shqetësimit.	Gjuetia	E vogël	Forcimi i rregullores së gjuetisë; Monitorimi i gjuetisë; Parandalimi i gjuetisë së llojeve të rralla dhe të mbrojtura me ligj.
Ujërat Nëntokësore		Ekziston mundësia për ndotjen e ujrave nëntokësore nga derdhjet aksidentale të gazrave dhe karburanteve.	Mesatare	Të merren masa të përshtatshme për kontrollin e ndotjes nga derdhjet e gazrave dhe karburanteve për të zvogëluar sa me shumë impaktet.
Erozioni		Faktori antropogjen, për përfitime personale	E vogël	Ndalimi i nxjerrjes së dheut, rërës, zhavorrit dhe gurit; Ndalimi i shartimit, prerjes dhe gërmimit të drunjve dhe kaçubave; Ndalimi i kullotjes së kafshëve; Prerja e drujve mund të bëhet në kushte, në mënyra dhe procedura me



				të cilat sigurohet mbrojtja nga erozioni, si dhe në harmoni me Ligjin për pyjet.
Mbeturinat	Zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujërave të pijshëm; Burimet nëntokësore; Burimet sipërfaqësore; Lumenjtë.	Faktori antropogjen	E madhe	Ndalohet hudhja e substancave dhe mbeturinave të ngurta, të lëngëta dhe të gazëta të cilat për shkak të vetive fizike, kimike dhe biologjike, rrezikojnë shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, florën dhe faunën ujore, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë objektet dhe pajisjet ujore.

Rekomandime:

Kufizimet për përdorim publik:

- Kalimi në hapësirat fizike dhe ujëra, mund të lejohet vetëm për qëllimet e ndërtimit dhe instalimit të pajisjeve të infrastrukturës publike;
- Ndërtimit të pajisjeve për pasuritë artificiale, të parapara me ligj dhe aktet nënligjore, të dalura nga ligji për mbrojtjen e ujërave.
- Masave të zbatuara për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike, të ujërave sipërfaqësore;
- Masave të zbatuara për mbrojtje të natyrës;
- Ndërtimit të pajisjeve të nevojshme;
- Ndërtimit të objekteve për përdorim të ujërve;
- Mbrojtjes nga përmbytjet;
- Shfrytëzimit të banjove natyrore dhe
- Vendosijs së pajisjeve të caktuara, për siguri publike dhe shpëtim.



Dispozitat e përgjithshme për shfrytëzimin e ujërave:

- Regjimi i ujërave është tërësia e parametrave të cilët e përcaktojnë gjendjen sasore dhe cilësore të ujërave.
- Ndalohet kryerja e të gjitha punëve të cilat shkaktojnë ndryshimin në gjendjen ujqor.
- Intervenimet me qëllim të përmirësimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së gjendjes së mirë të ujërave, duhet të kryhen në pajtim me planet për menaxhim të pellgjeve lumore.
- Kompetent për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave, mbrojtjen nga erozioni dhe veprimet tjera të dëmshme në zona urbane, zona e kufijve të qytetit është komuna.
- Komunitat dhe Autoriteti janë kompetente edhe për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastruktures
- mbrojtëse në shtretërit e lumenjve, përfshirë edhe pritrat malore, muret mbrojtëse dhe objektet tjera mbrojtëse.
- Të hartoj komuna programin për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave.

Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar:

- Ndërrimi i drejtimit të ujqit në ujërrjedha dhe kanale;
- Nxjerrja e rrës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hudhja e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta në ujërrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre;
- Ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve;
- Kryerja e punëve në afërsi të ujërrjedhave, liqeneve, akumulimeve, tuneleve të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre, si dhe transportimin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme;
- Ndërrimi i drejtimit, nxjerrja e rrës, zhavorrit, gurëve, ndërtimi i objekteve kryhet vetëm nën kushtet, mënyrën dhe procedurat e caktuara sipas ligjit për ujërat e Kosovës.
- Ndalohet çfardo lloj i transportimit të substancave, materieve dhe mbeturinave të rrezikshme pranë akumulimeve dhe zonave ujore të mbrojtura përveç me leje të veçantë.



- Ndalohet çfardo lloj ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve të dedikuara për prodhimin e substancave dhe materieve të rrezikshme në afërsi të trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, përfshirë edhe akumulimet.
- Personat juridikë dhe fizikë të cilët shkarkojnë, hedhin, depozitojnë substanca të rrezikshme dhe të dëmshme në ujëra, në brigje apo në zona të mbrojtura, janë të detyruar që të raportojnë rastin tek autoritetet kompetente.

Personat juridikë dhe fizikë të cilët shkaktojnë pasoja me veprimet e tyre, janë të detyruar që me shpenzime të veta t'i kompenzojnë dëmet e bëra personave tjerë dhe resurseve ujore.

Zonat e Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujërave të Pijshëm - Liqeni i Vërbovcit

Përcaktimi i zonave të mbrojtura sanitare dhe masave për mbrojtjen e tyre bëhet me qëllim që të mbrohen burimet e ujit nga ndotja e qëllimshme apo e rastësishme e cila mund të ketë efekte negative në kapacitetin e burimit si dhe në vetitë natyrore të ujit të burimit. Me qëllim të mbrojtjes së burimeve të ujit, përcaktohen tri zona të mbrojtura sanitare: *Zona e kufizimit, zona e kontrollimit, dhe zona e mbikëqyrjes.*

Zona e I-rë Zona e kufizimit

1. Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtur sanitare të një burimi nëntokësor në akuifer intergranular paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar së paku 10(dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujëmarrëse dhe objekteve përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit.
2. Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtur sanitare duhet të jetë i rrethuar me rrethojë të fortë dhe stabile, e cila duhet të jetë e lartë së paku 2 metra, në mënyrë që të pengohet hyrja e shtazëve apo e personave të pa-autorizuar.
3. Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtur shënohet me shenja të dukshme dhe vendosen në hyrjet e zonës si dhe në lokacione tjera të përshtatshme të kufirit të zonës me qëllim të njoftimit të kalimtarëve se ata gjenden në afërsi të zonës së mbrojtur dhe se u ndalohet hyrja e personave të paautorizuar.

Zona e II-të, Zona e Kontrolluar

1. Territori i zonës së II-të përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së I-rë deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 50 (pesëdhjetë) ditë për të arritur te vepra ujëmarrëse.



2. Kufiri i zonës së II-të të mbrojtur për burime dhe puse duhet të jetë së paku 100 (njëqind) metra nga zona e I-rë e mbrojtur.
3. Kufiri i Zonës së II-të të shënohet me vendosjen e shenjave të dukshme në hyrjet e zonës si dhe në lokacionet tjera të përshtatshme të kufirit të zonës.

Zona e III-të, Zona e Mbikëqyrur

1. Territori i zonës së III-të të mbrojtur për burimet në akuifer intergranular përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të të mbrojtur deri te ujëndarësi hidrogeologjik.
2. Në rastet kur kufiri hidrogeologjik nuk është i njohur, zona e III-të përfshin hapësirën deri te kufiri prej të cilit ujit nëntokësor i nevojiten së paku 200 (dyqind) ditë për të arritur te vepra ujëmarrëse.
3. Kufiri i zonës së III-të duhet të jetë së paku 500 (pesqindë) metra nga vepra ujëmarrëse.

Masat mbrojtëse të Zonës së I-rë

1. Në Zonën e I-rë të mbrojtur sanitare të burimeve nëntokësore në akuifer intergranular ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë.
2. Gjatë punimit të rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi me ç'rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

Lejohet: Kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve që mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit.

Masat mbrojtëse të Zonës së II-të

1. Në Zonën e II-të të mbrojtur sanitare të burimeve nëntokësore në akuifer intergranular ndalohet zhvillimi i aktivitetetve dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin, në menyrë specifike:
 - Përdorimi i plehrave kimike dhe atyre të kafshëve;
 - Përdorimi i pesticideve, herbicideve, dhe insekticideve;
 - Ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;



- Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve;
- Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale;
- Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajra dhe materia tjera të rrezikshme;
- Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme;
- Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës;
- Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative.

Masat mbrojtëse të Zonës së III-të

1. Në hapësirën e zonës së III-të ndalohen kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e banimit, dhe në mënyrë specifike:
 - Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajtuara të kanalizimit;
 - Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materia radioaktive dhe materia tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri të petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj).
 - Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
 - Përpunimi deponimi apo manipulimi me materia kimike, karburante, vajra dhe materia tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
 - Ndërtimi dhe operimi i impinateve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
 - Ndërtimi i autoudhëave, aeroporteve, parkingjeve, ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;
 - Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materia tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
 - Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbojtjen e bimëve;



- Ndikimi varrezave të reja zgjerimi i varrezave ekzistuese;
- Aktivitetet e tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.

7. ZONAT E MBROJTURA SANITARE NË BURIMET NËNTOKËSORE NË AKUIFER

Burimet nëntokësore: Burimi i ujit mineral në Poklek dhe burimet nëntokësore tjera

Zona e I-rë, Zona e Kufizimit

1. Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtur të një burimi nëntokësor në akuifer karstik paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar 20 (njëzet) metra nga vepra ujëmarrëse. Kjo zonë duhet të përfshijë edhe të gjitha objektet përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit të ujit.
2. Në rastet kur nuk mund të sigurohet largësia prej 20 (njëzet) metra, kjo largësi duhet të jetë së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha objektet ujëmarrëse me kusht që të vërtetohet se burimi nuk rrezikohet.
3. Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtur duhet të jetë i rrethuar me rrethojë të fortë dhe stabile, të lartë së paku 2 (dy) metra, në mënyrë që të pengohet hyrja e shtazëve apo e personave të paautorizuar.
4. Kufiri i zonës së I-rë të mbrojtur shënohet me shenja.

Zona e II-të - Zona e Kontrollimit

1. Territori i zonës së II-të sanitare për burimet e ujit në akuifer karstik përfshin hapësirën jashtë kufirit të zonës së I-rë të mbrojtur deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku (24 njëzet e katër) orë për të arritur deri në veprën ujëmarrëse, me ç'rast ky kufi nuk mund të jetë më afër se 500 (pesëqind) metra prej veprës ujëmarrëse.
2. Kufiri i zonës së II-të të mbrojtur shënohet me shenja sipas udhëzimit administrativ për kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit.

Zona e III-të - Zona e Regjimit të Lehtë të Mbrojtjes dhe Mbikëqyrjes



1. Territori i zonës së III-të sanitare për burimet në akuifer karstik përfshin hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 20 (njëzet) ditë për të arritur te vepra ujëmarrëse.

Masat mbrojtëse në Zonën e I-rë

1. Në zonën e I-rë sanitare të burimeve nëntokësore në akuifer karstik ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë.
 - *Përgjashtimisht në zonë e I-rë sanitare, lejohet:* Kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve tjera që mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit.
 - Punimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi, të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

Ndalesat në Zonën e II-të të Mbrojtur Sanitare:

Në zonën e II-të të mbrojtura sanitare të burimeve nëntokësore në akuifer karstik ndalohet zhvillimi i aktiviteteve siç janë:

- Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajuara të kanalizimit;
- Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materia radioaktive dhe materia tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri të petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj).
- Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
- Përpunimi deponimi apo manipulimi me materia kimike, karburante, vajra dhe materia tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
- Ndërtimi dhe operimi i impinateve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;



- Ndërtimi i autoudhëave, aeroporteve, parkingjeve, ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;
- Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materia tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
- Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbojtjen e bimëve;
- Ndikimi varrezave të reja zgjerimi i varrezave ekzistuese;
- Aktivitetet e tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.

Ndalesat në Zonën e III-të të Mbrojtur Sanitare:

1. Në hapësirën e zonë së III-të sanitare ndalohet kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat, dhe në mënyrë specifike:
 - Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajuara të kanalizimit;
 - Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materia radioaktive dhe materia tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri të petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj).
 - Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
 - Përpunimi deponimi apo manipulimi me materia kimike, karburante, vajra dhe materia tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
 - Ndërtimi dhe operimi i impinateve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
 - Ndërtimi i autoudhëave, aeroporteve, parkingjeve, ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;



- Kryerja e shpimeve hulumtuese për nafte, gaz tokësor dhe materia tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
- Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbojtjen e bimëve;
- Ndikimi varrezave të reja zgjerimi i varrezave ekzistuese;
- Aktivitetet e tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.



8. ZONAT E MBROJTURA SANITARE TË BURIMEVE SIPËRFAQËSORE: AKUMULACIONET DHE LIQENE

Burimet sipërfaqësore: Koroticë të epërme, Baicë, Krajkovë dhe burimet tjera sipërfaqësore – Lumenjtë

Zona e I-rë, Zona e Kufizimit

1. Zona e parë përfshin liqenin respektivisht akumulacionin dhe brezin mbrojtës përgjatë akumulacionit me gjerësi 10 (dhjetë) metra nga kufiri i nivelit më të lartë të ujit;
2. Veprën ujëmarrëse dhe objektet tjera përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.
3. Vendosja e shenjave paralajmëruese.

Zona e II-të - Zona e Kontrollimit

1. Territori i zonës së II-të të mbrojtur për akumulacione përfshinë: Brezin e gjerësisë prej 200 (dyqind) metra prej kufirit të zonës së I-rë të mbrojtur përgjatë gjithë liqenit ose akumulacionit.
2. Brezin e gjerë prej 50 (pesëdhjetë) metra në të dy anët e ujërrjedhave që derdhen në liqe dhe akumulacion në tërë gjatësinë e pellgut të akumulacionit.

Zona e III-të - Zona e Mbikëqyrjes

1. Territori i zonës së III-të të mbrojtur për liqene dhe akumulacione shtrihet jashtë kufijve të zonës së II-të të mbrojtur dhe përfshinë tërë gjerësinë e pellgut natyror që derdhet në akumulacion ose liqe.

Ndalesat në Zonën e I-rë të Mbrojtur Sanitare të liqeneve dhe akumulacioneve janë:

- Kultivimi i produkteve bujqësore përpos në rastet e prodhimtarisë ekologjike pa përdorimin e plehrave;
- Prodhimtaria e bagëtisë përpos për nevojat e bujqësisë respektivisht fermat deri 20 (njëzet) krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikën e mira të bujqësisë;
- Ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;



- Transporti rrugor i materieve kimike, karburanteve të lëngëta, dhe materieve tjera të rrezikshme;
- Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve magjistrale dhe hekurudhave;
- Ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
- Stacionet e reciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
- Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit në akumulacin;
- Kryerja e punimeve, ndërtimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike, përpos atyre për marrjen, trajtimin, dhe transportimin e ujit në sistemin e ujësjellësit;
- Përdorimi i plehrave dhe preparateve për mbrojtjen e bimëve;
- Shkarkimi i ujërav të ndotura nga objektet prodhuese dhe të ujërave që përdoren për pastrimin e pajisjeve për trajtimin e ujit;
- Shfrytëzimin e të gjitha llojeve të mjeteve të lundrimit me mjete motorike;
- Sportet e ujit, peshkimi sportiv dhe kultivimi i peshkut;
- Mbajtja dhe furnizimi me ujë i kafshëve;
- Qarkullimi publik i automjeteve dhe këmbësorëve.

Ndalesat në Zonën e II-të të Mbrojtur Sanitare të liqeneve dhe akumulacioneve janë:

- Kultivimi i produkteve bujqësore përpos në rastet e prodhimtarisë ekologjike pa përdorimin e plehrave;
- Prodhimtaria e bagëtisë përpos për nevojat e bujqësisë respektivisht fermat deri 20 (njëzet) krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikën e mira të bujqësisë;
- Ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;
- Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve magjistrale dhe hekurudhave;
- Ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
- Stacionet e reciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
- Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit në akumulacion etj.



Ndalesat në Zonën e III-të

Në hapësirën e zonës së III-të të mbrojtur sanitare të liqeneve dhe akumulacioneve ndalohet:

- Deponimi i mbeturinave;
- Shkarkimi ujërave të ndotura të papërpunuara;
- Ndërtimi i objekteve për deponim, transport, manipulim, dhe përpunim të materieve radioaktive dhe materieve tjera të rrezikshme dhe të dëmshme për ujin përfshirë objektet për deponimin e naftës dhe derivateve të naftës;
- Ndërtimi i objekteve për deponim transport, manipulim dhe përpunim të materieve radioaktive dhe materieve tjera të rrezikshme dhe të dëmshme për ujin përfshirë objektet për deponimin e naftës dhe derivateve të naftës;
- Ndërtimi i rrugëve pa objekte për grombullimin e vajrave dhe yndyrave dhe të atyre për trajtimin e ujërave atmosferik;
- Eksploatimi i rërës, zhavorrit, dhe argjilës.



9. ZONAT E MBROJTURA SANITARE NË BURIMET SIPËRFAQËSORE: UJËRRJEDHAT E HAPURA

Zona e I-rë, Zona e Kufizimit

1. Zona e I-rë sanitare në rastet e burimeve të ujit nga ujërrjedhat përfshin territorin përreth veprës ujëmarrëse në largësi së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujëmarrëse dhe të gjitha objekteve përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.
2. Kufiri i zonës së I-rë sanitare në pjesën tokësore duhet të jetë i rrethuar me rrethojë të fortë dhe stabile, e cila duhet të jetë e lartë së paku 2 metra, në menyrë që të pengohet hyrja e shtazëve apo e personave të pa-autorizuar.
3. Kufiri i zonës së I-rë të mbrojtur shënohet me shenja të dukshme dhe vendosen në htrjet e zonës si dhe në lokacionet tjera të përshtatshme të kufirit të zonës me qëllim të njoftimit të kalimtarëve se ata gjenden në afërsi të zonë së mbrojtur dhe se u ndalohet hyrja e personave të paaautorizuar.
4. Vendosja e shenjave.

Zona e II-të - Zona e Kontrollimit

1. Zona e dytë e mbrojtur sanitare në rastet e burimeve të ujit nga ujërrjedhat e hapura përcaktohet në bazë të elaboratit për mbrojtjen e burimit të ujit me ç'rast kufiri i kësaj zone nuk duhet të jetë më i vogël se 1000 (njëmijë) metra nga vepra ujëmarrëse në rrjedhën e sipërme të ujërrjedhës duke përfshirë ujërrjedhen dhe brezin prej 30 metrash në të dyja anët e ujërrjedhës.
2. Kufiri i zonës së II-të shënohet me vendosjen e shenjave të dukshme dhe vendosen në hyrjet e zonës si dhe në lokacionet tjera të përshtatshme të kufirit të zonës.

Ndalesat në Zonën e I-rë

- Në zonën e I-rë sanitare të ujërrjedhave ndalohet: Kryerja e të gjitha llojeve të punimeve dhe aktivitetetve, përpos atyre për marrjen, trajtimin dhe transportimin e ujit në sistemin e ujësjellësit.



- Përdorimi i plehrave dhe preparateve për mbrojtjen e bimëve.


Ndalesat në Zonën e II-të

- Në Zonën e II-të sanitare të ujërrjedhave ndalohen këto aktivitete: Kultivimi i produkteve bujqësore përpos në rastet e prodhimit ekologjik pa përdorimin e plehrave;
- Prodhimtaria e bagëtisë përpos për nevojat e bujqësisë respektivisht fermat deri 20 (njëzet) krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikën e mira të bujqësisë;
- Ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;
- Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve magjistrale dhe hekurudhave;
- Ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
- Stacionet e reciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
- Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit në akumulacion etj.

Koment: Komuna është përgjegjëse për zbatimin e masave mbrojtëse për zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit brenda territorit në Komunën e Glogocit. Për menaxhimin më efikas të ujërave Komuna e Glogocit duhet të koordinohet me aktivitetet, vendimet, masat dhe qëllimet e vendosura nga niveli qendror e sidomos nga Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e ujërave.

10. ZONA E REZERVAVE MINERARE DHE FUSHAT E EKSPLOATIMIT

Korniza ligjore në lidhje me industrinë minerare duhet të shoqërohet dhe të harmonizohet me direktivat përkatëse evropiane, reformat dhe ristrukturimi duhet të zbatohet dhe roli i Komunës duhet të jetë i qartë dhe i përkufizuar në sektorin minerar. Çfarëdo reforme ose procesi i ristrukturimit që do të ndodh detyruesisht duhet t'i trajtojë çështjet mjedisore, shoqërore dhe aspektet e zhvillimit ekonomik. Si ndotës të mjedisit e veçanërisht ndikimit negativ në ajër në Komunën e Glogocit konsiderohen aktivitetet nga operatori industrial New Feronikeli, aktivitetet e gurëthyesve, transporti, përdorimi i thëngjillit dhe drurit për ngrohje nga ekonomitë familjare, komerciale dhe institucionale, etj.



HARTA 4: ZONA E REZERVAVE MINERARE DHE FUSHAT E EKSPLOATIMIT

Problemet mjedisore që burojnë prej zonave për deponimin e mbetjeve industriale dhe aktiviteteve si ndërtimi i ndërtesave si minierë e xeheve dhe gurorë, proceseve minerare, deponitë e përkohshme të mbeturinave si pikat më kritike të ndotjes së mjedisit në komunë të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë dhe të merren veprime të menjëhershme.

Ndikimet e mundshme në mjedis janë:

- Kontaminimi i ujërave nëntokësore nga rrjedhja e metaleve nga deponitë, minerat dhe gurorët;
- Kontaminimi i sedimenteve dhe ujërave sipërfaqësore nga miniera e xeheve, metaleve gurore, materialet e deponive të cilat shkaktojnë erozion të sipërfaqes së deponive si dhe të shkarkimit të ujërave të kontaminuara nëntokësor në sipërfaqe;
- Kontaminimin e ajrit nga retë e pluhurit nga deponitë gjatë erërave në periudhat me mot të thatë;
- Kontaminimi i tokës bujqësore nga deponimi i pluhurit të depozituar nga deponitë e mbyllura;



- Kontaminimi i hapësirave të banimit, rrugëve dhe shesheve publike nga deponimi i pluhurit.

Komuna e Glllogocit duhet të ndërmarr masat që nevojiten të zbatohen për zvogëlimin e degradimit të mjedisit dhe të ndikimit sa më të vogël në shëndetin e njeriut janë:

- Zbatimi i plotë i Ligjit për Miniera dhe të legjislacionit mbështetës;
- Zbatimi i strategjisë minerare 2010-2025;
- Rehabilitimi i lokacioneve të deponive;
- Rehabilitimi i tokave bujqësore, dhe
- Fushatat e vetëdijesimit.
- Përveç kësaj, programet për përmirësimin e tokës bujqësore janë më së të nevojshme sa më parë.


Pastrimi i hapësirave publike dhe vendbanimeve, rehabilitimit i tokës do të kontribuonin në një jetë më të mirë për njerëzit në zonat e ndikuara në Komunën e Glllogocit dhe do të zvogëlonte kërcënimin mjedisor dhe për shëndetin e njeriut, e po ashtu do ta ngriste bashkëpunimin e gjerë.

ZONË BANIMI ME DENDËSI SHUMË TË ULËT (ME FUNKSIONE TJERA NE PAJTUESHMËRI)

Ndikimet potenciale mjedisore

Ndikimet e përgjithshme mjedisore të aktivitetetve të propozuara në zonën e banimit me dendësi shumë të ulët pritet të jenë të menaxhueshme, të përkohshme, disa të përhershme lokale, të cilat lidhen me punë ndërtimore dhe funksionale kryesisht në zonat rurale. Këto ndikime më së shpeshti përfshijnë, por nuk kufizohen në: a) pluhurin dhe zhurmën, b) Mbeturinat e gjeneruara c) emetimet akustikë d) rreziqet që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë.

Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vleresimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale



HARTA 5: ZONA E BANIMIT

Në bazë të analizave hulumtuese lidhur me ndikimin e zonës së banimit me dendësi shumë të ulët në mjedis si dhe duke iu referuar ndikimit shumë-dimensional në bazat e lartpërmendura ligjore, kemi arritur në konkluzion se mundësia e zgjerimit të zonave të banimit paraqet potencial të vogël për ndikim negativ në mjedis.



Megjithatë, ndikimet mjedisore janë të kontrollueshme dhe me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe masave zbutëse të përshkruara ndikimet mund të minimizohen. Përveç kësaj, lista e nën projekteve të mundshme në zonën e banimit nuk është plotësisht e përcaktuar dhe janë të mundshme llojet e tjera të ndikimeve.

Ndikimet në komponentët mjedisore: Emetimet e pluhurit nga transporti që bartin punonjësit dhe materialet; Pluhuri nga punimet tokësore dhe elementeve të tjera ndërtimore; Rreziqet nga puna në lartësi, makineritë e rënda dhe vozitja, rreziqet nga aksidentet e ngatërimit dhe rënies, neglizhimi i pajisjeve dhe veshjeve të sigurisë, procedurave ose shenjave paralajmëruese; Emetimet e zhurmës nga transporti dhe makineritë e rënda; Gjenerimi i mbeturinave - sasi e mbeturinave të ndërtimit do të gjenerohen kryesisht gjatë rehabilitimit të stuadiumit kombëtar ose çdo punimi të vogël riparimi/ndërtimi; Komuna duhet të krijojë mekanizma për kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së mbeturinave në territorin e saj.

Ndikimi në tokë - Do të jetë shumë i kufizuar, megjithatë, disa derdhje dhe rrjedhje të karburantit, vajrave, bojës etj. janë të mundshme; duhet patur kujdes ndikime mund të ketë edhe nga shfrytëzimet e lejuara siç janë: projektet e shtallave, gropat e sillosit, objektet për ruajtjen e bylmetit dhe objektet për depozitimin e e plehut.

Ndikimi në ujë - Nuk janë parashikuar ndikime të theksuara në ujë, një shkallë e vogël është e mundur nga derdhjet e kufizuara të lëngjeve të rrezikshme; nese nuk trajtohen mbeturinat si duhet; nga projektet e shtallave (fermave të vogla dhe të mesme); objektet për depozitimin e plehut etj.

- Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktivitetet e fermave mund të ndikohet në disa rrugë:
- Menaxhimi jo adekuat i plehut dhe urinës së kafshëve – mund të rezultojë me depërtimin deri në ujërat nëntokësore. Në veçanti kjo mund të jetë e dëmshme në rast të fermave me kapacitete të mëdha, dhe në rast se në afërsi ka zona nga ku përdoret uji për pije (qoftë ujëra sipërfaqësor, qoftë puse).

Ndikimi në ajër - Potenciali për ndotjen e kualiteti të ajrit është minimal. Nuk janë parashikuar ndikime



të theksuara në ajër, një shkallë e vogël është e mundur nga punët e ndërtimit, lirimi i grimcave të pluhurit në ajër, nga përdorimi i drunjëve dhe thëngjillit për ngrohje etj.

Ndikimi në natyrë - Janë parashikuar ndikime në natyrës sa i përket ndërtimeve të reja si objekte të banimit, infrastruktura rrugore, shfrytëzimi për prodhim bujqësor (shtallë për kafshë) etj. Sa i përket zonave të mbrojtura nuk është parashikuar ndikim pasi që nuk do të bëhen punime në zonat e mbrojtura dhe punimet janë punime të kufizuara ndërtimore.

Flora dhe fauna – Për ndikimet e theksuara në florë dhe faunë rekomandohet projektet ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, dhe të zbatohen masat për ruajtjen e tyre.

Masat Zbutëse

Efektet potenciale të pafavorshme që priten nga aktivitetet në zonën e banimit me dendësi shumë të ulët duhet të minimizohen duke zbatuar në mënyrë strikte legjislacionin mjedisor kombëtar dhe lokal, procedurat dhe udhëzimet si dhe masat dhe monitorimet e përcaktuara nga VSM-ja. Ndikimet e identifikuar në kapitullin e mëparshëm janë të lokalizuara në një zonë të vogël, me ashpërsi të reduktuar, lehtësisht të zbutura me masat tipike për zvogëlimin e ndikimeve në punimet ndërtimore:

- Emetimet e pluhurit duhet të kufizohen;
- Pastrimin e rregullt të zonës punuese, rrugëve, automjeteve dhe makinerive, si dhe spërkatjen me ujë të vendpunishteve dhe/ose të mbrohet nga era (p.sh. përmes mbrojtësve të erës);
- Punëtorët duhet të veshin rroba mbrojtëse (kapela të forta, doreza, etj.) dhe pajisje gjatë gjithë kohës;
- Zjarri i hapur të jetë rreptësisht i ndaluar dhe po ashtu çdo lloj shqetësimi i kafshëve (gjuetia ilegale, kapja për tregti dhe të tjera), grumbullimi i bimëve, ushqimit pyjor, drurit dhe produkteve të tjera;
- Të gjitha punët të kryhen në një mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar, të dizajnuara për të minimizuar ndikimet ndaj banorëve fqinjë dhe mjedisit;
- Vendpunishtja duhet të zërë vetëm sipërfaqet e nevojshme për kryerjen e punimeve.
- Gjatë ndërtimit, punëtorët duhet të kufizohen në zonat e ndërtimit dhe qasja në zonën e hapur përreth duhet të rregullohet në mënyrë të rreptë.



- Puna gjatë natës duhet të shmanget nëse është e mundur, sidomos në afërsi të vendbanimeve. Në rast se do të punohet gjatë natës duhet të merren leje përkatëse.
- Terreni në vendin e punës duhet të kthehet në gjendjen e tij të mëparshme, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë do të rehabilitohet në mënyrë adekuate.
- Grumbullimi, ndarja, transporti dhe përpunimi i mëtejshëm i mbeturinave të realizohet në përputhje me legjislacionin për mbeturina.

Objektet për depozitimin e plehut: Menaxhimi i drejtë i plehut; menaxhimi i lëvizjes së kafshëve dhe transportit të furnizimeve duhet të bëhet ashtu që të minimizoj pengesat në lëvizjen e banorëve dhe trafikut lokal;

Peizazhi - Për të ruajtur karakterin peizazhor të zonës, e vecmas ndikimin te komuniteti lokal, lokacioni i zonës të rrethohet me rrethoja përkatëse, me bimë të kultivueshme (gardh natyror, pisha dekorative etj);

ZONË BANIMI ME DENDËSI TË ULËT (ME FUNKSIONE TJERA NE PAJTUESHMËRI)

Ndikimet potenciale mjedisore

Ndikimet e përgjithshme mjedisore të aktivitetetve të propozuara në zonën e banimit me dendësi të ulët pritet të jenë të menaxhueshme, të përhershme disa të përkohshme, lokale, të cilat janë në kufi me zonën rurale dhe zonën bujqësore brenda kufirit kadastral të Glllogocit, Çikatovës së re dhe Komoranit. Ndikimet mjedisore lidhen me punë ndërtimore dhe funksionale kryesisht në zonat rurale, mungesën e hapësirave rekreative, mungesën e hapësirave sportive, zhurma e krijuar nga transporti, menaxhimin e mbeturinave, ndarjen e tyre për riciklim, rreziqet që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë.



Ndikimet e mundshme mjedisore

Në bazë të analizave hulumtuese lidhur me ndikimin e zonës së banimit me dendësi të ulët në mjedis si dhe duke iu referuar ndikimit shumë-dimensional në bazat e lartpërmendura ligjore, kemi arritur në konkluzion se mundësia e zgjerimit të zonës së banimit paraqet potencial të vogël për ndikim negativ në mjedis. Megjithatë, ndikimet e mundshme mjedisore janë të kontrollueshme dhe me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe masave zbutëse të përshkruara ndikimet mund të minimizohen. Përveç kësaj, lista e nën projekteve të mundshme në zonën e banimit nuk është plotësisht e përcaktuar dhe janë të mundshme llojet e tjera të ndikimeve.

Ndikimet në komponentët mjedisore

Emetimet e pluhurit nga transporti që bartin punonjësit dhe materialet; Pluhuri nga punimet tokësore, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve, dhe elementeve të tjera ndërtimore; Rreziqet nga puna në lartësi, makineritë e rënda dhe vozitja, rreziqet nga aksidentet e ngatërimit dhe rënies, neglizhimi i pajisjeve dhe veshjeve të sigurisë, procedurave ose shenjave paralajmëruese; Emetimet e zhurmës nga transporti dhe makineritë e rënda; Gjenerimi i mbeturinave - sasi e mbeturinave të ndërtimit që do të gjenerohen kryesisht nga punimet e ndërtimit, ndërtimi i pompave të derivateve, autolarje dhe automekanik, saldues etj.

Ndikimi në tokë - Ndikimet në tokë janë relative me ndikim negative në mjedis. Shfrytëzimi i tokës për aktivitete si: autolarje, automekanik, saldues, pomp të derivateve etj. Ndikimet mund të jenë të kufizuara, megjithatë, disa derdhje dhe rrjedhje të karburantit, vajrave, bojës etj. janë të mundshme. Pasi zona me dendësi të ulët të banimit gjendet në kufi me zonën rurale dhe bujqësore kujdes duhet ti kushtohet rrjedhjes së mundshme të karburanteve në tokë dhe ndotjen e tokës bujqësore.

Ndikimi në ujë - Janë parashikuar ndikime të mundshme në ujë, nga derdhjet e kufizuara të lëngjeve të rrezikshme, nga aktivitetet e autolarjeve, automekaniket, ndërtimi i pompave të derivateve, saldues të ndryshëm, nese nuk trajtohen mbeturinat si duhet, etj. Pasi zona me dendësi të ulët të banimit gjendet në kufi me zonën rurale dhe bujqësore kujdes duhet ti kushtohet rrjedhjes së lumit Drenica, i cili mund të ndotet nga ndikimet e aktiviteteve të sipër përmendura.

Ndikimi në ajër - Ndikime e theksuara në ndotjen e ajrit në zonën me dendësi të vogël, është e mundur nga punët e ndërtimit, lirimi i grimcave të pluhurit në ajër, transporti, përdorimi i lëndëve për djegje gjatë



stinë së dimirt (dru, thëngjill), mungesa e gjelbërimit, mungesa e parqeve rekreative etj.

Ndikimi në natyrë - Nuk janë parashikuar ndikime konkrete të theksuara në natyrë, mirëpo duhet të kemi parasyshë se me dendësimin e ri të banimit individual dhe shërbime tjera të nevojshme për komunitetin, kërkesat për shfytëzimin e resurseve natyrore do të rriten dhe ndikimet për shfrytëzimin e tyre janë të pashmangshme.

Masat Zbutëse

Efektet potenciale të pafavorshme që priten nga aktivitetet në zonën e banimit me dendësi të ulët duhet të minimizohen duke zbatuar në mënyrë strikte legjislacionin mjedisor, procedurat dhe udhëzimet administrative si dhe masat dhe monitorimet e përcaktuara nga VSM-ja.

- Shtimi i parqeve rekreative, sportive;
- Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m²/banor;
- Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banor;
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara sipas normave ndërkombëtare në vendet urbane për kokë të banorit duhet të jenë 20 m² sipërfaqe e gjelbëruar.
- Të kufizohen emetimet e pluhurit, përmes pastrimit të rregullt të zonës punuese, rrugëve, automjeteve dhe makinerive, si dhe spërkatjen me ujë të vendpunishtes dhe/ose të mbrohet nga era (p.sh. përmes mbrojtësve të erës).
- Punëtorët duhet të veshin rroba mbrojtëse (kapela të forta, doreza, etj.) dhe pajisje gjatë gjithë kohës.
- Zjarri i hapur të jetë rreptësisht i ndaluar dhe po ashtu çdo lloj shqetësimi i kafshëve (gjuetia ilegale, kapja për tregti dhe të tjera), grumbullimi i bimëve, ushqimit pyjor, drurit dhe produkteve të tjera.
- Të gjitha aktivitetet të kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar, të dizajnuara për të minimizuar ndikimet ndaj banorëve fqinjë dhe mjedisit.
- Vendpunishtet duhet të zënë vetëm sipërfaqet e nevojshme për kryerjen e punimeve.
- Gjatë ndërtimit, punëtorët duhet të kufizohen në zonat e ndërtimit dhe qasja në zonën e hapur përreth duhet të rregullohet në mënyrë të rreptë.



- Të shmangët puna gjatë natës nëse është e mundur, sidomos në afërsi të vendbanimeve. Në rast se do të punohet gjatë natës duhet të merren leje përkatëse.
- Terreni në vendin e punës duhet të kthehet në gjendjen e tij të mëparshme, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë do të rehabilitohet në mënyrë adekuate.
- Grumbullimi, ndarja, transporti dhe përpunimi i mëtejshëm i mbeturinave duhet të realizohet në përputhje me legjislacionin për mbeturina.
- Autolarjet nuk duhet të kenë qasje në rrjetin e ujës-jellës lokal. Shfrytëzimi i ujit për larje të automjeteve duhet të jetë burimi i ujit nga bunarët lokal apo nga burimet tjera të ujit përveç të rrjetit të ujës-jellës lokal.
- Autolarjet nuk mund të vendosen në afërsi të rrathëve rrotullues. Ato do të lejohen në largësi prej 100 m gjatësi afër rrathëve rrotullues.
- Nuk duhet të vendosen në afërsi të zonave ujore, pasi rrezikojnë ndotjen e ujërave dhe shkaktojnë eutrofikimin e tyre;
- Ujërat që lirohen nga pastrami i makinave nuk duhet të kenë qasje në kanalizim pa u trajtuar paraprakisht;
- Lokacioni për vendosjen e servisit të karburantit duhet të jetë i tillë që rreziku nga zjarri dhe eksplodimi të jetë e zvogëluar në nivelin më të ulët të mundur. Kapaciteti më i madh i lejuar i rezervarit për karburant të veçantë është 50[m³], prej objekteve ku gjenden njerëzit dhe toka e fqinjëve, duhet të jenë larg së paku 5.0[m]. Nëse objektet fqinj, janë objekte me ngarkesë të shtuar të zjarrit [$>1000 \text{ MJ/m}^2$] ose në to 11 gjendet më shumë se 50 njerëz, duhet respektuar lëvizjet e cekura në dispozitat për mbrojtjen nga zjarri për objekte të tilla;
- Gjatë mbushjes së rezervarëve të depozitave të servisit dhe mbushjes së rezervarëve të automjeteve me karburante, duhet plotësuar kërkesat e emisioneve të lejuara të vlerave të bashkëdyzimeve organike të avullit në ajër;
- Gjatë ndarjes së ujërave teknologjike të zeza nga sipërfaqja duhet siguruar që ujërat e zeza, para lëshimit jashtë zonave të servisit të karburantit, të ndahen sipas kanalizimeve të zbatuar dhe të sanksionuar teknologjikisht dhe përmes aparateve pastruese për largimin e vajrave minerale dhe të benzinës (në vazhdim: grumbulluesit e vajrave), efekti pastrues i të cilave duhet të jetë në përputhje me kriteret ligjore për menaxhimin e ujërave të zeza.
- Grumbulluesi i ujërave, përmes të cilit ndahen ujërat teknologjike të zeza nga servisi i karburantit duhet të eksploatohet dhe të funksionojnë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe kërkesat për emisionet gjatë ndarjes së ujërave teknologjike të zeza prej serviseve të karburantit.



Automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre - Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të automjeteve mbeturinë duke:

- Përcaktuar taksë për importin dhe prodhimin e automjeteve për të mbuluar koston e menaxhimit/trajtimin të tyre pasi të bëhen mbeturinë; Inkurjuar qytetarët dhe pronarët që në fund të jetës së automjeteve të tyre, ato ti sjellin në pikat e grumbullimit ose çmontimit; Organizuar sistemin për grumbullimin dhe transportimin e automjeteve mbeturinë deri në vendet e trajtimit;
- Sistemin e menaxhimit të automjetëve mbeturinë do të përfshinë edhe mbeturinat e mjeteve hekurudhore; Ripërdorimin e pjesëve funksionale të automjeteve mbeturinë.

Gomat mbeturinë - Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të gomës duke:

- Përcaktuar taksë të veçantë për importin dhe prodhimin e gomave për të mbuluar koston e menaxhimit dhe trajtimit të tyre, pasi të bëhen mbeturinë;
- Goma e grirë në copa apo pluhur gome e cila mund të eksportohet, ose do të përpunohet në produkte të ndryshme gome si mbushës/shtesë për asfalt etj. Textili mund të shkojë në deponi të mbeturinave komunale ose të digjet në furrat industriale. Për një projekt i tillë do të ishte i zgjidhje e duhur për mbeturinat e gomave. Kapaciteti i fabrikës duhet harmonizuar në ato kapacitete që mund të riciklojnë gomat të cilat krijohen mbeturinë në Komunë.
- Krijimi i sistemit për grumbullimin dhe transportin e gomave të përdorura.

Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike - Të krijohet sistemi i qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike që do të rezultojë në mbledhjen e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike. Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike duke:

- Grumbulluar dhe transportuar mbeturina nga pajisjet elektrike dhe elektronike në qendrat grumbulluese dhe demontuese për këto lloje të mbeturinave;
- Inkurjuar operatorët që të bëjnë ndarjen, ripërdorimin dhe riciklimin mbeturinave;
- Eksportimi i mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike në rast se nuk mund të trajtohen në Kosovë.



ZONË BANIMI ME DENDËSI TE MESME (ME FUNKSIONE TJERA NE PAJTUESHMËRI)

Ndikimet e përgjithshme mjedisore të aktivitetetve të propozuara në zonën e banimit me dendësi të mesme pritet të jenë të menaxhueshme, të përhershme disa të përkohshme, lokale, dhe të kontrollueshme. Dendësimi i zonës me dendësi të mesme të banimit është parapa me ngritjen e kualitetit të banimit me dominim të banim induvidual dhe shërbime përcjellëse tregtare, bankare, fetare, profesionale, shkollore, e kulturore, parkingje publike, autolarje, automekanik, pompë të derivateve etj. prandaj edhe ndikimet mjedisore lidhen me këto aktivitete.

Ndikimet e mundshme mjedisore

Në bazë të analizave hulumtuese lidhur me ndikimin e zonës së banimit me dendësi të mesme në mjedis si dhe duke iu referuar ndikimit shumë-dimensional në bazat e lartpërmendura ligjore, kemi arritur në konkluzion se mundësia e zgjerimit të zonës së banimit paraqet potencial të vogël për ndikim negativ në mjedis. Megjithatë, ndikimet e mundshme mjedisore janë të kontrollueshme dhe me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe masave zbutëse të përshkruara ndikimet mund të minimizohen. Përveç kësaj, lista e nën projekteve të mundshme në zonën e banimit me dendësi të mesme nuk është plotësisht e përcaktuar dhe janë të mundshme llojet e tjera të ndikimeve.

Ndikimet mjedisore

- Emetimet e pluhurit nga transporti që bartin punonjësit dhe materialet;
- Pluhuri nga punimet tokësore, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve, heqja e mureve, llaçeve, izolimit dhe elementeve të tjera ndërtimore;
- Rreziqet nga puna në lartësi, makineritë e rënda dhe vozitja, rreziqet nga aksidentet e ngatërimit dhe rënies, neglizhimi i pajisjeve dhe veshjeve të sigurisë, procedurave ose shenjave paralajmëruese;
- Emetimet e zhurmës nga transporti dhe makineritë e rënda;
- Gjenerimi i mbeturinave etj etj.



Ndikimi në tokë – Toka mund të kontaminohet me derdhjen aksidental të karburantve, vajrave, mbeturinave, bojës etj. Ndikime mund të ketë edhe nga shfrytëzimet e lejuara siç janë: projektet e shtallave, gropat e sillosit, objektet për ruajtjen e bylmetit dhe objektet për depozitimin e e plehut.

Ndikimi në ujë - Janë parashikuar ndikime të mundshme në ujë, nga derdhjet e kufizuara të lëngjeve të rrezikshme, nga aktivitetet e autolarjeve, automekaniket, ndërtimi i pompave të derivative, suldues të ndryshëm, nese nuk trajtohen mbeturinat si duhet, etj.

Ndikimi në ajër - Ndikime e theksuara në ndotjen e ajrit në zonën me dendësi të mesme, është e mundur nga punët e ndërtimit, lrimi i grimcave të pluhurit në ajër, transporti, përdorimi i lëndëve për djegje gjatë stinë së dimirt (dru, thëngjill), mungesa e gjelbërimit, mungesa e parqeve rekreative etj.

Ndikimi në natyrë – Duke pasur parasyshë se me dendësimin e ri të banimit individual dhe shërbime tjera të nevojshme për komunitetin, kërkesat për shfytëzimin e resurseve natyrore do të rriten dhe ndikimet për shfrytëzimin e tyre janë të pashmangshme, prandaj edhe ndikimet ne natyrë janë prezente.

Efektet potenciale të pafavorshme që priten nga aktivitetet në zonën e banimit me dendësi të mesme duhet të minimizohen duke zbatuar në mënyrë strikte legjislacionin mjedisor, procedurat dhe udhëzimet administrative si dhe masat dhe monitorimet e përcaktuara nga VSM-ja.

Cilësia e ajrit

- Vendet e ndërtimit, rrugët e transportit dhe vendet e trajtimit të materialeve duhet të spërkatën me ujë në ditë të thata dhe me erë;
- Materialet e ndërtimit duhet të ruhen në vende të përshtatshme të mbuluara për të minimizuar pluhurin;
- Ngarkesat e automjeteve që kanë gjasa të lëshojnë pluhur duhet të mbulohen;
- Rrugët fshihen dhe pastrohen rregullisht në pika kritike;
- Mbajeni shtresën e punueshme dhe rezervat e ndara;
- Mbroni me fleta/rrethoja në rast të motit me erë;
- Lokalizoni rezervat larg linjave të drenazhit, rrugët ujore natyrore dhe vendet e ndjeshme ndaj erozionit tokësor.
- Të gjitha ngarkesat e tokës mbulohen kur hiqen nga vendpunishtja për deponim.



- Të sigurohet që të makineritë dhe automjetet e transportit janë pajisur me pajisjet e duhura të kontrollit të emetimeve, mirëmbahen rregullisht dhe provohen.
- Nuk duhet të ketë lëvizje të tepruar të automjeteve ndërtimore në vendpunishte.

Cilësia e ujit dhe tokës

- Parandalimi i derdhjeve të rrezikshme që vijnë nga mbeturinat (magazinimi i përkohshëm i mbeturinave duhet të jetë i mbrojtur nga rrjedhjet dhe ato për mbetjet e rrezikshme ose toksike të pajisura me sistem sekondar të mbrojtjes, p.sh. kontejnerët me mur të dyfishtë ose me shirita).
- Nëse ndodhin derdhje të rrezikshme, duhet të pastrohet vendin dhe ndiqen procedurat dhe masat për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.
- Në rast të ndonjë rrjedhjeje që vjen nga zont e punimeve eventualisht të ndotura nga substanca të rrezikshme do të mblidhet në vend në një pellg të përkohshëm mbajtjeje dhe duhet të bartet në një impiant të përshtatshëm të licencuar për trajtimin e ujërave të zeza.
- Instalimi/sigurimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të përshtatshme sanitare për punëtorët.
- Ujërat e zeza nga këto burimet duhet të barten në impiante të përshtatshme për trajtimin e ujërave të zeza.
- Parandalimi i derdhjeve të rrezikshme që vijnë nga rezervuaret (sistemi sekondar i detyrueshëm i mbrojtjes, p.sh. kontejnerët).

Zhurma

- Duke qenë zonë urbane banimi niveli i zhurmës nuk duhet të tejkalojë 55 dB gjatë ditës dhe mbrëmjes dhe 45 dB gjatë natës;
- Puna e ndërtimit nuk duhet të lejohet gjatë natës, operacionet në vend punishte do të kufizohen nga ora 7:00 deri në ora 19:00 (dakorduar në leje).
- Pajisjet mekanike duhet të jenë të vendosura sa më larg zonave të banimit që është e mundur.

Erozioni i tokës

- Në rastin e derdhjeve, uji i ndotur duhet të futet në kontejner për të parandaluar kontaminimin e mëtejshëm dhe të transportohet në një impiant për trajtimin e ujërave të zeza.



- Automjetet dhe makineritë mund të parkohen, lahen dhe mirëmbahen vetëm në zonat e përcaktuara me sipërfaqe të papërshkueshme me një sistem grumbullimi dhe trajtimi (ndarës të vajit dhe yndyrës);
- Mbrojtja e sedimenteve të përhapura nga rrethojat dhe barrierat.

Siguria e popullatës

- Të informohen me kohë shfrytëzuesit e objekteve dhe komunitetet fqinje për punimet e ardhshme.
- Në rast të ndërprerjes së trafikut, të organizohen rrugë alternative në bashkëpunim me Komunën.

Mbrojtja e natyrës

- Ndalohet rreptësisht gjuetia ilegale, shqetësimi i kafshëve, grumbullimi i barishteve dhe ushqimit pyjor. Zjarret e hapura janë rreptësisht të ndaluara; Nuk duhet të ketë shpërndarje të mbeturinave; Para punimeve, zona duhet të kontrollohet për stofulla dhe fole; Nuk lejohet asnjë prerje e drunjve, nëse është e pashmangshme, duhet të merret një leje nga autoriteti kompetent konkretisht Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës; Të gjitha mbeturinat dhe materialet tjera si dhe pajisjet duhet të hiqen kur të përfundojnë aktivitetet; Të shmangen punimet gjatë sezonit të ngritjes së foleve/shturjes së zogjëve.

ZONE BANIMI ME DENDËSI TË LARTË (ME FUNKSIONE TJERA NË PAJTUESHMËRI)

Zonës e banimit me dendësi të lartë karakterizohet me disa aktivitete si banim induvidual dhe shërbime përcjellëse tregtare, bankare, fetare, profesionale, shkollore, e kulturore, argëtuese, dhe rekreative, parkingje publike, autolarje, automekanik, pompë të derivateve, ndërtesa me shumë njësi, shërbime të hotelerisë, hapësira të vogla artizanale etj. prandaj edhe ndikimet mjedisore lidhen me këto aktivitete.

Ndikimet e mundshme mjedisore

Në bazë të analizave hulumtuese lidhur me ndikimin e zonës së banimit me dendësi të lartë në mjedis si dhe duke iu referuar ndikimit shumë-dimensional në bazat e lartpërmendura ligjore, kemi arritur në konkluzion se mundësia e zgjerimit të zonave të banimit paraqet potencial relative për ndikime negative



në mjedis. Megjithatë, ndikimet mjedisore janë të kontrollueshme dhe me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe masave zbutëse të përshkruara ndikimet mund të minimizohen. Përveç kësaj, lista e nën projekteve të mundshme në zonën e banimit nuk është plotësisht e përcaktuar dhe janë të mundshme llojet e tjera të ndikimeve.

Ndikimet në komponentët mjedisore

- Emetimet e pluhurit nga transporti që bartin punonjësit dhe materialet;
- Pluhuri nga punimet tokësore, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve, heqja e mureve, llaçeve, izolimit dhe elementeve të tjera ndërtimore;
- Rreziqet nga puna në lartësi, makineritë e rënda dhe vozitja, rreziqet nga aksidentet e ngatërimit dhe rënies, neglizhimi i pajisjeve dhe veshjeve të sigurisë, procedurave ose shenjave paralajmëruese;
- Emetimet e zhurmës nga transporti dhe makineritë e rënda;
- Gjenerimi i mbeturinave;

Ndikimi në tokë - Të mundshme janë derdhje dhe rrjedhje të karburantit, vajrave, bojës, detergjentve, etj. Ndikime mund të ketë edhe nga shfrytëzimet e lejuara siç janë: Hapësira për riparim të automjeteve, autolarje, automekanik, parking, saldues, pompë të derivative, shërbimet tregtare, bankare, fetare etj.

Ndikimi në ujë - Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktivitetet e zonës së banimit me dendësi të lartë mund të ndikohet në disa rrugë: Derdhjet e kufizuara të lëngjeve të rrezikshme; Nese nuk trajtohen mbeturinat si duhet, hedhja e mbeturinave direkt në ujëra;

Ndikimi në ajër - Ndikime e theksuara në ndotjen e ajrit në zonën me dendësi të lartë, është e mundur nga punët e ndërtimit, lirimi i grimcave të pluhurit në ajër, transporti, përdorimi i lëndëve për djegje gjatë stinë së dimrit (dru, thëngjill), mungesa e gjelbërimit, mungesa e parqeve rekreative etj.

Ndikimi në natyrë - Nuk janë parashikuar ndikime konkrete të theksuara në natyrë, mirëpo duhet të kemi parasyshë se me dendësimin e ri të banimit individual dhe shërbime tjera të nevojshme për komunitetin, kërkesat për shfytëzimin e resurseve natyrore do të rriten dhe ndikimet për shfrytëzimin e tyre janë të pashmangshme.



Masat Zbutëse


Efektet potenciale të pafavorshme që priten nga aktivitetet në zonën e banimit me dendësi të lartë duhet të minimizohen duke zbatuar në mënyrë strikte legjislacionin mjedisor kombëtar dhe lokal, procedurat dhe udhëzimet si dhe masat dhe monitorimet e përcaktuara nga VSM-ja.

- Emetimet e pluhurit duhet të kufizohen përmes pastrimit të rregullt të zonës punuese, rrugëve, automjeteve dhe makinerive, si dhe spërkatjen me ujë të vendpunishtes dhe/ose të mbrohet nga era (p.sh. përmes mbrojtësve të erës).
- Punëtorët duhet të veshin rroba mbrojtëse (kapela të forta, doreza, etj.) dhe pajisje gjatë gjithë kohës.
- Zjarri i hapur të jetë rreptësisht i ndaluar dhe po ashtu çdo lloj shqetësimi i kafshëve (gjuetia ilegale, kapja për tregti dhe të tjera), grumbullimi i bimëve, drurit dhe produkteve të tjera pyjore.
- Të gjitha punët dueht të kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar, të dizajnuara për të minimizuar ndikimet ndaj banorëve fqinjë dhe mjedisit.
- Vendpunishtet duhet të zënë vetëm sipërfaqet e nevojshme për kryerjen e punimeve.
- Gjatë ndërtimit, punëtorët duhet të kufizohen në zonat e ndërtimit dhe qasja në zonën e hapur përreth duhet të rregullohet në mënyrë të rreptë.
- Puna gjatë natës duhet të shmanget nëse është e mundur, sidomos në afërsi të vendbanimeve. Në rast se do të punohet gjatë natës duhet të merren leje përkatëse.
- Terreni në vendin e punës duhet të kthehet në gjendjen e tij të mëparshme, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë do të rehabilitohet në mënyrë adekuate.
- Grumbullimi, ndarja, transporti dhe përpunimi i mëtejshëm i mbeturinave të realizohet në përputhje me legjislacionin për mbeturina.



VLERËSIMI STRATEGJIKË MJEDISOR - ZONAT MBISHTRESORE

Ndikimet e përgjithshme mjedisore të aktivitetetve të propozuara në zonat mbishtresore pritet të jenë me ndikime pozitive në mjedis. Pengimi i ndikimeve të dëmshme në mjedis bëhet duke futur në funksion instrumentet për mbrojtjen e mjedisit që janë të listuar në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit e që janë: - Infrastruktura ligjore; - Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit; - Instrumentet ekonomike; - Dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis; - Instrumentet për monitorimin e mjedisit; Menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik.



HARTA 6: ZONAT MBISHTRESORE

Infrastruktura ligjore mjedisore në Kosovë: Përdorimi i këtij instrumenti nënkupton zbatimin e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit si: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ligji për Pyjet e Kosovës, Ligji për Mbeturinat dhe Ligji për Minierat dhe Mineralet.



SIPËRFAQET E MBROJTURA TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Masat për mrojtjen e mjedisit

Masat e përgjithshme mbrojtëse si dhe masat e mbrojtjes për monumentin e trashëgimisë kulturore duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit për trashëgiminë kulturore, ligji nr. 02/L-88 aktet ligjore përcjellëse si dhe rregulloreve respektive. Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë legalisht fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme me qëllim që trashëgimia të shijohet nga gjeneratat e tashme dhe të jetë e gatshme për gjeneratat e ardhshme si një dokument historik dhe kulturor.

- Sipërfaqja ekzistuese gjelbëruese në kuadër të zonës së monumentit duhet të ruhet;
- Konservimi dhe mbrojtja e vlerave të TK dhe TN (asetet që kanë status të mbrojtur dhe ato të propozuara) në funksion të zhvillimit të turizmit;
- Konservimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkitekturore (kulla, shtëpi, kompleks banimi)
- Konservimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkeologjike
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes programeve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Organizmi dhe implementimi i fushatave vetëdijësuese për trashëgiminë kulturore në nivel komunal;
- Në rast renovimi, rikonstruktimi apo revitalizimi, gjelbërimi ekzisutes nuk duhet të pritët, dëmtohet.
- Peisazhi duhet të reflektojë dhe mbrojë karakterin si të monumentit ashtu edhe të mjedisit përreth duhet përdorur materialet dhe bimësia lokale.
- Ndalohet vendosja e parkingjeve para apo në afërsi të monumenteve që mund të pengojnë pamjen apo qasjen e lirë në monument;



- Ndalohet vendosja e kiosqeve, tezgave, shportave për mbeturina dhe elementeve tjera montazhe para apo në afërsi të monumenteve që mund të pengojnë pamjen apo qasjen e lirë në monument;

ZONAT NATYRORE

Sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës laramanisë biologjike dhe peisazhore dhe vlerave të saj përcaktohet me ligjin për mbrojtjen e natyrës Ligji Nr. 03/L-233. Ky ligj krijon bazën ligjore për mbrojtjen e natyrës, zhvillimin e qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht:

- Mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore; përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara; vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës; pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre; sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës; sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë; parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike; mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së; ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve të cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

Zbatimit i mbrojtjes së natyrës- Mbrojtja e natyrës zbatohet përmes ruajtjes së larmisë biologjike, peizazhore dhe vlerave të natyrës. Mbrojtja e natyrës zbatohet veçanërisht përmes: përcaktimit dhe vlerësimit të gjendjes së përbërësve të larmisë biologjike dhe peizazhore; zbatimit të masave të mbrojtjes së natyrës; vendosjes së kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe planet e menaxhimit me të mirat e natyrës në veprimtaritë e xehetarisë, bujqësisë, pylltarisë, gjuetisë, peshkatarisë, hidro-ekonomisë si dhe veprimtarive tjera me ndikim në natyrë; hartimit të raporteve për gjendjen e natyrës, nxjerrjen dhe zbatimin e strategjisë, programeve, planeve të veprimit dhe planeve të menaxhimit; përcaktimit të vlerave të natyrës dhe vlerave të mbrojtura të natyrës; themelimit të sistemit për administrim me vlerat e natyrës dhe



vlerat e mbrojtura të natyrës; lidhjes dhe harmonizimit të sistemit shtetëror me sistemin ndërkombëtar për mbrojtjen e natyrës; inkurajimit të hulumtimeve shkencore në lëmin e mbrojtjes së natyrës; njoftimit të publikut me gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës; inkurajimit dhe mbështetjes të mbrojtjes së natyrës përmes ngritjes së vetëdijes së publikut, posaçërisht përmes procesit të arsimimit.

- Komuna detyrohet, që në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, Strategjinë dhe Planin e Veprimit për mbrojtjen e natyrës si dhe dokumentet për planifikim hapësinor që: të kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore në territorin e vet; të shpallin zonat e mbrojtura që janë kompetencë e tyre; të sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre; të marrin pjesë në procedurën e shpalljes së zonave të cilat i shpall Kuvendi dhe Qeveria; të marrin pjesë në hartimin e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre; të mbajnë regjistrin për shënimet që janë me rëndësi për mbrojtjen e natyrës; të informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e tyre dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e saj.
- Zonat natyrore janë vendbanime të shumë llojeve të rralla bimore e shtazore dhe që bartin në vete shumë fenomene e dukuri të rralla e interesante, gjeologjike, morfologjike, hidrologjike e peizazhore.
- Zonat natyrore janë edhe burime të rëndësishme për zhvillim ekonomik, mirëqenie shoqërore, edukim dhe rekreacion. Me gjithë këtë, shfrytëzimi i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i këtyre vlerave dhe burimeve natyrore, mund të sjellë dëme të pariparueshme të cilat do të kenë për pasojë edhe zhdukjen e llojeve të rralla bimore dhe shtazore dhe dëmtimin e fenomeneve të rralla natyrore.
- Sipas të dhënave nga Raporti për Gjendjen e Natyrës 2015-2017 sot, Kosova ka 11.5 % të territorit të saj të mbrojtur me ligj, në kuadër të së cilit përfshihen zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme. Klasifikimi i zonave të mbrojtura bazohet në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L233) dhe pjesërisht është në harmoni me Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Zonat e mbrojtura të natyrës sipas këtij Ligji klasifikohen në 7 kategori: si: rezervatet strikte të natyrës, parqe kombëtare, parqe të natyrës, peizazhe, monumente të natyrës si dhe zona tjera natyrore më rëndësi të veçantë.



Masat e përgjithshme për mbrojtjen e Zonave të Natyrës

Mbrojtja e peizazheve - Ka për qëllim mbrojtjen e karakteristikave të ekosistemeve dhe llojeve të rralla e të rrezikuara, veçorive të peizazheve të rrezikuara, vlerave rekreative të peizazheve. Pëlqimi mjedisor jepet nëse konstatohet, se plani dhe projekti, nuk dëmton statusin e favorizuar të mbrojtjes së llojeve të mbrojtura apo të rrezikuara të habitateve dhe peizazheve. Ndikimi negativ ekziston nëse, plani ose projekti mund të shkaktojë: efekte negative tek një numër i konsiderueshëm i llojeve bimore, kërpudhave dhe llojeve shtazore të rrezikuara, të rralla ose të ndjeshme, si pasojë e veprimeve negative, nëse pritet çrregullim i madh në relacionet ose veprimet reciproke në mes të llojeve bimore dhe shtazore dhe faktorëve të tyre natyrorë, biotik ose abiotik (gjeologjike, klimatike, tokësore, ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor etj.) në ekosisteme apo pjesë të tyre.

Mbrojtja e llojeve të florës dhe faunës së egër – Përfshinë: Mbrojtjen e llojeve të shtazëve dhe bimëve nga dëmtimi nga ana e njeriut, Mbrojtjen dhe ruajtjen e habitateve të llojeve të florës e faunës së egër. Popullzimin e llojeve të rralla të florës dhe faunës së egër në vendet e përshtatshme për zhvillimin dhe shumëzimin e tyre. Shfarosja, dëmtimi, vrasja, zhvendosja ose shqetësimi i llojeve të mbrojtura të përcaktuara me aktet nënligjore si dhe të shpezëve të mbrojtur me Direktivën Evropiane 79/409/EEC është e ndaluar dhe sanksionohet me ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe atyre të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Pronarët e tokave në të cilat ndodhen habitatet e mbrojtura janë të detyruar: të ruajnë dhe përkujdesen për llojet dhe habitatet; të raportojnë organeve kompetente për ndryshimet e mundshme; të lejojnë aktivitetet hulumtuese dhe shkencore mbi llojet dhe habitatet e mbrojtura.

Për llojet me rëndësi të florës të evidentuara në Listën e kuqe ndalohe: vjelja, shkulja me rrënjë, apo dëmtimi si dhe grumbullimi i tyre, mbajtja, transportimi, shitja, dhe ndërrimi i tyre.

Për llojet e faunës të evidentuara në Listën e kuqe ndalohe: përvetësimi apo vrasja e qëllimshme; shqetësimi i qëllimshëm sidomos gjatë reproduktimit, gjumit dimëror dhe migrimit të tyre; shkatërrimi i qëllimshëm apo marrja e vezëve; heqja ose dëmtimi i qëllimshëm i çerdheve, strofllave dhe vendbanimeve



të tyre; mbajtja, transportimi, shitja ose këmbimi i llojeve të faunës së egër, veprimet të cilat mund të shkaktojnë zhdukje apo shqetësime të popullacionit të atyre llojeve.

Masat e veçanta për mbrojtjen e Zonave të Natyrës

Rezervati strikt i natyrës - Ruajtja e habitateve, ekosistemeve dhe llojeve nga shqetësimet; përkujdesja e resurseve gjenetike në gjendje dinamike dhe evolutive; përkujdesja e proceseve të themeluara ekologjike; ruajtja e vetive strukturore peizazhore apo relievve shkëmbore; ruajtja e mostrave të mjedisit natyror për studime shkencore; arsimimi dhe monitorimi mjedisor; ulja e shqetësimeve përmes planifikimit me kujdes të zbatimit të hulumtimeve dhe aktiviteteve të tjera; kufizimi i qasjes së publikut për informim.

Parqet kombëtare - Mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; përjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës; sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit.

Monumentet natyrore - Mund të jenë me karakter: gjeologjik (paleontologjik, mineralogjik, hidrogeologjik, gjeologjik, sedimentet); gjeomorfologjik (shpella, humnera, shkëmbinj); hidrologjik (burime, ujërrjedha, ujëvara, liqene); botanik (ekземplarët e rrallë të botës bimë, kopshti botanike). Qëllimet e mbrojtjes së monumenteve natyrore janë: mbrojtja dhe ruajtja e vetive të qëndrueshme natyrore me rëndësi të posaçme, cilësive unike, dhe vlerave inspiruese; ofrimin e mundësive për kërkime shkencore, arsimore, interpretuese dhe vlerësuese nga publiku.

Shpellat - Shpellat mund të vizitohen, të përdoren për qëllime turistike ose të tjera, vetëm pasi të jenë përshtatur për këto veprimtari, me autorizim dhe nën mbikëqyrjen e AKMM, strukturave përkatëse të turizmit dhe pushtetit lokal. Eksplorimi, hyrjet e autorizuar dhe çdo përdorim i shpellave, duhet të sigurojë mbrojtjen dhe pastërtinë e tyre, ruajtjen e mikroklimës, regjimit ujor, ekosistemeve, të tipareve gjeologjike dhe gjeomorfologjike, të gjetjeve paleontologjike e arkeologjike dhe të gjallesave.

Peizazhi i mbrojtur - mbajtja e stabilitetit në veprimet reciproke të natyrës dhe njeriut me mbrojtjen e peizazheve tokësore, ujore dhe shfrytëzimit tradicional të tokave, ndërtimeve, si dhe manifestimeve shoqërore dhe kulturore; përkrahja e mënyrës së jetesës dhe aktiviteteve ekonomike të cilat janë në harmoni



me natyrën; ruajtja e larmisë së peizazheve, habitateve të llojeve të ngjashme dhe ekosistemeve të ndalojë dhe parandalojë shfrytëzimin apo uzurpimin e tokave dhe ndërmarrja e aktiviteteve që nuk janë në pajtim me qëllimet e mbrojtjes; krijimin e mundësive për rekreacion dhe turizëm të cilat i përgjigjen kategorive të zonave; nxitja e aktiviteteve shkencore dhe arsimore për të mirën afatgjatë të popullsisë si dhe shtimin e mbështetjes publike për mbrojtjen e atyre zonave; ofrimi i benificioneve dhe kontributit në mirëqenien e komunitetit përmes sigurimit të prodhimeve natyrore (siç janë: prodhimet ekologjike të pyllit dhe peshkimi) dhe shërbimet (siç janë: uji i pastër dhe të ardhurat nga turizmi).

Zona e mbrojtur e resurseve natyrore - Komuna duhet të përkujdesen për ruajtjen e diversitetit biologjik duke mbrojtur nga dëmtimi ose shkatërrimi i habitateve si: ujërat e rrjedhshëm me vegetacion të veçantë; burimet dhe rrjedhat e ujërave minerale; ujëvarat dhe rrjedhat të ngjajshme atraktive; diversitetet e tjera me karakteristika të veçanta.

Rekomandime:

Të vazhdohet studimi i vlerave natyrore dhe biodiversitetit në tërë territorin e Komunës së Glllogocit;

Inspektorati i Komunës së Glllogocit në bashkëpunim me Inspektoriatin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të rrisë numrin e inspektimeve për ndërhyrjet në Zonat e mbrojtura;

Të bëhen hulumtime shkencore për florën, faunën dhe habitatet në territorin e të gjitha zonave të mbrojtura të Komunës së Glllogocit;

Të shtohen aktivitetet për monitorimin e gjendjes dhe mbrojtjen e florës dhe faunës (bimëve endemike dhe mjekuese) dhe ekosistemeve në territorin e Komunës.

Të shtohen aktivitetet për monitorimin e vendeve turistike, monitorimin e pronave në pronësi private si dhe monitorimin dhe inspektimin e shfrytëzimit të resurseve natyrore;

Të vendosen tabelat informuese, (aty ku janë dëmtuar) në të gjitha Zonat e mbrojtura.

Të ndërmerren masa shtesë për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, zjarret, insektet dëmtues dhe sëmundjet;

Të rriten aktivitetet dhe veprimet që ndërlidhen me informimin dhe vetëdijesimi i publikut për mbrojtjen e resurseve natyrore.

Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim shkatërrues për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e Komunës së Glllogocit.



Zona mbishtresore e ndikuar nga vërshimet

Menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, zvogëlimi i numrit të fatkeqësive, parandalimi si dhe zvogëlimi i numrit të viktimave dhe pasojave tjera nga fatkeqësitë e tilla, janë të përcaktuara me Ligjin nr. 04/-L-027 -për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe aktet tjera nënligjore; dhe Ligjin nr. 04/L-147 -për ujërat e Kosovës, si dhe aktet tjera nënligjore.

Detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera:

- Zbulimi, monitorimi dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera; njoftimi, paralajmërimi dhe alarmimi për rrezikun e pashmangshëm dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; trajnimi dhe aftësimi profesional për detyrat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës; organizimi i gatishmërisë emergjente, krijimi dhe mirëmbajtja e formave tjera të gatishmërisë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; vetëmbrojtja, vetë ndihma dhe ndihma reciproke; mobilizimi dhe aktivizimi i mekanizmave për mbrojtje dhe shpëtim dhe Strukturave për mbrojtje dhe shpëtim, resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; përcaktimi dhe zbatimi i masave mbrojtëse; shpëtimi dhe ndihma; rimëkëmbja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë; vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; bashkëpunimi ndërkombëtar lidhur me zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; mbikëqyrja e zbatimit të rregullave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; dhënia e ndihmës për vendet tjera në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera.



Përgjegjësitë e nivelit lokal - Niveli lokal është përgjegjëse për zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e tij si: Menaxhimin e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në nivelin lokal; monitorimin e rreziqeve, paralajmërimin dhe alarmimin e popullatës për kërcënimet e mundshme; pajisjen me mjete elektronike të komunikimit për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në përputhshmëri me një sistem unik të komunikimit dhe informimit; planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse; përpunimin e vlerësimit të rreziqeve dhe planeve të reagimit emergjent; organizimin, zhvillimin dhe menaxhimin e mbrojtjes personale dhe reciproke; organizimin, menaxhimin dhe zbatimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në nivel lokal; përcaktimin, organizimin dhe pajisjen e njësive dhe shërbimeve komunale të SMSHN dhe organizatave tjera të kësaj fushe; furnizimin me resurse të domosdoshme për akomodim emergjent në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera; përpunimin dhe zbatimin e programeve trajnuese të rëndësisë lokale; koordinimin e planeve të reagimit emergjent dhe operacioneve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë me komunat fqinje; furnizimin me kushte elementare të jetës dhe restaurimit, rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; identifikimin e organizatave të rëndësisë së veçantë për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në nivel lokal; bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas këtij ligji.

Komunat bashkëpunojnë midis tyre në kryerje të detyrave të lidhura me mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe mund t'i bashkojnë resurset e tyre dhe të krijojnë resurse të përbashkëta për tu marr me çështjet e përbashkëta në këtë fushë.

Planet e reagimit emergjent - Mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera dhe në gjendje të jashtëzakonshme duhet të planifikohen nëpërmjet planeve të reagimit emergjent. Qëllimi i planeve të reagimit emergjent është sigurimi i ndërmarrjes së veprimeve të organizuara dhe të koordinuara për parandalimin e fatkeqësive apo zvogëlimin e pasojave të tyre dhe në rast të fatkeqësisë, të sigurohen sa më shpejt që të jetë e mundur kushtet elementare për jetë. Planet lokale të reagimit emergjent hartohen nga autoritetet lokale.



Masat mbrojtëse përfshinë: Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat tjera teknike; evakuimin; akomodimin dhe kujdesin e njerëzve të rrezikuar; mbrojtjen radiologjike, kimike dhe biologjike; strehimin; mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat tjera teknike: ndërmerren gjatë planifikimit hapësinor, urban dhe ndërtimor me qëllim të parandalimit apo zvogëlimit të efekteve të dëmshme si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe për të mundësuar mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën. Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizim të qytetarëve, transport publik, si dhe deponim, prodhim dhe përdorim të materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike - Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike, përbën masat dhe mjetet për mbrojtje të drejtpërdrejtë nga efektet e armëve nukleare, kimike dhe biologjike, si dhe nga pasojat e incidenteve që përfshijnë materiet e rrezikshme. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve dhe të pajisjeve të destinuara për furnizim publik, transport dhe deponim të gjërave ushqimore, medikamenteve, ushqimit për kafshë, shërbimet publike, shëndetësore, ruajtje dhe arsimim të fëmijëve, duhet t'i sigurojnë mjetet mbrojtëse dhe t'i ndërmarrin masat e parapara për mbrojtje kimike, biologjike dhe radiologjike.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore - Mbrojtja e trashëgimisë kulturore përfshinë përgatitjet dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rreziqeve, parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera në trashëgiminë kulturore. Përgatitjet dhe masat zbatohen nga pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore, shërbimi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nivelet qendrore dhe lokale. Gjatë realizimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas nevojës, marrin pjesë edhe njësitë dhe shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikjes, si dhe strukturat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.



Detyrat e Kryetarit të Komunës - Kujdeset për realizimin e përgatitjeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; miraton planet e reagimit emergjent në nivel komunal; përcakton llojin dhe madhësinë e SMSHN ; kujdeset për implementimin e masave për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera; menaxhon mbrojtjen, shpëtimin ndihmën dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; kujdeset për njoftimin e banorëve për rrezikun, gjendjen e mbrojtjes dhe masat e ndërmarra për mbrojtje; cakton Komandantin e Incidentit me rekomandimin e Menaxherit Emergjent.

Akuiferifet - Të gjitha zhvillimet brenda Zonave Mbishtresore të Akuifereve duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në: Ligjin nr. 04/L-147 -për ujërat e Kosovës, si dhe aktet tjera nënligjore; Ligjin nr. 04/L-040 -për rregullimin e tokës, si dhe aktet tjera nënligjore; Ligjin nr. 04/L-090 -për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe aktet tjera nënligjore; Ligjin nr. 03/L-198 - për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-9 për ujitjen e tokave bujqësore, si dhe aktet tjera nënligjore; Ligjin nr. 2003/10 -ligji për plehrat artificiale, si dhe aktet tjera nënligjore.

Zona mbishtresore për mbrojtje nga erozioni - Erozioni është një fenomen që rrezikon tokën ose burimin më të rëndësishëm mjedisor. Ai është një fenomen natyror që kë të bëjë me gërryerjen, ç’vendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit ose erës. Aktiviteti human, mund të shkaktojë erozionin e tokës qoftë edhe në përmasa të mëdha (ndërtimet, turizmi, vullkanet, katastrofat natyrore etj). Erozionet natyrore në Komunën e Glllogocit janë të shprehura në malet e Çiçavicës, në Kosmaq - erozioni vertikal, në luginën e Drenicës – erozioni anësor. Fatkeqësisht janë prezente edhe erozionet artificiale në mihjet sipërfaqësore në Çikatovë të vjetër, Korreticë të lartë dhe Baicë. Sipas ligjit të Ujërave të Kosovës, sipërfaqet me intensitet të lartë të erozionit i cili sjell pasoja të dëmshme në ujë rrjedha, tokë, pyje dhe objekte dhe paluajtshme, duhet të shpallen nga komuna si zona erozive.

Erozioni vepron në kundërshti me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Në një këndvështrim të përgjithshëm, nevojitet një kohë shumë e gjatë për të kompensuar humbjen e lëndës të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër.

Disa nga faktorët që influencojnë erozionin janë: Sasia dhe intensiteti i reshjeve; kushtet e relievit (pjerrësia) dhe mënyra e përdorimit të tokës; degradimi i mbulesës bimore (ç’pyllëzimet, zjarret,



mbikullotja etj); modifikimi i topografisë (p.sh. ndërtimi i rrugëve, qendrave urbane etj); politika e administrimit të ujrave (kanalizimet, veprat hidrike, pritrat, etj).

Masat e luftës kundër erozionit synojnë parandalimin e rreziqeve për mjedisin human ose konservimin e burimeve jetësore. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në afatgjatë ndikon drejtëpërdrejtë në cilësinë e jetesës.

Midis formave të erozionit dhe efekteve të shkaktuara dallohen: **Erozioni sipërfaqësor** - ç'vendosja e shtresës së sipërme të tokës nga reshjet dhe era; humbje dhe degradim i tokës bujqësore, i florës dhe faunës. **Erozioni në formë rrëkesh:** çarje, deri në rrëke që përshkojnë sipërfaqen e tokës kjo është formë më e përkeqësuar e erozionit sipërfaqësor.

Gërryerja e tokës: formë e erozionit që karakterizohet nga gërryerja dhe ç'vendosja e masës nga rrjedha e ujit në përrenj dhe lumenj. Efektet e kësaj forme të erozionit veprojnë mbi rrjedhën e ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, tokat e kultivuara dhe infrastrukturën.

Lëvizjet dhe shkarjet e tokës: provokohet nga forca e gravitetit dhe faktorë natyrorë ose antropik që influencojnë degradimin e mjedisit dhe infrastrukturës. Objektivi kryesor i luftës kundër erozionit është ulja e shkallës së erozionit në një nivel të pranueshëm për kushtet e mjedisit.

Masat parandaluese dhe antierozive për minimizimin e shfaqjes së erozionit që duhet të ndërmerren janë: Në të shumtën e rasteve të natyrës tekniko-biologjike dhe përfshijnë: - konsolidimin e sipërfaqeve të kërcënuara nga erozioni (pyllëzimi, brezat e erës, prita të vogla etj.); - mënyrat e punimit të tokës të mos favorizojnë erozionin ose rrjedhën e ujit (punimi në drejtim tërthor, punim minimal); - ndërhyrje topografike (ndërtimi i tarracave dhe mureve mbajtës); - masa për veshjen e përrenjëve dhe shtratit të rrjedhës, modifikimi i profilit të tyre - modifikimi i prurjeve të rrjedhës: ndërtime për të bërë shpërndarje të rrjedhës në drejtime të ndryshme duke ulur forcën e saj; vepra mbrojtëse për infrastrukturën : diga, prita, kanale etj.

Masat preventive kundër erozionit nga era - Mbjelljen e gardhit të shkurreve ose mbjellja e brezave mbrojtës; nën mbjellja ose bashkë mbjellja; përdorimi i kashtës, dhe masat tjera të përshtatshme për të zvogëluar dukshëm erozionin ose parandaluar erozionin nga era.

Rekomandim: Të respektohen masat, që janë përcaktuar me UA për Përcaktimin, Mënyrën, dhe procedurat për Mbrojtjen e Zonave Eroze dhe UA për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore nga Erozioni.



ZONA MBISHTRESORE ME NDOTJE TË LARTË (HOT SPOTET)

Kushtet zhvillimore, masat parandaluese dhe masat mbrojtëse të propozuara në HZK për zonën me ndotje të lartë, pritet të kenë ndikime pozitive në mjedis.

Masat për mbrojtjen e mjedisit sipas VSM-së janë:

- Pastrimi i shtratit dhe i brigjeve të lumit Drenica dhe ndërtimi i murit ndarës përgjatë mbetjeve industriale dhe lumit;
- Shtimi i hapësirave gjelbra afër minerave, izolimi me tampon mbrojtës nga gjelbërimi i lartë;
- Në afërsi të Deponisë së Feronikelit ndalohet ndërtimi i vendbanimeve deri në 1000 m nga deponia e skories;
- Ndalimi i deponimit të mbeturinave të rrezikshme pa u bërë trajtimi paraprak, me qëllim për të zvogëluar përqendrimin e komponentëve të dëmshme në mbeturina, zvogëlimin e veçorive të rrezikshme dhe zvogëlimin e sasisë dhe masës vëllimore të mbeturinave;
- Ndalimi i hollimit të mbeturinave të rrezikshme, me qëllim të shkarkimit të tyre në mjedis, përveç në rastet kur lejohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

ZONA MBISHTRESORE PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË TEKNIKO-TEKNOLOGJIKE

Kushtet zhvillimore, masat parandaluese dhe masat mbrojtëse të propozuara në HZK për zonën mbishtresore për mbrojtje nga fatkeqësitë tekniko-teknologjike, pritet të kenë ndikime pozitive në mjedis.

Masat për mbrojtjen e mjedisit sipas VSM-së:



- Të kontrollohet cilësia e karburantëve në territorin e Komunës së Glllogocit :
- Të mirren masa për parandalimin e zjarrit nga shpërthimet eventuale;
- Ndalohet kontaminimi i tokës, ujit, dhe ajrit me vajra të automjeteve, dhe materiale tjera korozive që lirojnë makinat e vjetra në natyrë;
- Lokacioni i automekanikëve, pompave për karburante nuk duhet të jetë në afërsi të ujërave dhe të shkaktojnë ndotje;
- Ruajtja e të gjitha materialeve në kontejnerë origjinalë në lokacione adekuate, që lejojnë ruajtjen nga depërtimi i rrjedhjes dhe në kontejnerë të mbrojtur nga rrjedhjet.
- Nuk duhet të ketë ruajtje të një sasive të madhe të lëndëve djegëse në vend punishte;
- Të sigurohet që punëtorët janë të familjarizuar me rregulloret e sigurisë në këto aktivitetet;
- Të sigurohen absorbues për derdhjet në rast aksidenti, ndaloni derdhjen dhe riparoni vendin;
- Mbeturinat duhet të trajtohen si të rrezikshme.
- Kimikalet dhe mbeturinat e rrezikshme duhet të vendosen në vende të sigurta dhe sigurohen që të mos rrjedhinë tokë ose ujë;

Zona mbishtresore për mbrojtje nga zjarret - Kushtet zhvillimore, masat parandaluese dhe masat mbrojtëse të propozuara në HZK për zonën mbishtresore për mbrojtje nga zjarret, pritet të kenë ndikime të theksuara pozitive në mjedis.

Zona mbishtresore për mbrojtje nga tërmetet – Kushtet zhvillimore, masat parandaluese dhe masat mbrojtëse të propozuara në HZK për zonën mbishtresore për mbrojtje nga tërmetet, pritet të kenë ndikime të theksuara pozitive në mjedis.

Zonë e interesit të veçantë - Duke marrë për bazë vlerësimin e ndikimeve mjedisore, masat parandaluese, masat mbrojtëse të propozuara sipas HZK-së mundë të kolaudohet që ndikimet mjedisore në Zonën me interes të Veçantë (ZIV) të “SHTABI I PËRGJITHSHËM I UÇK-ËS KLEÇKË DHE DIVJAKË” do të jenë të vogla dhe lehtë të kontrolluara. Si zonë do të vazhdojë të jetë e mbrojtur dhe të gjitha intervenimet do të jenë në harmoni me planin e lartpërmendur.


Ndikim i vogël negativ në mjedis pritet nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e objekteve



të banimit, ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeneve, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të karburanteve etj. Me ngritjen e këtyre objekteve do të shfrytëzohen burimet natyrore të cilat do ta rrisin emetimet në mjedis, do të ndikojnë në humbjen e tokës, do të krijohen mbeturina të materialeve ndërtimore disa prej të cilave kanë veçori të rrezikshme me mundësi të ndotjes së ujit dhe dheut, do të shtohet edhe sasia e ujërave të ndotura prandaj rekomandohet që të gjitha këto projekte ti nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të identifikohen mundësitë për minimizimin e efekteve negative në mjedis.

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR PËR INFRASTRUKTURË RRUGORE

Zhvillimi i infrastrukturës rrugore, duhet të marrë për bazë aspektet mjedisore përmes zbatimit të parimeve të VNM- së dhe parimeve tjera të zbatueshme, dhe të jetë në përputhje të plotë me UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.



HARTA 7: RRJETI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE



Rrjeti hekurudhor - Kompletimi i rrjetit të rrugëve si dhe rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit hekurudhor do të shoqërohet me ndikime të theksuara në mjedis. Andaj në këto raste objektivave mjedisore duhet të realizohen përmes procesit të VNM-së. Në mënyrë të veçantë duhet të merren për bazë ndikimi në zonat e mbrojtura dhe në rrjetin ekologjik.


Transporti publik – Krijimi i rrjetit të transportit urban për Komunën e Glllogocit parasheh ndikim pozitiv. Sa i përket mobiliteti apo lëvizshmërisë së këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve te motorizuara ato duhet të jenë të fokusuar në favorizimin e transportit publik dhe transportit të qëndrueshëm që do të mundësonte uljen e emisioneve ndotëse në ajër.

Vend parkimet publike – Të respektohen kërkesat për vend parkime përmes krijimit të rregullave në përputhje me Udhëzimin Administrativ 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor të cilat synojnë zvoglimin e ngarkesave të automjeteve dhe rreziqeve që zhvillohen nga trafiku.

Rekomandime:

- Si pjesë e ndërtimit të çfarëdo rruge të re, ose ndërtese të re, duhet të kërkohet që të mbillen drunjtë përgjatë rrugëve.
- Gjatë zhvillimit të ri infrastrukturorë aty ku ka mundësi dhe potencial për biodiversitet të pasyr me lloje të ndërtohen mbi-kalime të gjelbra, që kafshët të kalojnë rrugën me siguri.
- Gjatë planifikimit të infrastrukturës hekurudhore të krijohen mundësi si tunele të breshkave nën shinat hekurudhore, për të shpëtuar breshkat e zonës lokale nga dëmtimet.
- Në vendbanimet në të cilat pemet kanë një moshë mbi 100 vjeçare, të krijohen rreth rrotullime në mënyrë që të mbrohen ato.
- Të vendosen përgjatë rrugëve shpërndarës të ujit që pastrojnë rrugët dhe parandalojnë ndotjen e qytetit nga pluhuri.
- Në vendet e pjerrëta të krijohen shkallë lëvizëse për biçikleta, pasi ngjitja në kodrat e pjerrta është më e lehtë.
- Gjatë ndërtimit të rrugëve lidhëse, të ndërtohen ura me litar për të mundësuar lëvizjen e lirë të kafshëve.

Sipas analizës së veprimeve strategjike dhe aktiviteteve të përcaktuara për infrastrukturë publike dhe sociale pjesa më e madhe e aktiviteteve do të sjellë efekte pozitive në mjedis. Me respektimin e plotë të planit, masave për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor, ndikimet do të jenë të vogla dhe lehtë të kontrollueshme.



Fushat sportive dhe hapësirat rekreative – Ndikim i vogël negativ në mjedis pritet nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e infrastrukturës sportive. Këto ndërtime do të manifestohen me ndikime të ndryshme mjedisore sidomos në zënien e tokave, krijimin e mbeturinave, zhurmës, pluhurit apo edhe formave tjera të presionit në mjedis. Hapësirat rekreative parashihen të kenë ndikim kryesisht pozitiv në mjedis.



Hapësirat dhe ndërtimet për shërbime mjekësore - Nga aspekti social parashihet ndikim pozitiv sepse ngritja e infrastrukturës shëndetësore do të ndikojë në përmirësimin e shëndetit publik të qytetarëve të Komunës së Gllogocit, që është një element i rëndësishëm që ndërlidhet me kushtet e mjedisit. Ndikim negativ për faktin se investimet në përmirësimin e infrastrukturës manifestohen me ndikime të ndryshme mjedisore kryesisht gjatë fazës së ndërtimit të objekteve shëndetësore.

Institucionet kulturore dhe argetuese - Këto aktivitete janë cilësuar pozitive dhe të domosdoshme për promovimin e kulturës së Komunës së Gllogocit.

Ndërtesat për shërbime sociale – Sa i përket aspektit mjedisor priten ndikime të vogëla negativ në mjedis nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e ndërtesave të banimit për banim social, mirëpo me respektimin e masave për ruajtjen e mjedisit këto ndikime janë lehtë të kontrollueshme dhe të menaxhueshme, ndërsa sa i përket aspekti social priten ndikime pozitiv sepse do të zgjidhen shumë probleme sociale themelore siç janë çështja e banimit për kategoritë sociale, përkujdesje sociale ndaj personave me nevoja të veçanta, dhe ndihmës shëndetësore që u ofrohet.

Objektet e religjionit – Hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve fetare si dhe shërbimeve të tjera të lidhura nuk parasheh ndonjë ndikim të theksuar negativ në mjedis.

Qendrat administrative - Pritet ndikime pozitiv mjedisore sepse fuqizimi i shërbimeve administrative do të ndikojë pozitivisht edhe në përmirësimin e shërbimeve që ndërlidhen me çështje mjedisore dhe kulturore.

Ndërtesat e institucioneve parashkollore, shkollat dhe universitetet - Ndikim i përzier në mjedis. Ndikim pozitiv sepse ngritja e infrastrukturës shkollore dhe trajnuese do të ofrojë edhe mundësi për ngritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit. Negativ për faktin se ndërtimet manifestohen me ndikime të ndryshme mjedisore sidomos në zënien e tokave, krijimin e mbeturinave apo edhe rritjen e presionit në mjedis përmes formave tjera të emetimeve.


Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike - **Ndikim pozitiv social dhe mjedisor.**

Varrezat - **Ndikim pozitiv social dhe mjedisor.**



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR PËR INFRASTRUKTURË TEKNIKE

Në mënyrë që VSM-ja të jetë efektive në mbështetjen e procesit për ndërtimin dhe përmirësimin e gjithë rrjetit të infrastrukturës teknike në Komunën e Glogocit duke identifikuar çështjet specifike mjedisore të cilat janë të rëndësishme në ushtrimin e planifikimit të cilat ne dëshirojmë ti adresojmë dhe përmirësojmë përmes planit.



HARTA 8: HARTA E INFRASTRUKTURES TEKNIKE

Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit - Do të ketë ndikime pozitive sidomos në aspektin e përmirësimit të shëndetit publik përmes përmirësimit të sasisë dhe cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë banorët e komunës së Glogocit. Aktiviteti do të ndihmojë edhe në reduktimin e humbjeve të ujit përmes përmirësimit të rrjetit të furnizimit me ujë.

Implantet për trajtimin e ujërave të zeza - Pritet ndikim pozitiv mjedisor sepse do të ndikojë në përmirësimin cilësisë së ujërave sipërfaqësore përmes trajtimit të ujërave të ndotura urbane. Edhe ky aktivitet gjatë fazës së implementimit paraprakisht duhet ti nënshtrohet procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe procedurave për marrjen e lejes ujore, pëlqimit mjedisor dhe lejes mjedisore.



Rrjeti i ujitjes – Ka ndikim pozitiv në mjedis, pasi ndërtimi i akumulacionit në fshatin Vërboc mund të përfshijë zonat të cilat nuk përfshihen nga sistemi i ujitjes “Ibër Lepenci”.

Rrjeti i shpërndarjes lokale me energji elektrike – Pritet ndikim i vogël negativ në rastet e implementimit të aktiviteteve për rrjetin shpërndarës elektrik, për shkak se gjatë ndërtimit të rrjetit mundë të ketë ndërhyrje në peizazh apo edhe në tokë.

Zonat e sigurisë – Këto aktivitete kanë ndikime pozitive në mjedis dhe shëndetin e popullatës së Komunës së Glogocit pasi në këto zona janë të vendosura stabilimentet energjetike, me qëllim të mbrojtjes së sistemit të energjisë, jetën, shëndetin e qytetarëve apo të mirave materiale.

Rrjeti i telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme - Këto aktivitete pritet të kenë ndikime pozitive në mjedis.

Rrjeti i grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitokësore dhe nëntokësore: Nga këto aktivitete priten ndikim të theksuara pozitiv në mjedis dhe shëndetin e popullatës sepse do të ndikojë në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Glogocit që është një nga problemet kryesore mjedisore. Rekomandohet që: Lokacioni për deponimin e mbeturinave duhet të plotësojë masat dhe kërkesat që dalin nga Ligji për Mbeturina nr. 04/L-060 dhe udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj. Këto aktivitete janë subjekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.


Ndërtesat dhe hapësirat për riciklim dhe dekompozim – Priten ndikime të theksuara pozitive në mjedis, pasi Riciklim është procesimi i materialeve të përdorura më parë në produkte të reja, në mënyrë që të reduktojë shpërdorimin e materialeve të dobishme për jetën tonë. Lokacioni për riciklim duhet të plotësojë masat dhe kërkesat që dalin nga Ligji për Mbeturina nr. 04/L-060 dhe udhëzimet administrative tjera që dalin nga ky ligj.

Rekomandim: Riciklimi i mbeturinave duhet inkurajuar në vazhdimsi, me qëllim që të arrihen synimet e parashikuara për riciklimin dhe shfrytëzimin e mbeturinave si lëndë e parë sekondare. Trajtimi termik i mbeturinave-shfrytëzimin e mbeturinave si lëndë djegëse dhe djegia me qëllim të përfitimit të energjisë.



TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE

Masat për mbrojtjen e mjedisit dhe komponentet mjedisore të prekur nga aktivitetet e ndryshme në këtë zonë duhet trajtuar sikur zonat më lartë të tërë territorit të komunës dhe duhet respektuar masat për mbrojtjen e mjedisit veçanërisht masat për zonën industriale pasi lagja Feronikeli është në afërsi të kompleksit industrial Feronikeli.




HARTA 9: VENDBANIMET JOFORMAL



PËRCAKTIMI I ZONAVE PËR TË CILAT HARTOHET PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM

Kufinj të zonave për të cilat do të hartohet plani rregullues i hollësishëm : Sipas vlerësimit mjedisor parashihen ndikime pozitive në mjedis.



HARTA 10: PLANET RREGULLUESE TË HOLLËSISHME

Vlerësimi Strategjik Mjedisor sipas Planit të veprimit për zbatim të Hartës Zonale të Komunës së Glogocit

Sipas analizës së veprimeve strategjike dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e veprimit për zbatim të hartës zonale pjesa më e madhe e aktiviteteve do të sjellë efekte pozitive të theksuara në mjedis dhe në përmirësimin e gjendjes socio- ekonomike të popullatës së Glogocit, megjithëkëtë duhet të merren për bazë rekomandimet dhe masa zbutëse të përshkruara në raport. Rekomandim i raportit të VSM-së është që realizohet pjesëmarrja e publikut sa më shumë që të mundet në vendimmarrje përmes procedurave të VSM-së dhe/ose VNM-së



MASAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT BAZUAR NË NDIKIMIN E HARTES ZONALE

Masat për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis janë paraqitur në vijim. Masat e paraqitura duhet të implementohen plotësisht. Për implementimin e masave mbrojtëse të mjedisit të përshkruara në raportin “Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor” përgjegjës është Komuna e Glllogocit konkretisht Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ndërsa roli inspektues i inspektorëve komunal për Mjedis nga Drejtoria e Inspektionit është i domosdoshëm.

Masat për mbrojtjen e ajrit - Aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore në zonën urbane të qytetit, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje, si dhe respektimi i ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Masat për mbrojtjen e tokës (dheut)- Mbrojtja e tokës është një aktivitet i interesit të përgjithshëm të shoqërisë i cili kryhet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Të zbatohen masat dhe rekomandimet që dalin nga Ligji për tokën bujqësore, i cili si qëllim kryesor ka krijimin e rregullativës ligjore për shfrytëzimin, mbrojtjen dhe rregullimin e tokës bujqësore.

Masat për mbrojtjen e tokës nga erozioni- Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontrolli i përmytjeve në zonën e erozionit ndërmerren masat kundër-erozive si në vijim: Ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm i lërimit të livadheve, kullotave dhe tokave të tjera bujqësore për shkak të konvertimit të tyre në tokë të punueshme me kulturat bujqësore vjetore; Prezantimi i kulturave bujqësore në rotacion; Kultivimin e plantacioneve shumëvjeçare; Ngritjen e ndërtesave specifike përkatëse; Përmirësimi i teknikave për trajtimin e tokës bujqësore; Ngritjen dhe kultivimin e brezave mbrojtës bujqësor apo mbjelljen e bimëve drunore shumëvjeçare; Ndalimi i kullotjes së bagëtive në një kohë të caktuar ose kufizimi i numrit të kafshëve që mund të lirohen në hapësira të caktuara; Ndalimi i prerjes së pyjeve dhe plantacioneve pyjore mbi tokë të rrezikuar etj.



Për parandalimin e erozionit duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010 -2020.

Rregullimi i tokës bujqësore - Rregullimi i tokës bujqësore nëpërmjet konsolidimit bëhet në rastet e mëposhtme: kur për shkak të fragmentimit të lartë dhe të formave të parregullta të parcelave kadastrale, toka bujqësore nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë të arsyeshme; kur të bëhet ndërtimi i sistemeve të kullimit ose të ujitjes; kur të bëhet ndërtimi i rrjetit të rrugëve fushore; kur të bëhet ndërtimi i infrastrukturës dhe ndërtesave të mëdha - rrugëve publike, hekurudhave, rezervuarëve, etj.; kur të bëhet rregullimi i rrjedhave ujore dhe zgjerimi i tokave ndërtimore; kur të bëhen punë dhe masa kundër-erozive.

Mbrojtja e tokës nga fragmentimi

Masat kundër-fragmentuese janë: Toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela. Kjo masë mbrojtjeje duhet të respektohet në dokumentet e planifikimit hapësinor;

Toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e së cilës është ≤ 0.50 ha, të mos mund të fragmentohet tutje. Kjo masë mbrojtjeje mund të përcaktohet në dokumentet e planifikimit hapësinor.

Masat për mbrojtje nga zhurma- Të zbatohen masat dhe këkesat që dalin nga Ligji për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102. Sipas këtyre kërkesave komuna obligohet të hartoj Planin e Veprimit dhe Hartën e zhurmës, përmes së cilave do të identifikohen lokacionet që i ekspozohen zhurmës, prezantimi i tyre në hartë dhe propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma.

Masat për mbrojtjen e Ujit- Për menaxhimin më efikas të ujërave komuna e Glllogocit duhet të koordinohet me aktivitetet, vendimet, masat dhe qëllimet e vendosura nga niveli qendror e sidomos nga Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Ujërave.



Masat për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore – Ruajtja e monumenteve të vjetra, si: ndërtesa religjioze, xhami e kisha, shtëpi të ndërtuara në mënyrë tradicionale si dhe objekte të tjera të vjetra si ura të cilat duhet të ruhen dhe konservohen për shkak të vlerat të tyre kulturore.

Masat për mbrojtjen e Resurseve Natyrore- Investime në infrastrukturë në përputhje me standarde dhe normat europiane, (ulëse, shtigje, lokacion për mbeturina, shenjëzim, ndriqim); çasjeadekuate në monumente të natyrës dhe deri tek shpellat; hartim i planeve menaxhuese në mënyrë që të nxisë zhvillimin e turizmit; të rritet vetëdijësimi i qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit; mirëmbajtja e zonave të mbrojtura; hulumtimi dhe studimi i mëtejshëm i shpellave të cilat paraqesin atraksion për vizitorët dhe ndikojnë në zhvillimin e turizmit të komunës; të pengohen dukuritë negative që rrezikojnë trashëgiminë natyrore.

Masat për mbrojtjen e Biodiversiteti - Liqenet e Vasilevës si dhe zona rreth tyre është e pasur me biodiversitet, dhe si e tillë meriton të vihet në mbrojtje dhe të menaxhohet me qëllim të ruajtjes së habitateve karakteristike dhe biodiversitetit që gjendet aty.

Masat për mbrojtjen e Pyjeve - Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet nëpërmjet formave si në vijim: Mbrojtja e tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj toke për shfrytëzime të tjera jo-pyjore; Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet pyllëzimit- krijimi i një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore (ekskluzivisht autoktone) në një tokë ku nuk kishte pyll; Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në forme të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale (nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës). Komuna është e kufizuar me dhënien e lejeve për ndërtim në Zonën e Pyjeve. Pjesët e djegura dhe të prera të pyjeve nga faktori antropogjen në vitet e fundit duhet ri-pyllëzuar.

Njoftimi dhe Siguria e Punëtorëve

- Ofrimi i informatave tek popullsia lokale rreth fushëveprimit dhe kohës së fillimit dhe kohëzgjatjes së aktiviteteve të ndërtimit duke përgatitur Njoftimin i cili duhet të vendoset në tabelën e njoftimeve



- të komunës dhe në faqen e internetit të komunës dhe përmes mjeteve tjera të informimit si: radio dhe tv lokale, nëse është e nevojshme, për t'u siguruar se popullsia lokale është e informuar mirë;
- **b)** Inspektoratet lokale të ndërtimit dhe të mbrojtjes së mjedisit/të natyrës duhet të jenë të informuara për punimet para fillimit;
 - **c)** Të gjitha lejet/opinionet e nevojshme merren para fillimit të punimeve (duke përfshirë atë të ndërtimit , pëlqimet mjedisore, dhe të tjera);
 - Të gjitha punët duhet të kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar;
 - Rrobat dhe pajisjet mbrojtëse personale të punëtorëve duhet të jenë në dispozicion në sasi të mjaftueshme dhe vishen/përdoren gjatë gjithë kohës;
 - Punëtorët duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe me përvojë adekuate për punën që kryejnë (p.sh. për punimet në lartësi);
 - Gropat e hapura duhet të mbulohen dhe shënohen qartë kur nuk punohet në to;
 - Të sigurohet shënimi përkatës dhe tabela informative e vendit të rindërtimit
 - Shënimi i vendpulishteve për ruajtjen e përkohshme të materialit për rindërtim afër vendpulishtes
 - Sigurimi i shiritave të paralajmërimit, rrethojave dhe shenjave përkatëse që paralajmërojnë rrezik, rregullat kyçe dhe procedurat që duhet të ndiqen
 - Hyrja e ndaluar e personave të papunësuar brenda shiritave të paralajmërimit dhe rrethojave kur/ku shihet e nevojshme;
 - Zona rrethuese afër sallës sportive duhet të mbahet e pastër;
 - Makinat duhet të operohen vetëm nga personeli i trajnuar dhe me përvojë, duke zvogëluar kështu rrezikun e aksidenteve;
 - Të gjithë punëtorët duhet të njihen me rreziqet e zjarrit dhe masat për mbrojtje nga zjarri dhe duhet të jenë të trajnuar për të operuar me fikësit e zjarrit, hidrantët dhe pajisjet tjera që përdoren për shuarjen e zjarrit
 - **o)** Aparatet, pajisjet dhe fikësit e zjarrit duhet të jenë gjithmonë funksionale, kështu që në rast nevojë, mund të përdoren me shpejtësi dhe efikasitet. Kutitë e ndihmës së parë duhet të jenë në dispozicion në vendpulishte dhe personeli i trajnuar për ta përdorur.
 - **p)** Procedurat për rastet e emergjencës (duke përfshirë derdhjet, aksidentet etj.) duhet të jenë në dispozicion në vendpulishte.



- Si pjesë e ndërtimit të çfarëdo rruge të re, ose ndërtese të re, duhet të kërkohet që të mbillen drunjtë përgjatë rrugëve. Një mesatare prej një druri për çdo 20 metra do të mbillen përgjatë gjatësisë së rrugës. Drunjtë e rrugëve mund të mos mbillen në intervale të caktuara, por mund të lëvizin për t'u përshtatur me infrastrukturën teknike, infrastrukturën publike, infrastrukturën sociale, rrugët publike dhe karakteristikat të tjera. Lokacionet për mbjelljen e drunjëve mund të jenë ose të mos jenë ndërmjet vijës rregulluese dhe skajit të rrugës, në varësi të rrethanave të vendit. Nëse drunjtë nuk janë të vendosur ndërmjet vijës rregulluese dhe skajit të rrugës, ato vendosen brenda parcelës menjëherë pranë vijës rregulluese, apo përgjatë vijës aksiale qarkulluese të rrugëve publike. Drunjtë të ri rrugorë nuk do të kërkohen aty ku ka drunjë ekzistues përgjatë rrugëve publike janë të shëndetshëm. Drunjtë e tillë do të ruhen dhe do të shërbejnë për të njëjtin qëllim.
- Të gjitha rregullimet e nevojshme të peizazhit mirëmbahen vazhdimisht nga pronari i pronës dhe mbahen të pastra nga mbeturinat. Çdo peizazh i kërkuar që vyshket, hiqet ose dëmtohet rëndë, duhet të zëvendësohet nga pronari aktual i pronës sa më shpejt që është praktike, duke pasur parasysh sezonet e rritjes, brenda një maksimumi prej 150 ditësh.
- **Hapësirat e gjelbra, duhet të planifikohet në lokacione** - Në afërsi të zonave të banimit; në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik.
- **Brezi i gjelbër** - Brezi i gjelbër përgjatë rrugëve dhe shtigjeve ka për qëllim: Izolimin e këmbësorëve, çiklisteve dhe ndërtesave nga trafiku i veturave/ zhurma; krijimin e kushteve të përshtatshme higjienike dhe mikroklimatike; përmirësimin e cilësisë estetik të peizazhit. Brezi i gjelbër përgjatë rrugëve dhe shtigjeve ndahet në: brez të gjelbër, përgjatë sistemeve kombëtare të infrastrukturës rrugore, si pjesë e sistemeve lokale të infrastrukturës rrugore: rrjeti i rrugëve nacionale: ≥ 35 m; rrjeti i rrugëve rajonale: ≥ 22 m. Brez i gjelbër, përgjatë sistemit lokal të infrastrukturës rrugore: rrjeti primar: ≥ 10 m; rrjeti sekondar: ≥ 8.00 m. Brezi i gjelbër, përgjatë shtigjeve: ≥ 3.00 m. brez i gjelbër, përgjatë vend-parkimeve: $\geq 2.50-4.50$ m.
- Te gjitha investimet të behen me material ekologjike;
- Shtigjet për këmbësorë duhet të ndërtohen me gurë apo me materiale tjera që i përshtaten dhe janë në harmoni me rrethinën në të cilën ndërtohen;



MONITORIMI

Është propozuar një plan monitorues për monitorimin e ndikimeve të Hartave Zonale të Komunës kundrejt objektivave të Vlerësimit Strategjik Mjedisorë, si dhe për të sugjeruar qasjet relevante dhe kornizat kohore.

Objektivi i VSM	Treguesit e monitorimit	Shpeshtësia	Autoriteti përgjegjës
AJRI	Monitorimi i rregullt i cilësisë së ajrit në Komunën e Glogocit; të respektohen masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit;	12 muaj	Komuna/DPUM M Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
TOKA	Monitorimi i tokës; Përqindja e sipërfaqes së zonave të reja urbane në zonat e planifikuara urbane; Sipërfaqja e tokës së humbur nga ndërtimet e reja.	6 muaj	Komuna/ DBZHE MBPZhR
TOKA BUJQËSORE	Sipërfaqja e tokës së humbur nga realizimi i aktiviteteve sipas HZK-së.	6 muaj	Komuna/ DBZHE MBPZhR
UJI	Monitorimi i rregullt i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe ujërave për pije;	12 muaj	Komuna/DSHPE Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik
ZHURMA	Monitorimi i ndotjes nga zhurma; masat mbrojtëse për ndërtime të reja në zonat me ndotje të lartë dhe në zonat e ekspozuara nga zhurma.	12 muaj	Komuna
SHËNDETI I POPULLATËS	Mbrojtja e shëndetit të popullatës	12 muaj	Komuna

Komuna e Glllogocit (Drenasit) 2020
Vleresimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale



BIODIVERSITETI FLORA DHE FAUNA	Mmonitorimi i zonave të mbrojtura; Identifikimi dhe propozimi i zonave të reja potenciale për mbrojtje: Monitorimi i florë dhe faunës.	12 muaj	Komuna/DPUM M Instituti për Mbrojtjen e Natyres
PEIZAZHI	Monitorimi i ndikimeve në peizazh: zbatimi i masave për ruajtjen e peizazhit.	12 muaj	Komuna/DPUM
PYJET	Sipërfaqja e tokës së degraduar të pyllëzuara apo ripyllëzuara. Sipërfaqet e restauruara/rehabilituara të pyjeve.	12 muaj	Komuna/DBZH E Agjencioni i Pyjeve
EROZIONI	Sipërfaqja së tokës me rrezik të lartë nga erozioni: Monitorimi i pyjeve dhe brigjet e lumenjëve.	12 muaj	Komuna/ DBZHE
MBETURINAT	Rehabilitimi deponive ilegale të mbeturinave Përfshirja e ekonomive familjare në sistemin e grumbullimit të mbeturinave Riciklimi dhe ripërdorimi i mbeturinave.	12 muaj	Komuna/DPU MM MEA KRM
FAKTORET KLIMATIK	Ndryshimi i klimës: Emitimet e gasrave serrë.	12 muaj	Komuna/DPU MM / MEA
INTEGRIMI VNM-SË, NË KUADËR TË PROJEKTEVE	Numri i raporteve të VNM për projektet komunale	6 muaj	Komuna/DPU MM
TRASHËGIMIA NATYRORE, KULTURORE, HISTORIKE, DHE ARKEOLOGJIKE	Numri i vendeve të trashëgimisë ku janë zhvilluar aktivitetet restauruese Numri i vendeve të trashëgimisë ku është përmirësuar qasshmëria	12 muaj	Komuna/DKRS MKRS



ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE	Numri i intervenimeve nga njësitet e zjarrfikësve dhe atyre të kërkim shpëtimit	6 muaj	Komuna/DSH PE Agjencioni i emergjencave
--	---	---------------	--

Përmbledhje jo teknike e VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) i Hartave Zonale të Komunë së Glllogocit synon rritjen e mundësive mjedisore dhe minimizimin e ndikimeve dhe rreziqeve që lidhen me zbatimin e tyre. Qëllimi përfundimtar i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe kontribuimi në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Në Kosovë VSM-ja është e rregulluar me Ligjin Nr. 03/L- 230, i cili përcakton kushtet, formën dhe procedurat për aplikimin e VSM-së.

Fazat kyçe të raportit të VSM-së, dhe rezultatet e tyre, janë si në vijim:

- Baza ligjore e legjisllacionit të Kosovës që përcakton objektivat dhe politikat e mbrojtjes së mjedisit që janë potencialisht relevante për HZK-në,
- Janë prezantuar një përmbledhje e konventave ndërkombëtare mjedisore, relevante për HZK-në,
- Me theks të veçantë gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë në shqyrtim Konventa Aarhus, Espoo dhe Protokolli i Kievit,
- Procesi dhe metodologjia e VSM-së dhe fazat kyçe të procesit të VSM-së,
- Të dhënat e përgjithshme për Komunë e Glllogocit, pozita gjeografike dhe ndarja administrative,
- Gjendja aktuale mjedisore në Komunëne Glllogocit,
- Identifikimi i veprimeve strategjike në mjedis të Hartave Zonale të Komunë së Glllogocit
- Është prezantuar një përmbledhje e ndikimeve mjedisore për secilen zonë veç e veç, dhe janë përshkruar masat për mbrojtjen e mjedisit,
- Janë përshkruar masat përmirsuese afatshkurtëra dhe afatgjata,
- Janë përshkruar masat e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit për secilën zonë të HZK-së,



- Propozimi i planit të Monitorimit, janë identifikuar komponentët mjedisorë për të zbuluar ndikimet aktuale të HZK-së kundrejt objektivave të VSM-së,
- Janë dhënë rekomandimet e nevojshme për secilën zonë, dhe rekomandimet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit nga implementimi i HZK-së,
- Literatura dhe burime të informacionit,



Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vlerësimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale

PËRFUNDIME

Bazuar në studimin e bërë për Vlerësimin Strategjik Mjedisor ndikimet e mundshme, masat për parandalimin e ndikimeve të Hartave Zonale të Komunës së Glogocit, si dhe duke i'u referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludohet si në vijim:

HZK-ja do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribuojë në ruajtjen e tokës bujqësore, mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve, ruajtjen e zonave të mrojtura natyrore dhe kulturore, resurseve ujore, monumenteve historike, parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e pëlleshme bujqësore përreth. Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikasitet të tokës dhe resurseve të tjera natyrore.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatimit të HZK-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore. Monitorim i zbatimit të HZK-së dhe parametrave mjedisore të tij do jetë kyç i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Me hartimin dhe hyrjen në fuqi të HZK-së arrihet një hap cilësor në planifikimin e qëndrueshëm të territorit dhe burimeve natyrore. Hartimi i Planeve rregulluese dhe projekteve tjera do duhet të sigurojë përfshirjen e faktorëve mjedisorë gjatë detajimit të planeve në nivel më të ulët gjatë zbatimit të HZK-së. Hartimi i Planeve rregulluese duhet të shërbejë për të përcaktuar dhe siguruar kufijtë e zonave të gjelbra, si edhe për të identifikuar dhe zhvilluar hapësira të vogla çlodhëse dhe rekreative sportive në vendbanime. Duhet të punohet vazhdimisht dhe nga të gjitha institucionet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kontrollit mjedisor. Ngritja e mekanizmave të tilla në nivel komunal do duhej të ishte vetëm një hap i parë në drejtimin e duhur. Me respektimin e plotë të planit, legjislacionit mjedisor për mbrojtjen e mjedisit, masave të dhëna në këtë raport, si dhe në bashkëpunimin të plotë me zyrtarët komunale për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Glogocit, inspektoriatin mjedisor komunal, ky plan konsiderohet i pranueshëm si në aspektin mjedisor, ekonomik dhe social.



Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vlerësimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale

DISKUTIMI PUBLIK

Debati publik me qytetarë është mbajtur me datën 24.08.2020 në ora 13: 00 në sallën e Kuvendit Komunal, është hapur nga drejtoresha e DPUMM-së znj. Flutura Avdiu e cila informoi të pranishmit në sallën e Kuvendit Komunal për përgatitje e raportit për Studimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartë Zonale të Komunës së Glogocit 2020-2028. Fillimisht falënderoj grupin punues për realizimin e VSM-së dhe i njoftoi të pranishmit se pret komente, masat tjera shtesë dhe debat të lirë në mënyrë që të kemi një raport sa më të kompletuar dhe gjithëpërfshirës. Fjalën e mori pastaj Znj. Lyra Bicurri zyrtare në kompaninë “Zonnum shpk Prishtinë”, e cili në bashkëpunim me Komunën e Glogocit ka hartuar raportin për Studimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Komunën e Glogocit për periudhën kohore 2020-2028. Masat për mbrojtjen e mjedisit dhe rekomandimet e paraqitura në këtë raport janë rezultat i punës së ekspertëve të kompanisë dhe i zyrtarëve përgjegjës nga Komuna e Glogocit.

Ajo ka prezantuar raportin sudimor në pika të shkurtëra, identifikimin e aktiviteteve në zonat e planifikuara, masat për mbrojtjen e mjedisit, rekomandime dhe ka treguar rëndësin e mbajtjes së debatit publik me qytetarë, shoqërinë civile, palët e interesit për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e aktiviteteve të ardhshme zhvillimore në mënyrë që të jenë në harmoni me mjedisin dhe të mos kenë efekte të dëmshme në shëndetin e popullatës.

Qellimi kryesor është përkrahja e zhvillim të qëndrueshem të Komunës së Glogocit duke mos i dëmtuar komponentë mjedisor dhe ruajtjen e tyre për gjeneratat e ardhshme.

Në hartimin e raportit të VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit kanë kontribuar shoqëria civile, profesionistët dhe ekspertët e fushave relevante, të cilët edhe sot morën pjesë në përfundimin e procedurave për aprovimin e këtij raporti.

Ndryshe, qytetarët e komunës, nga data 10.07.2020 deri me datë 10.08.2020, kanë pasur mundësinë e konsultimit publik për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit, për të dhënë komente dhe sugjerime në mënyrë elektronike në email adresën: komuna.drenas@rks-gov.net apo në mënyrë fizike në objektin e komunës, në zyret e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.



VSM - REKOMANDON DISA VEPRIME TË VEÇANTA PËR HARTEN ZONALE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT

Ajri- Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe mbrojtjes së tij nga ndotja si dhe me qëllim që të përmirësohet monitorim

i dhe raportimi për cilësinë e ajrit rekomandohet: Të implementohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit; të realizohen projektet specifike me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit; të kompletohet inventari i emisioneve dhe burimeve të ndotësve në ajër.

- Për reduktimin e ndotjes së ajrit në ambientin urban preferohet mbjellja e llojeve drurore të cilat jo vetëm që i zbukurojnë mjediset urbane, por njekohësisht zvogëlojnë ndikimin negative të faktorëve të ndryshëm në atë mjedis, prandaj sipërfaqet e gjelbra janë komponentë të domosdoshëm të planeve urbane.
- Bimët ndikojnë në klimën urbane (ulin temperature, ngritin lagështinë). Bimët në gjethet e tyre depozitojnë përqindje të madhe të pluhurit, zvogëlojnë zhurmën, me absorbim zvogëlojnë përqëndrimin e ndotësve në formë gazesh siç janë dyoksidi i karbonit, monoksidi i karbonit, oksidet e sulfurit, oksidet e azotit etj.
- Sipërfaqet e gjelbra, posaqërisht drunjtë janë mbrojtës të mëdha kundër zhurmës dhe erërave. Disa bimë si: Akacia, Bliri, Trëndafili në kohën e lulëzimit emitojnë aromë të këndshme dhe kështu neutralizojnë aromat e pakëndshme. Numri i baktereve mbi sipërfaqe të gjelbra në vendet urbane është 5-7 herë më i ulët se sa në vendet urbane të pa gjelbruara.
- Bimët më të përshtatshme për mbrojtje nga pluhuri janë: Bliri, Lajthija, Thanukla, Verri etj.
- Llojet më rezistente ndaj ndotësve janë: Molla, Dardha, Mështenka, Plepi i Zi, Larshi etj. Efektet e oksideve të azotit në bimët dekorative janë të mëdha, por më rezistente janë: Rododendroni, Leandri etj.



Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vleresimi Strategjik Mjedisore per Harten Zonale

- Për zvogëlimin e efekteve negative të ndotjes në qytet më të përshtatshme janë llojet si: Sephora japonica, Bungu, Panja gjetherrapi, Panja e malit, Hormoqi kanadez, Ginko biloba, Larshi, Tisi, Tuja, Pisha e zezë, Dëllinja etj. Pra, llojet e ndryshme bimore tregojnë shkallë të ndryshme të rezistueshmërisë, që nganjëherë përcillet me simptome karakteristike përmes të cilave njihet prezenca e ndotësve të caktuar.
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara sipas normave ndërkombëtare në vendet urbane për kokë të banorit duhet të jenë 20 m² sipërfaqe e gjelbëruar.

Uji - Meqenëse të gjithë jemi përdorues të ujit, ne jemi në të njëjtën kohë, edhe përgjegjës për mbrojtjen e tij. Dy parimet bazë për mirëmbajtjen e burimeve ujore janë ruajtja dhe mbrojtja.

- Burimet kryesore të ndotjes të ujërave sipërfaqësore vlerësohen të jenë mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, ujërat industrial, përdorimi i pesticideve dhe hedhjes së mbeturinave të ngurta.
- Vëmendje dhe rendësi të veçantë duhet t'i kushtohet ngritjes së infrastrukturës ujore, ngritjes së impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave.
- Për menaxhimin më efikas të ujërave komuna e Glogocit duhet të koordinohet me aktivitetet, vendimet, masat dhe qëllimet e vendosura nga niveli qendror e sidomos nga Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e ujërave.
- Sipas Ligjit për mbrojtjen e ujërave, Komuna është kompetente për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore brenda zonave urbane. Shfrytëzimi i pakontrolluar i inerteve nga lumenjtë dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore.



Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vlerësimi Strategjik Mjedisore për Harten Zonale

Toka - Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave nëpërmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.

- Çdo shfrytëzim i tokës për çfarëdo qëllimi bartë me veti mundësin e rrezikut dhe çdo sjellje jo racionale gjatë shfrytëzimit të saj kanë pasoja direkt dhe indirekte të degradimit.
- Deri të ndotja e tokës vije nëpërmjet ndotjes së ujit, ajrit, përmes përdorimit të plehrave minerale dhe pesticideve, nga deponitë ilegale të mbeturinave etj.
- Në komunën e Glogocit ekzistojnë disa deponi ilegale të mbeturinave komunale dhe deponi të mbeturinave industriale që janë burime të ndotjes së tokave.
- Faktorët tjerë të identifikuar gjatë hartimit të Studimit për "Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Hartave Zonale" që dëmtojnë cilësinë e tokave në Glogoc janë: ndërtimet e paplanifikuara, deponitë industriale, deponitë e mbeturinave, erozioni, eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit dhe përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

Toka Bujqësore - Për të mundësuar prodhimtari të rregullt dhe të sigurt me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, botës bimore, shtazore dhe mjedisit, zbatohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja.

- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja bëhet me ndalim, kufizim dhe parandalim nga bartja direkte, bartja përmes ujit dhe ajrit e materieve të dëmshme dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë.
- Në zonën e mbrojtur ndalohet ndërrimi i destinimit të tokës, e cila nuk është në pajtim me dokumentin e planifikimit hapësinor dhe Ligjit për Tokën Bujqësore. Neni 32

Zhurma- Komuna duhet të ketë për bazë që zhurma është një nga ndotësit e mjedisit dhe matja e nivelit të saj është e nevojshme për të vlerësuar nivelin e ekspozimit të popullatës ndaj këtij ndotësi, po ashtu është kërkesë ligjore që del nga Ligji për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102.

- Sipas këtyre kërkesave Komuna e Glogocit obligohet të hartoj Planin e Veprimit dhe Hartën e zhurmës, përmes së cilave do të identifikohen lokacionet që i ekspozohen zhurmës, prezantimi i tyre në hartë dhe propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma.



Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vleresimi Strategjik Mjedisor per Harten Zonale

- Ndalohet lëshuarja e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e dëmtojnë dhe ndryshojnë aftësinë prodhuese të tokës bujqësore apo kualitetin e kulturave bujqësor dhe përdorimi jo i drejt i plehrave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e bimëve.
- Nëse vjen deri tek ndotja e tokës bujqësore me lëshuerjen e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme në sasi më të madhe se sa është e lejuar, ndotësi i tokës bujqësore i bartë shpenzimet e veprimeve për dekontaminim, përkatësisht për sanim të tokës bujqësore.

Mbeturinat- Komuna e Glogocit për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme duhet të ndjek udhëzimet e hartuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.



LITERATURA

- Plani Zhvillimor Komunal – Glogoc 2008-2020+
- Plani Zhvillimor Komunal – Glogoc 2020-2028+
- Drafti i Hartës Zonale të Kosovës 2020-2028+
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor 2020-2028+
- Raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë, AMMK 2019,
- https://ëëë.ammkrks.net/repository/docs/Raporti_p%C3%ABr_gjendjen_e_ajrit_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_per_vitin_2019
- Vlerësimi Popullsia e Kosovës, ASK 2019, <https://ask.rks-gov.net/media/5480/vleresimi-i-popullsise-2019.pdf>
- Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit 2018-2022
- Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020
- Dokumenti për Politika dhe Strategjinë e zhvillimit të sektorit të Pylltarisë 2010 – 2020
- Draft Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë 2019-2021 për Komunën e Glogocit (Drenasit).
- Pedologjia, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, H.Gashi, Sh.Spaho, M.Dushi. 2002
- Identifikimi i produktit turistik në rajonin e Prishtinës, MTI 2017
- Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+
- Plani i Veprimit për Burimet e Ripërtitshme të Energjisë 2013-2020
- Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Komuna e Glogocit 2015-2020
- Propozim profesional për shpalljen e Liqeneve të Vasileves Peizazh i Mbrojtur, AMMK-IKMN/2014
- Raportet vjetor për cilësinë e ujit të pijshëm në Kosovë, për vitet 2016 dhe 2017, IKSH
- Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, AMMK
- Raporti për Gjendjen e Natyrës 2015-2017, AMMK, Prishtinë 2019



Komuna e Glogocit (Drenasit) 2020 Vleresimi Strategjik Mjedisore per Harten Zonale

- Raporti për gjendjen e ujerave 2015, AMMK
- Resurset natyrore. Universiteti i Prishtinës, fakulteti i shkencave matematike – natyrore, Bulliqi, Sh. 2004. Departamenti i Gjeografisë, Prishtinë.
- Statuti i Komunës së Glogocit
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin
- Strategjia e Kosovës për Mjedisin 2013-2022
- Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022
- Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025
- Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019- 2021
- Strategjia për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Glogocit/ 2015-2019
- Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2033
- Studimi i Ndotjes së Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, Identifikimi i burimeve të ndotjes dhe propozimet për masat e përmirësimit, MMPH/GIZ 2015
- Bilalli, A., Mulsiu, M., Ibrahim, H. & Svec, I. 2019: Neë records for the stonefly fauna (Insecta: Plecoptera) of Kosovo. Natura Croatica (në procedurë të botimit)
- 34. Ibrahim, H., Spahija, I., Bilalli, A. & Kuqi, R. 2019: Contribution to the knowledge of the Caddisfly (Insecta: Trichoptera) fauna of the Drenica River in Kosovo. Contribution to the knowledge of the Caddisfly (Insecta: Trichoptera) fauna of the Drenica River in Kosovo
- 35. Ibrahim, H., Gashi, A., Bilalli, A., Musliu, M., Grapci Kotori, L., & Zhushi Etemi, F., 2014: Three neë country records from the genus Limnephilus Leach, 1815 (Trichoptera: Limnephilidae) from the Republic of Kosovo. Biodiversity Data Journal 2: e4140
- 36. Bilalli, A. 2019: Veçoritë ekologjike, taksonomike dhe biogjeografike të insekteve ujore të Bjeshkëve të Karadakut. Punim i doktoratës. Universiteti i Prishtinës, FSHMN. 1-20